

| 2021 |

# *RAPORT*

*për gjendjen e financimit kapital të  
të sigurimit pensional*



## **Agjensioni për Mbikëqyrjen e Finansimit Kapital të Sigurimit Pensional**

Stiv Naumov Nr. 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Tel: (+389-2) 3224 229

[www.mapas.mk](http://www.mapas.mk)

Maj 2022

Përkthimi në shqip: Društvo za usluzi BESTEL DOOEL, Skopje

## Përmbajtja

|                                                                                                                                             |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Shkurtesa</b>                                                                                                                            | <b>3</b>  |
| <b>Fjala hyrëse</b>                                                                                                                         | <b>4</b>  |
| <b>Data të rëndësishme në vitin 2021</b>                                                                                                    | <b>6</b>  |
| <b>MAPAS, misioni dhe vizioni</b>                                                                                                           | <b>7</b>  |
| <b>1. Vështrim i shkurtër i situatave dhe trendeve në botë në sferën e pensioneve, me theks tek financimi kapital i sigurimit pensional</b> | <b>8</b>  |
| <b>2.Struktura e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut</b>                                         | <b>14</b> |
| 2.1 Përshkrimi i sistemit pensional                                                                                                         | 15        |
| 2.2 Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në sistemin pensional                                                                  | 16        |
| 2.3 Institucionet të financimit kapital të sigurimit pensional                                                                              | 17        |
| <b>3 Ndryshimet dhe plotësimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë financimin kapital të sigurimit pensional</b>                 | <b>20</b> |
| <b>4 Të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionale</b>                                                                              | <b>23</b> |
| 4.1 Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2021                                                                        | 24        |
| 4.2 Rezultati financiar i shoqërive pensionale                                                                                              | 27        |
| 4.3 Kapitali, kapitali themeltar dhe mjetet individuale të shoqërive pensionale                                                             | 27        |
| 4.4 Indikatorët                                                                                                                             | 28        |
| <b>5 Të dhëna për fondet e detyruara pensionale të detyrueshme</b>                                                                          | <b>30</b> |
| 5.1 Anëtarësimi në fondet e detyruara pensionale                                                                                            | 31        |
| 5.2. Të dhëna për anëtarësim në fonndet pensionale të detyrueshme                                                                           | 32        |
| 5.3 Transferimi i një anëtari nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër                                                            | 36        |
| 5.4 Kontributet në fondet e detyrueshme pensionale                                                                                          | 37        |
| 5.4.1. Kompensim për vonësë të transferit të kontributeve                                                                                   | 38        |
| 5.4.2. Mjetet e kthyera në Fondin SPIMV                                                                                                     | 39        |
| 5.5 Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve të detyrueshme pensionale                                                               | 40        |
| 5.6 5.6Mjetet neto, njësia llogaritare dhe shkalla e kontributit të fondeve të detyrueshme pensionale                                       | 46        |
| 5.7 Kompensimet tek fondet e detyrueshme pensionale                                                                                         | 52        |
| 5.8 Pagesa e pensioneve nga siguri i detyrueshëm pensional me financim kapital                                                              | 54        |
| <b>6 Të dhëna për fondet pensionale vullnetare</b>                                                                                          | <b>56</b> |
| 6.1 Qëllimi i sigurimit pensional vullnetar me financim kapital                                                                             | 57        |
| 6.2 Anëtarësia në fondet pensionale vullnetare                                                                                              | 58        |
| 6.3 Kalimi i një anëtari nga një llogari në një tjetër, brenda të njëjtit ose në një fond tjetër pensional vullnetar                        | 61        |
| 6.4 Kontributet në fondet pensionale vullnetare                                                                                             | 61        |
| 6.5 Investimi dhe struktura e portfolit të fondeve pensionale vullnetare                                                                    | 62        |
| 6.6 Mjetet neto, njësia llogaritare dhe norma e të ardhurave të fondeve pensionale vullnetare                                               | 68        |
| 6.7 Kompensimet e fondeve pensionale vullnetare                                                                                             | 73        |
| 6.8 Pagesa e kompensimeve pensionale të sigurimit pensional vullnetar me financim kapital                                                   | 75        |
| <b>7 Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale</b>                                                                                     | <b>76</b> |

## Shkurtesa

|                        |                                                                                                                            |
|------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PBV</b>             | <i>Prodhimi bruto vendor</i>                                                                                               |
| <b>Shtylla e dytë</b>  | <i>Sigurimi pensional i detyruar me financim kapital</i>                                                                   |
| <b>FPV</b>             | <i>Fonde pensioneale vullnetare</i>                                                                                        |
| <b>ESHS</b>            | <i>Enti Shtetëror i statistikës</i>                                                                                        |
| <b>BE</b>              | <i>Bashkimi Evropian</i>                                                                                                   |
| <b>FDP</b>             | <i>Fonde të detyrueshme pensioneale</i>                                                                                    |
| <b>IOPS</b>            | <i>Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë (International Organisation of Pension Supervisors)</i>              |
| <b>KB e parë</b>       | <i>KB Shoqëria e parë për administrim me fondet pensioneale të detyrueshme dhe vullnetare SHA Shkup</i>                    |
| <b>KBPv</b>            | <i>KB Shoqëria e fondit pensional të hapur vullnetar - Shkup</i>                                                           |
| <b>KBPd</b>            | <i>KB Shoqëria e fondit pensional të hapur të detyrueshëm - Shkup</i>                                                      |
| <b>MAPAS</b>           | <i>Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional</i>                                                |
| <b>BPRMV</b>           | <i>Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut</i>                                                                |
| <b>OECD</b>            | <i>Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organization for economic coopëration and developement)</i>           |
| <b>Shtylla e parë</b>  | <i>Sigurim mbi bazën e solidaritetit të gjeneratave</i>                                                                    |
| <b>SAVA</b>            | <i>Shoqëria për administrim të fondeve pensioneale të detyrueshme dhe vullnetare Sava Shoqëri Pensionale SH.A Shkup</i>    |
| <b>SAVAv</b>           | <i>Fondi pensional vullnetar i hapur Sava Pension Plus</i>                                                                 |
| <b>SAVAd</b>           | <i>Fondi pensional i detyrueshëm i hapur Fondi Pensional Sava</i>                                                          |
| <b>Shtylla e tretë</b> | <i>Sigurim pensional vullnetar me financim kapital</i>                                                                     |
| <b>TRIGLAV</b>         | <i>Shoqëria për administrim me fondet pensioneale të detyrueshme dhe vullnetare Shoqëria PENSIONALE TRIGLAV SH.A SHKUP</i> |
| <b>TRIGLAVv</b>        | <i>Fondi i Hapur Pensional Vullnetar Trigllav – Shkup</i>                                                                  |
| <b>TRIGLAVd</b>        | <i>Fondi i Hapur i Detyrueshëm Pensional - Shkup</i>                                                                       |
| <b>DAP</b>             | <i>Drejtoria e të Ardhurave Publike</i>                                                                                    |
| <b>Fondi SPIMV</b>     | <i>Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut</i>                                      |

# Fjala hyrëse



Të nderuar,

Raporti për gjendjet në finansimin kapital të sigurimit pensional në vitin 2021 të Agjencionit për Mbikëqyrjen e Finansimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS, përmban përshkrim të karakteristikave të Finansimit Kapital të Sigurimit Pensional, vlerësim të zbatimit të rregullave në sferën e finansimit kapital të sigurimit pensional dhe të dhënave tjera me rëndësi për këtë sigurim përfundimisht me vitin 2021. Raporti është vërtetim se MAPAS siguron funksionim të vazhdueshëm, zhvillim dhe avancim të shtyllës së dytë dhe të tretë, transparencë dhe mbikëqyrje efikase të segmentit të dytë për nga madhësia në sektorin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vitit 2021, mjetet e përgjithshme të mjeteve të përgjithshme të detyrueshme të fondeve të detyrueshme pensionale tejkaluan 100 miliardë denarë dhe në fund të vitit 2021 arritën 105,66 miliardë denarë, u rritën për 21% krahasuar me vitin 2020. Mjetet e përgjithshme të fondeve të detyrueshme pensionale shënuan rritje më të madhe lidhur me mjetet e përgjithshme të fondeve të detyrueshme pensionale, përkatësisht u rritën për 25% dhe arritën 2.9 miliardë denarë. Me atë mjetet e përgjithshme të fondeve pensionale në shtyllën e dytë dhe të tretë arritën afro 15% të prodhimit bruto vendor për vitin 2021. Në vitin 2021 u rrit edhe përfshirja e popullsisë në shtyllën e dytë, përkatësisht 96% të numrit të përgjithshëm të të siguruarve në Fondin e SIPMV-së ose 58% të popullsisë së përgjithshme aktive janë anëtarë të shtyllës së dytë. Megjithatë shënoi rritje të zmadhuar, megjithatë pjesëmarrja e popullsisë në shtyllën e tretë është ende modeste, përkatësisht vetëm afro 2,9% të popullsisë së përgjithshme aktive në RMV janë anëtarë me llogari individuale vullnetare dhe janë pjesëmarrës në skemën pensionale me llogari profesionale në fondin pensional vullnetar.

Gjatë vitit 2021 në fondet e detyrueshme pensionale u transferuan kontribute në shumë prej 9,68 miliardë denarë gjë që paraqet afro 1,34% e PBV-së së RMV-së, ndërsa në fondet pensionale vullnetare u paguan gjithsej afro 407,71 milionë denarë, gjë që paraqet afro 0,06% e PBV-së së RMV-së.

Struktura e portofolit investues të fondeve të detyrueshme pensionale nuk ndryshon dukshëm në krahasim me vitin e kaluar. Portofoli i investimeve në vitin 2021 përbëhet nga investimet vendore që përfshijnë letrat shtetërore me vlerë (59,87%), depozita (6,82%), aksione (2,89%), pjesëmarrjet në fondet investuese (0,27%) dhe obligacionet korporative (0,02%), si dhe investimet jashtë vendit, që përfshijnë pjesëmarrje të fondeve investuese (25,57%) dhe aksionet (4,13%). Në nivelin e finansimit kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional, në periudhën shtatëvjeçare 2015-2021 u realizuan të ardhura mesatare në nivel vjetor prej 5,91% në shumë nominale, përkatësisht 4,41% në shumë reale, të llogaritur nëpërmjet ndryshimit të ponderuar të njësive kontabël të fondeve të detyrueshme pensionale.

Struktura e portofolit investues të fondeve pensionale vullnetare gjithashtu nuk dallon dukshëm në krahasim me vitin e kaluar. Fillimi i punës së fondit pensional vullnetar TRIGLLAVv nuk ndikoi shumë në strukturën e përgjithshme të investimeve të fondeve pensionale vullnetare, duke pasur parasysh faktin se në vitet fillestare të funksionimit fondi i ri ka mjete që janë me vëllim të vogël në raport me mjetet e përgjithshme. Portofoli investues në vitin 2021 përbëhet nga investime vendore që përfshijnë letra shtetërore me vlerë (49.88%), depozita (11.36%), aksione (8.21%), obligacione korporative (0.61%) dhe një pjesë shumë e vogël në pjesëmarrje në fonde investuese (0.01%), si dhe investime jashtë vendit, që përfshijnë pjesëmarrje të fondeve investuese (24.22%) dhe aksione (4.99%). Në nivelin e finansimit kapital të sigurimit pensional, në periudhën shtatëvjeçare 2015-2021 u realizuan të ardhura mesatare në nivel vjetor prej 5,85% në shumë nominale përkatësisht 4,35% në shumë reale, të llogaritur nëpërmjet ndryshimit të

mesatares së ponderuar të njësive kontabël të fondeve pensionale vullnetare.

Gjithashtu, në vitin 2021 është punuar në avancimin dhe saktësimin apo thjeshtimin e procedurave të caktuara në kuadër të funksionimit të finansimit kapital të sigurimit pensional dhe në këtë drejtim u miratuan ndryshime të akteve nënligjore dhe udhëzime. Gjithashtu u rregullua mundësia e lidhjes digjitale të kontratës për anëtarësim në fondin e detyrueshëm/vullnetar pensional dhe mundësia e komunikimit elektronik ndërmjet fondeve pensionale dhe MAPAS-it. Gjithashtu, për të rritur numrin e instrumenteve të lejuara për investim dhe për të zgjeruar universin investues, u reduktuan kufizime të caktuara për investim të mjeteve të fondeve pensionale, u ul niveli i rejtingut të kërkuar të kredisë për cilësinë e të gjitha instrumenteve dhe u përcaktua niveli më i ulët i vlerësimit brenda kufijve të ligjit, përkatësisht vlerësimit të rekomandueshëm për investime sipas agjensioneve ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë. Me këtë ndryshim u zgjeruan mundësitë e investimit në shtete tjera anëtare të OECD-së ose të BE-së.

Kursimi për pension është afatgjatë, ndërsa sfidat që i sjell finansimi kapital i sigurimit pensional është i pashmangshëm. Gjendjet në sferën pensionale doemos duhet të ndiqen vazhdimisht, dhe me atë të ndërmërrën edhe masa përkatëse, me qëllim përforcimin e kursimeve individuale përmes nxitjes së konkurrencës, promovimit të menaxhimit efikas dhe fleksibil me portofolin dhe zgjerimit të mbulimit, e në drejtim të mbrojtjes së interesave të anëtarëve dhe realizimit të pensionit të sigurt gjatë pleqërisë.

Ju sigurojmë se trupi mbikëqyrës dhe rregullator, në punën e përditshme, udhëhiqemi nga misioni ynë edhe në vitet e kaluara, do t'i investojmë resurset tona në drejtim të mbindërtimit dhe avancimit të finansimit kapital të sigurimit pensional.

Besojmë se ky raport me të dhëna dhe informacione të detajuara për shtyllën e dytë dhe të tretë do të jetë i dobishëm për të gjitha palët e interesuara.

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve,

Maksud Ali

## Data të rëndësishme në vitin 2021

**1.3.2021**

*Filloi të punojë Fondi i hapur pensional vullnetar Trigllav - Shkup*

**1.5.2021**

*ëria pensionale Sava sh.a. Shkup i zvogëloi kompensimet të cilat i paguan në shtyllën e tretë (nga 2,9% në 2,5% kompensim nga kontributet dhe nga 0,100% në 0,075% kompensim nga mjetet)*

**2.9.2021**

*Vlera e mjeteve neto të fondeve të detyrueshme pensionale tejkaloi 100 miliardë denarë.*

# MAPAS, misioni dhe vizioni

Agjensioni për Mbikëqyrjen e Finansimit Kapital të Sigurimit Pensional - MAPAS është institucion rregullator dhe mbikëqyrës i themeluar me qëllim për t'u kujdesur për interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe për ta inkurajuar zhvillimin e finansimit kapital të sigurimit pensional. Është themeluar në korrik të vitit 2002. Ka cilësinë e personit juridik me autorizime publike, të përcaktuara me Ligjin për finansim të detyrueshëm kapital të sigurimit pensional dhe me Statutin. Për punën e tij përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

MAPAS-i është përgjegjës për lëshimin, tërheqjen dhe marrjen e lejeve për themelimin e shoqërive pensionale, lejeve për kryerjen e veprimtarisë - menaxhimin e fondeve pensionale dhe lëshimin, tërheqjen dhe heqjen e lejeve për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Ai kryen mbikëqyrje të punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, si dhe rojtare të pronës dhe menaxherëve të huaj të mjeteve. MAPAS-i, gjithashtu e promovon, organizon dhe inkurajon zhvillimin e finansimit kapital të sigurimit pensional në RMV, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe zhvillon ndërgjegjësimin e publikut për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, për përfitimet e anëtarësimit në fondin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar, duke përfshirë qëllimet, parimet dhe përfitimet e pjesëmarrjes në skemë pensionale profesionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe për çështje tjera lidhur me finansimin e plotë të sigurimit pensional. MAPAS-i miraton akte në përputhje me ligjet në sferën e finansimit kapital të sigurimeve pensionale si dhe udhëzime profesionale, manuale dhe ngjashëm në lidhje me finansimin kapital të sigurimit pensional dhe inicion miratim të akteve tjera lidhur me shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale të cilat ato i menaxhojnë. MAPAS-i gjithashtu bashkëpunon me institucionet përkatëse në RMV dhe jashtë vendit për të siguruar kontroll efektiv të finansimit kapital të sigurimit pensional në RMV.

Me Agjencinë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional menaxhon Këshilli i kspërtëve, i përbërë nga Kryetari i Këshillit dhe katër anëtarë, si më poshtë vijon:

Maksud Ali – Kryetar,  
Mentor Jakupi – Anëtar profesional i angazhuar,  
Darko Sazdov – Anëtar profesional i angazhuar,  
Borçe Bozhinoski – Anëtar i jashtëm,  
Marina Makenaxhieva – Anëtare e jashtme,

**Misioni ynë** është që të mbrojmë interesat e anëtarëve dhe anëtarëve në pension të fondeve pensionale dhe të nxisim zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional, për ditë më të sigurta pensionale.

**Vizioni ynë** është që të identifikohemi si një institucion i pavarur, profesional dhe transparent, që mbron dhe zhvillon sistemin pensional në RMV.



# 1

Vështrim i shkurtër i situatave dhe trendeve  
në botë në sferën e pensioneve, me theks tek  
financimi kapital i sigurimit pensional

# 1. Vështrim i shkurtër i situatave dhe trendeve në botë në sferën e pensioneve, me theks tek financimi kapital i sigurimit pensional

Sistemet pensionale në botë shpesh përkufizohen si shumëshyllëshe, me qëllim diversifikimin e rreziqeve të ndryshme që ndikojnë në sistemet pensionale. Mjetet në sistemet pensionale në mbarë botën në vitin 2020 u rritën për 11% krahasuar me vitin 2019 dhe tejkaluan 56 bilionë USD (54 bilionë USD në vendet anëtare të OECD-së dhe 2 bilionë USD në vende të zgjedhura të cilat nuk janë anëtare të OECD-së). Fondet pensionale edhe më tutje janë promotorët kryesorë të sistemeve pensionale në nivel botëror (mjete në shumë prej 35 bilionë në vitin 2020).

Pas rënies së tremujorit të parë nga viti 2020, tregjet financiare në nivel global u rimëkëmbën gjatë vitit, duke mundësuar që fondet pensionale t'i kompensojnë rezultatet negative nga investimet e tremujorit të parë. Kjo u nxit nga sektorët të cilët shënonin progres gjatë pandemisë (p.sh., kompanitë për zhvillim teknologjik), nga mbështetjet e bankave qendrore për t'i mbajtur të ulëta shpenzimet për huamarrje (p.sh., zhvillimi i vaksinave dhe aprovimi i tyre nga organet shëndetësore). Të ardhurat e ponderuara investuese neto reale janë 6% në vendet anëtare të OECD-së dhe 5,7% në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së.

Në vitin 2021, në vazhdim të diskutimeve për digjitalizimin dhe zhvillimin e teknologjisë në sferën pensionale, ishte qasja mbikëqyrëse për përf forcimin e rezistencës kibernetike në sektorin privat pensional. IOPS-ja i identifikoi kërcënimet dhe trendët kryesorë kibernetike lidhur me pensionet private në vitet e fundit edhe në periudhën e pandemisë me virusin Korona dhe i përmbledhi përvojat e deritanishme për masa efektive për zbutjen e këtyre rreziqeve.

Sistemet pensionale në botë karakterizohen me struktura të ndryshme si rezultat i gjendjeve të ndryshme socioekonomike dhe demografike në shtetet, ndikimit të kulturës së popullit dhe shprehive të tij dhe perceptimeve të kursimit të pensionit. Në dekadat e fundit, rreziqet nga plakja e popullsisë dhe nga natyra e ndryshueshme e tregut të punës nxisin spektër të gjerë të reformave në sistemet pensionale, me qëllim të zbutjes së tyre, por me qëllim të njëjtë të fundit – siguri i sistemit të qëndrueshëm pensional dhe të ardhurave për të siguruarit pas pensionimit të tyre.


Fondet në sistemet pensionale në mbarë botën në vitin 2020 u rritën për 11% krahasuar me vitin 2019 pavarësisht tronditjes së shkaktuar nga pandemia me virusin Korona dhe rënies së shumës së mjeteve pensionale në fund të marsit 2020. Në vitin 2020, mjetet pensionale në nivel botëror tejkaluan 56 miliardë dollarë (54 miliardë dollarë në vendet anëtare të OECD-së dhe 2 miliardë dollarë në vendet e zgjedhura të cilat nuk janë anëtare të OECD-së). Promotorët e sistemeve pensionale në nivel botëror edhe më tutje janë ende fondet pensionale (mjete në shumë prej 35 miliardë në vitin 2020). Gjithashtu, disa vende përdorin edhe forma tjera të kursimit për pension, siç janë kontratat e sigurimit pensional me shoqëritë e sigurimit (për Shërbull, Danimarka, Franca) ose produkte të cilat i sigurojnë dhe i menaxhojnë bankat dhe kompanitë e investimeve (të tilla si llogaritë individuale të pensionit (angl. individual retirement accounts SHBA).

Madhësia e vlerës së mjeteve të sistemeve private pensionale në të gjitha vendet është e ndryshme, gjë që është si rezultat, sigurisht, i fillimeve të ndryshme të vendosjes së sistemeve, nëse përfshirja në planin pensional është e detyrueshme apo vullnetare dhe, gjithsesi i rezultateve të investimit. Në kuptimin absolut, shumat më të mëdha të mjeteve pensionale vërehen në Amerikën e Veriut (Kanada dhe SHBA), në Evropën Perëndimore (Holandë, Zvicër dhe Mbretërinë e Bashkuar), Australi dhe Japoni, ku mjetet pensionale tejkaluan nga një miliardë dollarë. Nga ana tjetër, mjetet në sistemet pensionale private në 70 (nga 92 vende të sonduara) paraqesin më pak se 0.2 miliardë dollarë. Madhësia e vlerës së mjeteve të sistemeve pensionale private në të gjitha vendet ndryshon edhe në kuptim relativ. Nëntë nga 38 vendet anëtare të OECD-së në fund të vitit 2020 kishin mjete mbi 100% të ekonomisë së tyre. Në vendet e vogla si Islanda, mjetet e akumuluaru janë të vogla në krahasim me sistemet pensionale, por të larta në raport me ekonominë e tyre (207% e PBV-së). Nga ana tjetër, shumat e mjeteve pensionale është më pak se 20% e PBV-së në 52 nga 92 vendet e sonduara, duke përfshirë disa vende të mëdha dhe me rritje të shpejtë (p.sh. Kina, India).

Krahasimi i madhësisë së vlerës së mjeteve pensionale private me madhësinë e ekonomisë, të shprehur përmes prodhimit bruto vendor, jep një pasqyrë më të mirë të rëndësisë relative të segmentit pensional privat në vend. Shumata e mjeteve pensionale në vendet e OECD-së në lidhje me PBV-në e përgjithshme të vendeve anëtare të OECD-së u rrit nga 64% në 2010 në 100% dhjetë vite më vonë (treguar në Grqafikun 1.1). Ashtu si në vitin 2010, në vitin 2020 Danimarka kryeson me 229% të PBV-së, pastaj vijojnë Holanda (213%) dhe Islanda (207%). Në disa vende të cilat nuk janë anëtare të OECD-së, mjetet pensionale arritën nivelin mbi 100% të PBV-së 106% në Lihtenshtajn dhe 102% në Namibi). Nga ana tjetër, pavarësisht rritjes së caktuar, mjetet pensionale në disa vende (Shqipëri, Greqi dhe Serbi) janë ende më pak se 1% e PBB-së edhe në fund të vitit 2020.

<sup>1</sup>Burimet e shfrytëzuara: Raporte nga OECD, EIOPA, Banka Botërore, FIAP dhe OBSP dhe analiza dhe këndvështrime personale.

Grafiku 1.1. Mjetet e përgjithshme pensionale, në vitin 2010 (ose viti i parë i disponueshëm) dhe 2020 (ose viti i parë i disponueshëm).



Burimi: OECD, Tregu i pensioneve në fokus, 2021.

Edhe një tregues tjetër për rëndësinë e pensioneve me finansim kapital dhe privat në një vend është shkalla e mbulimit. Shkalla e mbulimit mund të matet me numrin e anëtarëve aktivë të planeve pensionale (persona që kanë mjete në planet pensionale dhe nuk janë ende në pension) në raport me popullsinë e aftë për punë (personat e moshës 15 deri në 64 vjeç). Qasja në planin pensional mund të jetë i detyrueshëm, vullnetar ose i nxitur përmes përfshirjes automatike. Të dhënat e disponueshme tregojnë se në vitin 2020 në 17 nga gjithsej 32 vende të sonduara në planet e detyrueshme pensionale janë përfshirë më shumë se 75% të popullsisë së moshës së aftë për punë. Shkallët më të larta të mbulimit vërehen në Danimarkë, Estoni, Finlandë, Islandë, Letoni dhe Suedi ku pothuajse e gjithë popullsia e aftë për punë merr pjesë në planet e detyrueshme pensionale. Në Amerikën Latine, Çile (83%) dhe Kosta Rikë (82.9%) shënojnë shkalla të larta të mbulimit prej 83% të popullsisë e aftë për punë, gjë që nuk është rast në vende tjera, si Kolumbia (52.4%) dhe Peruja (35.4%) ku njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet sistemit pensional të solidaritetit të gjeneratës dhe sistemit pensional privat me finansim kapital. Ndikon në mënyrë shtesë në shkallët e ulëta relative të mbulimit në planet e detyrueshme pensionale të punës joformale në këto vende. Pjesëmarrja në planet pensionale vullnetare dallon më shumë në shtetet. Më shumë se gjysma e të punësuarve në Gjermani dhe Islandë dhe më shumë se gjysma e popullsisë e aftë për punë në Belgjikë, Republikën e Çekisë, Japoni dhe Poloni përfshihen në planet pensionale vullnetare. Në disa vende, pjesëmarrja në planet pensionale vullnetare ishte relativisht e ulët, veçanërisht në Shqipëri, Bullgari, Pakistan dhe Kazakistan. Megjithatë, në Bullgari dhe Kazakistan, shumë persona të siguruar tashmë janë anëtarë të planeve të detyrueshme pensionale, përkatësisht 87% dhe 77.6% e popullsisë e aftë për punë. Mbulimi i vogël në Shqipëri dhe Pakistan mund të jetë rezultat i ndërgjegjësimit të pamjaftueshëm dhe interesit të vogël të popullsisë (veçanërisht të rinjve) për plane të tilla pensionale. Në shumicën e vendeve, në vitin 2020 është ruajtur trendi i rritjes, ndoshta si rezultat i masave për ruajtjen e vendeve të punës dhe masave tjera të politikave që synojnë zbutjen e ndikimit të virusit Korona në tregjet e punës dhe t'u mundësojnë të punësuarve t'i ruajnë vendet e tyre të punës ose të ruajnë të drejtat në planet e tyre të kursimit në pension gjatë pandemisë. Megjithatë, në disa vende (për shembull, Çile) pjesëmarrja në përqindje e njerëzve që kanë kurse pensionale në raport me popullsinë në moshë pune është ulur.

Shuma e përgjithshme e kontributeve të paguara në planet pensionale varet nga pjesëmarrja e personave që kanë qasje dhe që përfshihen në planet pensionale, sa prej tyre kontribuojnë aktivisht në planet dhe shumat e kontributeve. Pagesa mund të bëhet nga anëtarët, punëdhënësit e tyre ose shtetet (për shembull, si stimuj financiarë). Shumat më të mëdha të kontributeve të paguara në vitin 2020 vërehen në vendet me plane pensionale të finansimit të detyrueshëm kapital. Në raport me madhësinë e ekonomisë së tyre, shumat më të larta të kontributeve u paguan në Islandë (10.6% e PBB-së), Zvicër (9.6%), Republikën Dominikane (8.5%), Danimarkë (8.2%) dhe Australi (6.9%). Në këto vende, pjesëmarrja në planet pensionale është e detyrueshme dhe shkalla e mbulimit është relativisht e lartë (nga 55% në 92% të popullsisë e aftë për punë). Pagesat në planet pensionale në këto vende mund të bëhen si nga të punësuarit ashtu edhe nga punëdhënësit. Për krahasim, shumat më të vogla të kontributeve të paguara vërehen në sistemet pensionale vullnetare në Pakistan dhe Shqipëri, ku pjesëmarrja në planet pensionale është vullnetare dhe më pak se 2% e popullsisë e aftë për punë përfshihet në planin pensional.


Rezultatet e investimeve të planeve pensionale private dhe të finansimit kapital janë shtytësi kryesor i rritjes së mjeteve pensionale. Nga këndvështrimi i anëtarëve të planeve pensionale, të ardhurat investuese private e rrisin sigurinë e premtimeve të

planeve për pensionet e definuara dhe e rrisin shumën e mjeteve dhe të ardhurave pas pensionimit që mund t'i presin anëtarët e planeve me kontribute të përcaktuara. Rritja e mjeteve pensionale në vitin 2020 është pjesërisht për shkak të rezultateve të planeve pensionale private dhe të finansimit kapital në vitin 2020. Megjithatë më e ulët në krahasim me vitin 2019, të ardhurat investuese reale të mjeteve pensionale (neto nga shpenzimet e menaxhimit) në vitin 2020 arritën mesatarisht 4.1% në vendet e OECD-së dhe 3.2% në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së. Të ardhurat investuese të ponderuara reale (lidhur me mjetet pensionale) shënuan vlera më të larta, 6% në vendet e OECD-së dhe 5.7% në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së, duke reflektuar faktin se disa nga tregjet më të mëdha pensionale realizuan fitime më të mëdha. Disa nga tregjet më të mëdha pensionale, si Kanadaja, Holanda, Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara, shënuan rezultate relativisht të larta investuese, me të ardhura investuese reale më të larta se 5% në vitin 2020. Rezultatet më të mira janë vërejtur në Hong Kong (Kinë) (12.7%), Meksikë (9.3%) dhe Islandë (8.7%). Në përgjithësi, fitimi investues u vërejt në shumicën e vendeve të sonduara (në 30 nga 33 vendet e sonduara që nuk janë anëtare të OECD-së dhe në 30 nga 32 vendet e sonduara që nuk janë anëtare të OECD-së). Në grafikun 1.2. janë paraqitur të ardhurat investuese reale të mjeteve pensionale, neto nga shpenzimet e menaxhimit për vitin 2020, në vende të zgjedhura – anëtare të OECD-së dhe vende të zgjedhura që nuk janë anëtare të OECD-së.

Pas rënies në tremujorin e parë të vitit 2020, tregjet financiare në nivel global u rimëkëmbën gjatë vitit, duke mundësuar fondet pensionale t'i kompensojnë rezultatet negative nga investimet e tremujorit të parë. Kjo u nxit nga sektorët që përparuan gjatë pandemisë (p.sh., kompanitë për zhvillim teknologjik), mbështetjet nga bankat qendrore për t'i mbajtur pritjet gjatë vitit (zhvillimi i vaksinave dhe aprovimi i tyre nga organet shëndetësore).

Të ardhurat për një periudhë më të gjatë janë tregues më relevantë se të ardhurat më afatshkurtër duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të planeve pensionale. Planet pensionale në shumicën e vendeve të sonduara realizuan të ardhura investuese pozitive në afat më të gjatë. Edhe krahas ndikimit të virusit Korona dhe humbjet investuese për planet pensionale në shumë vende në tremujorin e parë në vitin 2020 dhe në vitin 2018 planet pensionale arritën të ardhura investuese vjetore reale pozitive në pesë vitet e fundit në të gjitha vendet anëtare të OECD-së, përveç në Çeki dhe në të gjitha vendet që nuk janë anëtare të OECD-së, përveç në Egjipt, Nigeri dhe Surinam. Rezultatet nga investimi i mjeteve pensionale në masë të madhe varen nga alokimi i mjeteve dhe niveli i rrezikut. Ekspozimi më i madh i portofolit të instrumenteve më të rrezikshme implikon shuma më të mëdha potenciale të të ardhurave dhe paqëndrueshmërisë së të ardhurave. Në shumicën e vendeve të sonduara në vitin 2020 mjetet pensionale janë investuar në obligacione dhe në aksione, dhe atë në më shumë se gjysma e investimeve në 35 dhe 38 vende anëtare të OECD-së dhe në vitin 38 dhe 46 vende të sonduara që nuk janë anëtare të OECD-së. Prandaj zhvillimi i tregjeve të obligacioneve dhe aksioneve ka rol kryesor në performansat financiare të planeve pensionale. Pjesëmarrje më të lartë të obligacioneve dhe aksioneve në portofolin e përgjithshëm të fondeve pensionale kishte në Rumani (98,6%), Çile (97,8%), Republikën Dominikane (97,2%), Estoni (96,9%), Maldivet (96,7%), Meksikë (96,5%), Nigeri (96,2%), Shqipëri (95,6%), Kroacia (95,1%) dhe Lituani (95%). Pjesëmarrja procentuale e aksioneve dhe obligacioneve dallohet në vendet në vitin 2020. Megjithatë, përgjithësisht ekziston prirje më e madhe ndaj obligacioneve, megjithatë në 11 vende anëtare të OECD-së dhe 12 vende që nuk janë anëtare të OECD-së, pjesëmarrja procentuale e aksioneve ishte më e madhe lidhur me obligacionet. Obligacionet shtetërore, për dallim nga obligacionet

Grafiku 1.2. Të ardhurat reale të fondeve pensionale të investimeve, neto nga shpenzimet e administrimit për vitin 2020 në përqindje.



Burimi: OECD, Tregu i pensioneve në fokus, 2021.

korporative, paraqitnin pjesë më të madhe të investimeve të drejtpërdrejta në obligacionet në numrin më të madh të vendeve. Për shembull, obligacionet shtetërore ishin 100% të investimeve të drejtpërdrejta në obligacionet në Shqipëri, 99,9% në Maqedoninë e Veriut, 97,8% në Maldivet, 96,9% në Kroaci, 95,9% në Kazakistan dhe Serbi, 89% në Izrael dhe 88,9% në Çeki, por vetëm 22,1% në Norvegji, 13,9% në Zelandën e Re, 11,7% në Surinam dhe 9,1% në Makao (Kinë). Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e mjeteve pensionale në disa prej vendeve të sonduara janë në mjete monetare dhe depozita. Për shembull, në Australi (15%) dhe Peru (5%) në krahasim me vitin 2019, mjetet pensionale janë ruajtur më shumë në mjete monetare dhe depozita për shërbime potenciale për shkak të tërheqjeve të mjeteve pensionale lidhur me virusin Korona. Në Ukrainë, pjesëmarrja e mjeteve monetare dhe depozitave ishte 40,3%, sepse fondet pensionale private investuan më së shumti në instrumente me nivelin minimal të rrezikut. Në shumicën e vendeve të sonduara, investimet në hua, pronë të patundshme, fondet investuese private dhe investimet tjera alternative, përfshijnë pjesëmarrje relativisht të vogël të investimeve të mjeteve pensionale. Pjesëmarrje më të konsiderueshme të investimeve në pronë të patundshme (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta) vërehet për shembull në Kanada (më shumë se 11,9% të mjeteve të përgjithshme) dhe Zvicër (20,1%). Rregullativa për investimet mund të parashikojë edhe kufizime për investim në instrumente jotradicionale. Shumica e vendeve i kufizojnë ose plotësisht i ndalojnë investimet në pronë të patundshme (së paku investime të drejtpërdrejta), fonde private dhe/ose hua.

Disa vende i zvogëluar kufizimet investuese në vitet e fundit dhe kanë inkurajuar investimet në projekte infrastrukturore dhe projekte afatgjata (si p.sh., në Kroaci dhe Rumani). Në Kroaci, me ndryshimet e ligjit të vitit 2014 u zgjeruan mundësitë investuese për fondet e detyrueshme pensionale, për investimet e drejtpërdrejta në projekte infrastrukturore dhe në fondet investuese alternative. Në Rumani, me ndryshimet e rregullativës nga viti 2019, u mundësua investimi i mjeteve të fondeve pensionale në projekte infrastrukturore (deri në 15% të fondeve pensionale). Në Zvicër, nga tetori 2020, u vendos kufizim prej 10% për investimet në infrastrukturë, veçanërisht nga kufizimi prej 15% për investimet alternative, me qëllim për të mundësuar rritjen e ekspozimit të fondeve pensionale ndaj investimeve në infrastrukturë.

Në vitin 2021 u diskutua edhe për investimet e fondeve pensionale në infrastrukturë, me vëmendje edhe në mbikëqyrjen e këtyre investimeve. Dokumenti i publikuar i IOPS e paraqet kornizën rregullatore për investimet e fondeve pensionale në infrastrukturë, i diskuton pengesat për investime të tilla dhe masat e paradokshme rregullatore që synojnë lehtësimin e investimeve në infrastrukturë nga fondet pensionale. Raporti siguron praktika të mira dhe mësimet të nxjerra nga përvojat mbikëqyrëse (të 33 vendeve anëtare të IOPS) në lidhje me investimet në infrastrukturë që zakonisht konsiderohen të jenë komplekse, jolikuide, jotransparente dhe kërkojnë burime shumë solide të aftësive. Në shumicën e vendeve, në rregullativën ose praktikën mbikëqyrëse nuk ekziston definicion konkret për infrastrukturën dhe në shumicën e vendeve, investimet në infrastrukturë nga ana e fondeve pensionale janë subjekt i kufizimeve të përgjithshme të investimeve (siç janë kufizimet sipas klasave të mjeteve, shkallëve të përqendrimit ose vlerësimit të kredisë). Analiza e investimeve dhe mbikëqyrjes së investimeve në infrastrukturë nga fondet pensionale mund të përmirësohet nëse vendoset definim dhe klasifikim i përbashkët i njohur ndërkombëtarisht i infrastrukturës dhe zhvillohet metodologji e përbashkët që do të mundësojë mbledhjen e shumë të dhënave granulare të investimeve (alokacione, performansa). Në përgjithësi, mbikëqyrja e këtyre investimeve kryhet në nivelin e menaxhimit të portofolit të përgjithshëm, kështu që qasja mbikëqyrëse individuale ndaj investimeve në infrastrukturë nuk rekomandohet. Megjithatë, mbikëqyrësit duhet të kenë kujdes për praktikatat e mira të cekura për mbikëqyrje më të mirë të investimeve në infrastrukturë nga ana e fondeve pensionale siç janë: përforsimi i menaxhimit me fondet pensionale me qëllim të promovimit të menaxhimit efektiv me rrezikun investues, vendosja e udhëzimeve mbikëqyrëse për kërkesat e mbikëqyrësit lidhur me çështjet kryesore në investimet (për shembull, vlerësimi, analiza e thellë dhe rreziku nga palët kontraktuese, shfrytëzimi i pjesëmarrësve në tregun për krijimin e mekanizmave për kontroll (për shembull, njoftim i dyfishtë i fondit pensional dhe rojtaret e pronës), etj. Një prej temave kryesore që u diskutuan në vitin 2021, në vazhdim të diskutimeve për digjitalizim dhe zhvillim të teknologjisë në sferën pensionale, ishte qasja mbikëqyrëse për përforsimin e rezistencës kibernetike në sektorin pensional privat. Mbikëqyrësit përsëri u kushtuan vëmendje masave mbikëqyrëse dhe qasjeve në sferën e sigurisë kibernetike, me qëllim për t'i mbledhur përvojat e deritanishme, në drejtim të këshillimit të institucioneve financiare, përfshirë edhe shoqëritë pensionale dhe drejtuesit me fondet pensionale, që të mund t'i zbusin edhe në mënyrë efektive rreziqet kibernetike. Në vitet e fundit, institucionet financiare, përfshirë edhe fondet dhe shoqëritë pensionale private gjithnjë e më shumë janë mbështetur në teknologjitë novatore për zhvillimin e zgjidhjeve të reja të TI-së, gjë që e zmadhoi vëllimin e vullnerabilitetit dhe mundësi për sulme kibernetike. Në vitin 2020, nevoja për zgjidhje digjitale që do të mundësojnë shërbime online dhe ndarje të informacioneve, si dhe puna në distancë përmes kanaleve digjitale u zmadhua me restriktionet për lëvizje të cilat shtetët i vendosën si përgjigje ndaj përhapjes së virusit Korona. Këto gjendje i zmadhuan brengat për siguri, përfshirë edhe kapacitetet e rrjetit virtual për mbështetje të punës në distancë dhe siguri informacioni në qasjen nga shtëpia. Kështu institucionet financiare u bënë goxha të ekspozuara ndaj kërcënimeve dhe sulmeve kibernetike. Shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale ruajnë sasi të mëdha të të dhënave personale dhe mjeteve të të siguruarve, gjë që i bën objektiv tërheqës për sulme kibernetike, megjithëse në një masë më të vogël krahasuar me bankat dhe institucionet tjera të shërbimit të pagesave. Të siguruarit mund të pësojnë dëme që lidhen me keqpërdorimin e të dhënave personale dhe humbjen e mjeteve financiare. Shoqëritë pensionale mund të përballen me sfida operacionale si prishje të proceseve të shërbimeve dhe ndërprerje të aktivitetit afarist, humbje të të dhënave për anëtarët, mospërmblidhje të qëllimeve financiare dhe mospërputhje të detyrës fiduciare. Prandaj, siguria kibernetike është me interes të madh publik dhe kërkon vëmendje të veçantë dhe të shtuar nga mbikëqyrësit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Për këtë dedikim, IOPS shpërndau raport që i identifikon kërcënimet dhe tendencat kryesore kibernetike që lidhen me pensionet private në vitet e fundit dhe gjatë pandemisë me virusin Korona. Raporti përfshin pikëpamjet e mbikëqyrësve dhe praktikatat e menaxhimit për vlerësimin e rrezikut kibernetik nga shoqëritë pensionale dhe drejtuesit e fondeve pensionale dhe identifikon

një sërë fushash që kërkojnë vëmendje të zmadhuar. Raporti ofron gjithashtu gjetje kryesore për rritjen e sigurisë kibernetike në një mjedis të ndikuar nga pandemia me virusin Korona. Mbikëqyrja e bazuar në vlerësim të rreziqeve është temë e vazhdueshme aktuale e IOPS për disa vite radhazi, e kështu, edhe gjatë vitit 2021. Mbikëqyrësit pensional në mbarë botën i monitorojnë sektorët financiarë dhe shkojnë drejt qasjes për mbikëqyrje, të bazuar në vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve, me qëllim për të vepruar në mënyrë proaktive dhe për të parandaluar rreziqet më të mëdha. Ky është një proces që përfshin identifikimin e rreziqeve të mundshme me të cilat përballen fondet pensionale, ose planet, vlerësimin e këtyre rreziqeve dhe ndikimet e mundshme negative financiare tek anëtarët e fondit pensional dhe marrjen e hapave për të zbutur ose eliminuar efektet e këtyre rreziqeve. Një nga qëllimet kryesore të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është sigurimi i menaxhimit të duhur të rrezikut në nivel institucional, duke marrë parasysh cilësinë e menaxhimit të rrezikut dhe saktësinë e vlerësimit të rrezikut. Pavarësisht situatave specifike në qasjen e mbikëqyrjes, në secilin vend individualisht, OECD dhe IOPS konsiderojnë se në fondet pensionale mund të krijohen praktika të përgjithshme të mira të menaxhimit të rrezikut, të cilat do të jenë ndihmë e madhe për mbikëqyrësit e sistemeve pensionale. Në vitin 2020 dhe 2021, një pjesë e aktiviteteve përfshinin përditësimin e mjetit IOPS për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik dhe studimet e rasteve të disa anëtarëve të IOPS, si dhe diskutimin e sfidave të mbikëqyrjes së bazuar në rreziqe përmes vlerësimit të leksioneve të mësuara dhe sfidave lidhur me hartimin, zbatimin, shfrytëzimin dhe revizionin e sistemeve të cilat tashmë praktikojnë mbikëqyrje të bazuar në rreziqe.

## 2

## Struktura e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

---

- 2.1 Përshkrimi i sistemit pensional
- 2.2 Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në sistemin pensional
- 2.3 Institucionet të financimit kapital të sigurimit pensional



## 2. Struktura e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sistemi pensional në Maqedoni paraqet sistem të kombinuar të sigurimit publik, rrjedhshëm i financiar nga privati, sigurim pensional me financim të kapitalit. Sistemi pensional i sigurimit me financim të kapitalit bazohet në parimin e kapitalizimit të kontributeve të paguara në emër dhe përllogari të anëtarit. Karakteristikë për këtë sigurim është se mjetet në të administrohen privatisht dhe kompetitivisht nga ana e shoqërive pensionale. Karakteristikat kryesore të sigurimit pensional me financim të kapitalit janë e drejta e zgjedhjes personale, e drejta e transferit të mjeteve, si dhe sigurimi i shkallës së lartë të transparencës.

Në RMV ekzistojnë tri shoqëri pensionale, të cilat administrojnë me nga një fond të detyrueshëm pensional dhe me nga një fond vullnetar pensional.

### 2.1 Përshkrimi i sistemit pensional

Sistemi pensional maqedonas është pjesë e sigurimit social të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) dhe ka strukturën në vijim:

- Sigurimi mbi bazën e solidaritetit të gjeneratave (d.m.th. shtylla e parë),
- Finansimi kapital i sigurimit të detyrueshëm pensional (d.m.th. shtylla e dytë),
- Finansimi kapital i sigurimit pensional vullnetar (d.m.th. shtylla e tretë).

Kjo strukturë është rezultat i reformës themelore të sistemit pensional, që është përgatitur shumë vite, ndërsa korniza e saj ligjore është vendosur në vitin 2000. Ekzistojnë katër ligje dhe numër i madh i akteve nënligjore që e rregullojnë sistemin pensional në RMV. Ato janë: Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, Ligji për sigurim pensional me finansim kapital, Ligji për sigurim pensional vullnetar me finansim kapital, Ligji për pagesë të pensioneve dhe kompensimeve të pensionit nga finansimi kapital i sigurimit pensional dhe numër më i madh i akteve nënligjore që e përpunojnë në mënyrë shtesë sferën përkatëse. Sistemi pensional në RMV ka histori të gjatë të ekzistimit shumëvjeçar, mbulim të madh të fuqisë punëtore dhe sigurim të pensioneve për personat e siguruar. Por ndryshimet socio-ekonomike në RMV, në fillim të viteve të 90-ta, kishin ndikim në sistemin pensional, i cili u përball me vështirësi financiare në funksionimin e tij. Ato u shkaktuan nga lëvizjet e pafavorshme në ekonomi të cilat ndikuan në uljen e numrit të të siguruarve aktivë dhe uljen e pagesës së kontributeve nga njëra anë dhe rritjen e numrit të pensionistëve nga ana tjetër. Shpenzimet për pensione shënuan rritje të vazhdueshme.

Faktor tjetër që ka ndikim të fuqishëm mbi sistemin pensional është faktori demografik. Gjegjësisht, plakja e popullsisë, gjë që është trend botëror, do të thotë se njerëzit jetojnë gjithnjë më gjatë për shkak të kushteve më të mira dhe shërbimeve më të mira shëndetësore, e njëkohësisht zvogëlohet numri i të porsalindurve, përkatësisht të rinjve. Si rezultat i këtij faktori pjesëmarrja e të moshuarve në popullsinë e përgjithshme është gjithnjë më e madhe.

Lëvizjet e përgjithshme demografike në sistemin pensional shkaktojnë paraqitje të numrit të zmadhuar të pensionistëve dhe shfrytëzim më afatgjatë të pensionit, dhe zvogëlim të numrit të të siguruarve. Për sistem me finansim rrjedhës është i rëndësishëm raporti ndërmjet të të siguruarve dhe pensionistëve, sepse me kontributet nga të siguruarit ekzistues paguhet pensionet për pensionistët ekzistues. Projektionet e aktuarit, të përpunuara gjatë përgatitjes së reformës së sistemit pensional, treguan se mund të pritët që këto faktorë të kenë ndikim të madh negativ mbi solvencën e Fondit të SIPMV-së, në afat të gjatë, përkatësisht pa reforma sistemi do të funksionojë me deficit të shprehur që rritet shpejt dhe dukshëm.

Me qëllim përmbushjen e këtyre situatave të pritura, u realizua reformë themelore të sigurimit pensional dhe invalidor në shtetin tonë, me të cilin u fut sistem pensional treshtyllësh, me mënyrë të kombinuar të finansimit të pensioneve të ardhshme dhe me diversifikimin e rreziqeve demografike dhe ekonomike, me qëllim sigurimin e pensionit të sigurt për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme të pensionistëve dhe stabilitet financiar afatgjatë të sistemit pensional.

Shtylla e parë financohet në bazë rrjedhëse (PAYG), që do të thotë se me kontributet nga të siguruarit ekzistues paguhet pensionet e pensionistëve të tanishëm. Kjo shtyllë funksionon në parimin e a.q. pensione të definuara, përkatësisht përmes tij sigurohen pensione sipas formulës së paracaktuar për përllogaritje të pensionit. Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor, pensionit familjar, si dhe shumica më e ulët e pensionit.



Shtylla e dytë dhe e tretë paraqesin finansim kapital të sigurimit pensional në të cilin bëhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Këto dy shtylla funksionojnë në parimin e a.q. kontribute të definuara, përkatësisht te ato, është paracaktuar niveli i kontributit që paguhet, ndërsa pensioni përcaktohet pastaj, varësisht nga shuma e akumuluar. Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë. Nga shtylla e tretë sigurohet mbrojtja financiare/kompensim gjatë pleqërisë, invaliditetit dhe në rast të vdekjes së të siguruarit.

Me vendosjen e sistemit pensional shumëshyllës si një sistem i kombinuar i sistemit të sigurimit pensional publik, me finansim rrjedhës, privat dhe kapital në RMV, pritet të sigurohet stabilitet afatgjatë i sistemit dhe siguri në realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, përmes realizimit të përfitimeve afatgjate për individët që marrin pjesë në sistemin pensional për vetë sistemin pensional si dhe efekte shtesë në ekonomi. Gjegjësisht, në aspekt të personave individuale sigurohet siguri më e madhe në realizimin e pensionit i cili do të financohet nga disa burime, kështu që bëhet ndarja e rreziqeve. Në të njëjtën kohë, me reformën arrihet transparencë dhe informim më i madh i anëtarëve të fondeve pensionale. Reforma duhet të çojë në vendosjen e sistemit pensional solvent si dhe rritje të kursimeve dhe nxitje të investimit të popullsisë dhe stimulim të rritjes ekonomike.

## 2.2 Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në sistemin pensional

Finansimi kapital i sigurimit pensional dallohet rrënjësisht nga sigurimi i financuar pensional dhe në aspekt të trajtimit dhe evidencës së kontributeve të paguara ashtu edhe në aspekt të përcaktimit dhe pagesës së pensionit. Në këtë sigurim, çdo anëtar ka llogari individuale në të cilën evidentohen pasuritë e tij dhe sigurohet lidhje dhe varësi e ngushtë mes vëllimit të kontributeve të paguara dhe pensioneve të ardhshme që do t'i realizojë çdo person. Kjo mënyrë e sigurimit bazohet në parimin e mjeteve të akumuluar të kontributeve të llogarive individuale, të cilat investohen më tej dhe të ardhurat e realizuara nga investimet, të zvogëluara për shpenzimet e punës së sistemit, në tërësi u shtohen mjeteve të grumbulluara në llogaritë individuale. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale dhe nga jetëgjatësia e pritur gjatë pensionimit, përkatësisht periudha e pritur e shfrytëzimit të pensionit. Është e rëndësishme të theksohet se ky kursim pensional është kursim afatgjatë, gjatë të cilit ka ndodhur rritje graduale, por e vazhdueshme e kursimeve, me ç'rast fillimisht, derisa i siguruari është i ri, kursimet janë të vogla, por në të ardhmen, kur i siguruari arrin moshën e pensionit, kursimet bëhen dukshëm më të mëdha.

Karakteristike për këtë sigurim është ajo që mjetet në të menaxhohen në mënyrë private dhe të vazhdueshme, kështu që kontributet e paguara investohen nga ana e shoqërive të licencuara pensionale që menaxhojnë me fondet pensionale. Në këtë mënyrë, sigurohen qëllimet ekonomike për ta caktuar strategjinë investuese, duke krijuar mundësi për maksimizim të të ardhurave të përgjithshme në interes të anëtarëve. Diversifikimi i rreziqeve të investimeve (përfshirë edhe diversifikimin ndërkombëtar) është një prej karakteristikave më të rëndësishme të këtij sistemi.

Gjithashtu, karakteristika të rëndësishme të finansimit kapital të sigurimit pensional janë e drejta e zgjedhjes personale dhe iniciativa e individit. Të gjithë të punësuarve, para 1 janar 2003, u dha mundësia për të vendosur nëse do të përfshihen në shtyllën e dytë të sistemit pensional dhe të zgjedhin se në cilin fond të detyrueshëm pensional dëshirojnë të anëtarësohen, ndërsa të gjithë të punësuarit e rinj pas datës 1 janar 2003 kishin mundësinë të zgjedhin fond të detyrueshëm pensional sipas zgjedhjes së tyre. Gjithashtu me ndryshimet në Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital nga dhjetori 2018, për anëtarët e fondeve të detyrueshme pensionale të cilët vullnetarisht janë anëtarësuar në shtyllën e dytë (të punësuar për herë të parë para datës 1.1.2003) dhe që kanë lindur para datës 1.1.1967, u dha mundësia të zgjedhin ta ndërpresin ose vazhdojnë anëtarësimin në shtyllën e dytë pensionale. Të gjithë personat e sapopunësuar pas datës 1 janar 2019, të cilët në datën e hyrjes në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor janë nën moshën 40 vjeç, kanë mundësinë të zgjedhin fond të detyrueshëm pensional sipas dëshirës së tyre. Më pas, anëtarësimi në fondet pensionale vullnetare është sipas zgjedhjes personale ose nëpërmjet pjesëmarrjes në skemë pensionale profesionale, të financuar nga punëdhënësi ose nga shoqatë qytetare.

Bartshmëria (portabiliteti) i mjeteve është, gjithashtu, e drejtë e rëndësishme në një sistem të finansimit kapital të sigurimit pensional. Të gjitha anëtarët të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, kanë të drejtën e kalimit nga njëri fond në tjetrin fond pensional, me ç'rast transferohen edhe mjetet e tyre të kursyera. Dhe në rast të pjesëmarrjes në skemën pensionale profesionale, personi ka të drejtë që gjatë kalimit të sigurosi tjetër t'i transferojë mjetet e kursyera ose në skemën tjetër pensionale profesionale ose në llogarinë individuale vullnetare.

Finansimi kapital i sigurimit pensional siguron shkallë të lartë të transparencës që paraqet një prej karakteristikave të tij të rëndësishme dhe risi e dobishme në sistemin pensional. Shoqëritë kanë obligim ligjor, së paku njëherë në vit, t'i informojnë në formë me shkrim anëtarët dhe anëtarët e pensionuar të fondit pensional për gjendjen e mjeteve në llogaritë e tyre individuale, me dorëzim të a.q. "zarf i gjelbër", me raport për kursim pensional. Zarfi i gjelbër, gjithashtu, përmban të dhëna për investimin e fondit pensional për kompensimet e paguara dhe për të ardhurat e realizuara të fondit pensional.

## 2.3 Institucionet e financimit kapital të sigurimit pensional

Institucionet që bëjnë pjesë në sistemin pensional me tre shtylla janë :

- **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale** – kompetentë për krijimin dhe menaxhimin e politikave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe për ushtrimin e kontrollit në zbatimin e legjitimitetit të këtij sigurimi.
- **Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)** – institucion rregullator dhe mbikëqyrës në finansimin kapital të sigurimit pensional. MAPAS paguan kompensim nga shoqëria pensionale që përlogaritet si përqindje e kontributeve të paguara në fondet pensionale. Për vitin 2021, kjo përqindja ishte 0,8%.
- **Shoqëria pensionale** – shoqëri aksionare e themeluar nga institucionet financiare me kapital dhe përvojë të madhe, aktiviteti i vetëm i së cilës është menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale. Në sistemin e njohur pensional ka mundësi për themelimin të tri llojeve të shoqërive:
  - o Shoqëri për menaxhimin me fondet e detyrueshme pensionale,
  - o Shoqëri për menaxhimin me fondet vullnetare pensionale ,
  - o Shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.
- **Rojtari i pronës së fondit pensional** – i ruan në mënyrë të sigurt mjetet e fondit pensional në llogari të veçantë, të veçuara nga mjetet e shoqërisë
- **Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP)** – kryen pagesë të centralizuar të kontributeve dhe në Fondin e SIOMV-së i dorëzon kontributet e përgjithshme për sigurim pensional dhe invalidor.
- **Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut (FSPIMVV)** – kryen shpërndarje të kontributeve për sigurim pensional ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë dhe kryen transferim të kontributeve dhe të dhënave përkatëse për anëtarët, në fondet e zgjedhura të detyrueshme pensionale të shtyllës së dytë. Çdo shoqëri që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional ka për obligim t'i paguajë kompensim mujor Fondit të SIPMV-së në shumë prej 0,1% nga secili kontribut i paguar në muajin paraprak në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon.

Shoqëria pensionale është shoqëri aksionare që themelohet dhe punon në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe Ligjin për sigurim pensional me finansim kapital, ose me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me finansim kapital. Shoqëria pensionale themelohet në bazë të lejes së MAPAS dhe menaxhon me fondin pensional në bazë të lejes për menaxhim me fondin pensional. Shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale themelohet dhe menaxhon vetëm me fondet e detyrueshme pensionale, shoqëria për menaxhim me fondet pensionale vullnetare themelohet dhe menaxhon vetëm me fondet pensionale vullnetare, ndërsa shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare themelohet dhe menaxhon me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe pensionale duhet të ketë kryegjë themelore në lartësi prej së paku 1,8% milionë euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së, shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale duhet të ketë kryegjë themelore prej së paku 1,5 milionë euro dhe shoqëri për menaxhim me fonde pensionale vullnetare duhet të ketë kryegjë themelore prej së paku 0,5 milionë euro. Në rastin e zmadhimit të mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria është e detyruar që ta rrisë kryegjë në pajtim me dispozitat ligjore. Veprimtaria e vetme e shoqërisë pensionale është menaxhimi me fondet pensionale, prezantimi i tyre para personave të tretë dhe aktivitetet të cilat dalin drejtpërdrejt nga kryerja e punës së menaxhimit me fondet pensionale. Përgjegjësitë themelore dhe aktivitetet e shoqërisë pensionale janë: anëtarësimi, menaxhimi me mjetet, menaxhimi me rreziqet dhe mekanizmat kontrolluese për zbutjen e rreziqeve, administrata dhe mbajtja e evidencës, respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore, njoftimi i rregullt i anëtarëve, publikut dhe i MAPAS-it, pagesa e tërheqjeve të programuara të anëtarëve të pensionuara, etj. Shoqëria pensionale punon në pajtim me rregullat për menaxhim të mirë korporativ të shoqërisë dhe ka detyrë fudiciare për të punuar vetëm në dobi të interesave të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondit pensional me të cilin menaxhon, që duhet ta realizojë duke zbatuar standardet e larta të etikës dhe integritetit dhe pa konflikt interesi. Për kryerjen e këtyre funksioneve, shoqëritë pensionale, në pajtim me ligjin paguajnë tre lloje kompensimi. (Më shumë detaje për kompensimet ka në kapitujt 5.7 dhe 6.7.)

Fondi pensional (i detyrueshëm ose vullnetar) paraqet fond të hapur investues i cili themelohet dhe punon në pajtim me Ligjin për fonde investuese, nëse me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me finansim kapital, ose me Ligjin për sigurim pensional me finansim kapital, nuk është rregulluar më ndryshe. Fondi i detyrueshëm pensional përbëhet nga kontributet dhe mjetet e anëtarëve, mjetet e anëtarëve të pensionuar dhe të ardhurat nga kontributet e investuara, të zvogëluara për kompensimet që paguhen nga fondi i detyrueshëm pensional. Fondin pensional vullnetar e përbëjnë kontribute vullnetare të paguara në emër dhe për llogari të anëtarëve, mjeteve të anëtarëve, mjeteve të anëtarëve të pensionuar dhe të ardhurat nga kontributet e investuar dhe mjetet, të zvogëluara për kompensimet që paguhen nga fondi pensional vullnetar. Pronarët e fondit pensional janë anëtarët e tij dhe anëtarët e pensionuar, ndërsa të drejtat e tyre pronësore

individuale janë të caktuara nga shuma e mjeteve në llogaritë e tyre. Mjetet e fondit pensional nuk mund të jenë lëndë e kërkesave, as mbi ato mjete nuk mund të kryhet përmbarim nga, ose në emër të kreditorëve të shoqërisë pensionale që menaxhon me atë fond pensional.

Në vitin 2005 MAPAS-i me tender publik ndërkombëtar lëshoi dy leje për themelimin e shoqërive, me ç'rast u themeluan dy shoqëri për menaxhim me fondet pensionale dhe në vitin 2009 MAPAS-i dy shoqërive ekzistuese për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale u lëshoi leje për kryerjen e veprimtarisë - menaxhim me fondin pensional vullnetar dhe leje për menaxhim me fondin pensional vullnetar. Gjatë vitit 2017 dhe gjysmës së parë të vitit 2018 u realizua procesi i shitjes së shoqërisë aksionare për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Fondi i ri pensional" Shkup përkatësisht u bë transferimi 100% i aksioneve të emetuara nga NLB Fondi i ri pensional SHA Shkup<sup>2</sup> Pozavarovalnica Sava d.d. Lubjana, Republika e Sllovenisë. Në qershor 2018, MAPAS-i lëshoi leje për ndryshimin e emrit të shoqërisë Shoqëria aksionare për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Fondi i ri pensional" Shkup në Shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava shoqëri pensionale sh.a. Shkup, dha leje për ndryshim të emrit të fondit pensional Fondi i hapur i detyrueshëm pensional - "NLB Fondi pensional" Shkup në Fond të hapur pensional vullnetar Sava penzija plus. Në vitin 2019 u themelua shoqëria e tretë pensionale. Gjegjësisht, në fund të muajit mars 2019, MAPAS-i lëshoi leje për themelimin e shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare të Zavarovalnica Triglav DD Lubjana, Republika e Sllovenisë dhe leje për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional dhe leje për menaxhim me fondin pensional vullnetar.

Përfundimisht me 31.12.2021, në RMV, ekzistojnë tre shoqëri pensionale që menaxhojnë me nga një fond të detyrueshëm pensional dhe me nga një fond pensional vullnetar që është paraqitur në tabelën 2.1.

Tabela 2.1 Shoqëritë pensionale dhe Fondet pensionale në RMV

| Shoqëria për administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava Penzisko Drushtvo sh.a. Shkup                                                        | KB Shoqëria e parë për administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare SHA Shkup                                                                                                                                                                            | Shoqëria për administrimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Triglav Penzisko Drushtvo SH.A Shkup                                                 |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| e cila administron me:                                                                                                                                                  | e cila administron me:                                                                                                                                                                                                                                                       | e cila administron me:                                                                                                                                             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>Fondi i hapur i detyrueshëm pensional Sava Penziski Fond</li> <li>Fondi i hapur vullnetar pensional Sava Penzija Plus</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>KB Fondi i parë i hapur i detyrueshëm pensional – Shkup</li> <li>KB Fondi i parë i hapur vullnetar pensional - Shkup</li> </ul>                                                                                                       | <ul style="list-style-type: none"> <li>Triglav fondi i hapur i detyrueshëm pensional – Shkup</li> <li>Triglav fondi i hapur vullnetar pensional – Shkup</li> </ul> |
| Kujdestari i pasurisë së fondeve pensionale: NLB banka SH.A Shkup <sup>3</sup>                                                                                          | Kujdestari i pasurisë së fondeve pensionale: Shparkase Maqedoni SHA Shkup                                                                                                                                                                                                    | Kujdestari i pasurisë së fondeve pensionale: Banka Komerciale SH.A Shkup                                                                                           |
| Aksionar:                                                                                                                                                               | Aksionarë:                                                                                                                                                                                                                                                                   | Aksionar:                                                                                                                                                          |
| - Pozavarovalnica Sava d.d., Republika e Sllovenisë - 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.                                                                        | <ul style="list-style-type: none"> <li>Skupina Prva zavarovalniski holding DD Lubjanë, Republika e Sllovenisë - 51% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë</li> <li>Komercijalna Banka SHA Shkup, Republika e Maqedonisë - 49% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë</li> </ul> | -Zavarovalnica Triglav DD Lubjanë, Republika e Sllovenisë – 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.                                                             |
| Kapitali themeltar:                                                                                                                                                     | Kapitali themeltar:                                                                                                                                                                                                                                                          | Kapitali themeltar:                                                                                                                                                |
| 2,1 milionë euro.                                                                                                                                                       | 1,8 milionë euro.                                                                                                                                                                                                                                                            | 3 milionë euro.                                                                                                                                                    |

Një nga shoqëritë pensionale e ka kombinimin të aksionarëve vendas (49% pjesëmarrje) dhe të huaj (51% pjesëmarrje), ndërsa dy shoqëritë pensionale të tjera kanë aksionar të vetëm të huaj (100% pjesëmarrje). Aksionarët e të tre shoqërive pensionale janë paraqitur në tabelën 2.1.

<sup>2</sup>Aksionarë të Shoqërisë aksionare për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB fond pensional I ri" Shkup ishin Nova Lublanska banka, DD, Republika e Sllovenisë e cila merrti pjesë me 51% në kapitalin e shoqërisë dhe NLB banka SH.A Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut e cila merrti pjesë me 49% në kapitalin e shoqërisë

Njëra prej shoqërive pensionale ka kombinim të aksionarëve vendorë (49% pjesëmarrje) dhe të huaj (51% pjesëmarrje), ndërsa dy shoqëri pensionale kanë aksionar të huaj të vetëm (100% pjesëmarrje). Aksionarët e tre shoqërive pensionale janë cekur në tabelën 2.1.

Mjetet e fondit pensional janë krejtësisht të ndara nga aktivet e shoqërisë që menaxhon me atë fond dhe ruhen te banka rojtar. Ky segregacion i mjeteve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të arritur një shkallë të lartë të sigurisë së mjeteve dhe kontroll shtesë të transaksioneve me mjetet e fondit pensional. Funkcionin - rojtar i pronës, edhe për fondet e detyrueshme pensionale edhe për ato vullnetare, e kryejnë bankat komerciale që i plotësojnë kushtet ligjore dhe me të cilat shoqëria ka lidhur marrëveshje për ruajtje të pronës së fondeve pensionale. Të tre shoqëritë pensionale kanë përzgjedhur rojtar pronash për të dy fondet pensionale me të cilat menaxhojnë, siç është paraqitur në tabelën 2.1. Për funksionin e tij të ruajtjes së pronës të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, rojtarët e pronës paguajnë kompensim nga shoqëritë pensionale. Kompensimet përllogariten si përqindje të mjeteve të fondeve pensionale, në përputhje me marrëveshjet e lidhura për ruajtjen e pronës së fondeve pensionale. Në tabelën 2.2. është dhënë pasqyrë e kompensimeve që i paguajnë rojtarët e pronës nga shoqëritë pensionale në vitin 2021.

Tabela 2.2. Shumat që i arkëtojnë kujdestarët e pasurisë nga shoqëritë pensionale kompetent për ruajtjen e pasurisë së fondeve pensionale

| Për fondet e detyruara pensionale                          | Shuma (në nivel vjetor) | Për shumën e mjeteve (në milionë euro) | Data e zbatimit |
|------------------------------------------------------------|-------------------------|----------------------------------------|-----------------|
| Shparkase Makedonija SHA Shkup si rojtar i pronës së KBPD  |                         | 0,034%                                 | 3 tetor 2020 r. |
|                                                            |                         | 0,032%                                 | 3 tetor 2021 r. |
|                                                            |                         | 0,030%                                 | 3 tetor 2022 r. |
| NLB Banka SHA Shkup si rojtar i pronës së SAVAd            | 0,058%                  | deri 100                               | 4 prill 2019    |
|                                                            | 0,055%                  | mbi 100 mbi 200                        |                 |
|                                                            | 0,050%                  | mbi 200 deri 300                       |                 |
|                                                            | 0,048%                  | mbi 300 deri 400                       |                 |
|                                                            | 0,040%                  | mbi 400 deri 500                       |                 |
|                                                            | 0,037%                  | mbi 500 deri 600                       |                 |
|                                                            | 0,035%                  | mbi 600 deri 700                       |                 |
|                                                            | 0,032%                  | mbi 700 deri 800                       |                 |
|                                                            | 0,029%                  | mbi 800 deri 900                       |                 |
|                                                            | 0,025%                  | mbi 900 deri 1000                      |                 |
| Banka Komerciale SHA Shkup si rojtar i pronës së TRIGLLAVd | 0,024%                  | mbi 1000                               | 1 prill 2019    |
|                                                            | 0,050%                  | deri 50                                |                 |
|                                                            | 0,041%                  | mbi 50 deri 100                        |                 |
|                                                            | 0,038%                  | mbi 100 deri 200                       |                 |
|                                                            | 0,035%                  | mbi 200 deri 300                       |                 |
|                                                            | 0,033%                  | mbi 300 deri 400                       |                 |
|                                                            | 0,028%                  | mbi 400 deri 500                       |                 |
|                                                            | 0,026%                  | mbi 500 deri 600                       |                 |
|                                                            | 0,025%                  | mbi 600 deri 700                       |                 |
|                                                            | 0,023%                  | mbi 700 deri 800                       |                 |
| Fondet pensionale vullnetare                               | 0,020%                  | mbi 800 deri 900                       | 1 prill 2019    |
|                                                            | 0,018%                  | mbi 900 deri 1000                      |                 |
|                                                            | 0,017%                  | deri 1000                              |                 |
|                                                            |                         |                                        |                 |
|                                                            |                         |                                        |                 |
|                                                            |                         |                                        |                 |
|                                                            |                         |                                        |                 |
|                                                            |                         |                                        |                 |
|                                                            |                         |                                        |                 |
|                                                            |                         |                                        |                 |
| Shparkase Makedonija SHA Shkup si rojtar i pronës së KBPv  |                         | 0,06%                                  | 3 tetor 2018    |
|                                                            |                         |                                        |                 |
| NLB Banka SHA Shkup si rojtar i pronës së SAVAv            | 0,180%                  | deri 50                                | 4 prill 2019    |
|                                                            | 0,144%                  | mbi 50                                 |                 |
| Banka Komerciale SHA Shkup si rojtar i pronës së TRIGLLAVv | 0,050%                  | deri 50                                | 1 prill 2019    |
|                                                            | 0,041%                  | mbi 50 deri 100                        |                 |
|                                                            | 0,038%                  | mbi 100 deri 200                       |                 |
|                                                            | 0,035%                  | mbi 200 deri 300                       |                 |
|                                                            | 0,033%                  | mbi 300 deri 400                       |                 |
|                                                            | 0,028%                  | mbi 400 deri 500                       |                 |
|                                                            | 0,026%                  | mbi 500 deri 600                       |                 |
|                                                            | 0,025%                  | mbi 600 deri 700                       |                 |
|                                                            | 0,023%                  | mbi 700 deri 800                       |                 |
|                                                            | 0,020%                  | mbi 800 deri 900                       |                 |
|                                                            | 0,018%                  | mbi 900 deri 1000                      |                 |
|                                                            | 0,017%                  | mbi 1000                               |                 |

# 3

Ndryshimet dhe plotësimet e akteve ligjore  
dhe nënligjore që rregullojnë financimin  
kapital të sigurimit pensional



# Ndryshimet dhe plotësimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë financimin kapital të sigurimit pensional

Në drejtim të avancimit dhe saktësisht ose thjeshtimit të procedurave të caktuara në vitin 2021, u miratuan ndryshime të rregulloreve që i rregullojnë sferat e licencimit, anëtarësimit në shtyllën e dytë dhe shtyllën e tretë, investimit të mjeteve të fondeve pensionale, etj.

Ndërkaq, u rregullua mundësia për lidhje digjitale të marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm/vullnetar pensional dhe mundësia për komunikim elektronik ndërmjet shoqërive pensionale dhe MAPAS-it. Pastaj, në drejtim të rritjes së numrit të instrumenteve të lejuara për investim dhe zgjerim të universumit investues, u zvogëluan kufizime të caktuara për investim të mjeteve të fondeve pensionale, u zvogëlua niveli i rejtingut të kërkuar kreditor për cilësi të të gjithë instrumenteve dhe u përcaktua niveli më i ulët i rejtingut në kufijtë e ligjit, përkatësisht rejtingut të rekomandueshëm për investim sipas agjencive të rejtingut kreditor ndërkombëtar. Me këtë ndryshim u zgjeruan mundësitë për investim në instrumentet plotësuese në RMV dhe në shtete anëtare të OECD-së ose BE-së.

Gjatë vitit 2021 u miratuan nga një ndryshim të Ligjit për sigurim pensional me finansim kapital, Ligjit për sigurim pensional vullnetar me finansim kapital dhe Ligjit për pagesën e pensionave dhe kompensimeve pensionale të sigurimit pensional me finansim kapital. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2021, Këshilli i Ekspertëve i MAPAS-it miratoi nëntë rregullore, përkatësisht ndryshime të rregulloreve që kanë të bëjnë me sigurimin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar me finansim kapital.

Gjegjësisht, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi tre ndryshime të ligjeve që kanë të bëjnë me financimin kapital të sigurimit pensional dhe atë:

1. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me finansim kapital ("Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 103/2021 nga 10.5.2021),
2. Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional vullnetar me finansim kapital ("Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 103/2021 nga 10.5.2021) dhe
3. Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për pagesë të pensioneve dhe kompensimeve pensionale të sigurimit pensional me finansim kapital gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 103/2021 nga 10.5.2021)

Me ndryshimet e ligjeve u bë harmonizimi me Ligjin për kundërvajtjet, përkatësisht u zvogëluan gjobat dhe u parapa dallim në shqiptimin e gjobave. U saktësua edhe kompetenca e gjykatës dhe e Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje, për udhëheqjen e procedurës dhe për shqiptimin e sanksioneve për kundërvajtje.

Gjatë vitit 2021 MAPAS-i përgatiti ndryshime dhe plotësime të akteve nënligjore ekzistuese që kanë të bëjnë me sigurimin pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar dhe atë:

1. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për licencimin e shoqërive pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 98/2021 nga 4.5.2021);
2. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën dhe procedurën e dhënies së lejeve për ndryshimet në dokumentet e parashtruara gjatë licencimit ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 160/2021, nga 14.7.2021);
3. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së anëtarit të Këshillit të Drejtorëve dhe Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 160/2021, nga 14.7.2021);
4. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 212/2021, datë 10.9.2021);
5. Rregullore për ndryshimin e Rregullores për anëtarësim në fondin pensional vullnetar ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 212/2021, nga 10.9.2021);
6. Rregullore për ndryshimin e Rregullores për mënyrën dhe procedurën e marketingut të fondeve pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 253/2021, nga 11.11.2021);
7. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për investimin e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 274/2021, datë 10.12.2021);
8. Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për investimin e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 274/2021 nga 10.12.2021);
9. Rregullore për formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 5/2022 nga 5.1.2022);



Ndryshimet në rregullore u bënë për saktësimin e procedurave të caktuara dhe harmonizim me ndryshimet e akteve përkatëse. Me ndryshimin e Rregullores për licencimin e shoqërive pensionale u hap mundësia që personat juridikë që kanë përvojë në menaxhimin e mjeteve në kuptimin e gjerë të fjalës (fondet investuese, bankat dhe institucionet tjera financiare) të përfshihen në tregun e menaxhimit me fondet pensionale. Me ndryshimin e Rregullores për mënyrën dhe procedurën e dhënies së lejeve për ndryshimet e dokumenteve të parashtruara gjatë licencimit dhe Rregullores për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së anëtarit të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë pensionale dhe Rregullores për mënyrën dhe procedurën e marketingut të fondeve pensionale u bë harmonizimi i dispozitave të këtyre rregulloreve me Ligjin për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime konfidenciale. Në këtë mënyrë, komunikimi ndërmjet shoqërive pensionale dhe MAPAS-it përshpejtohet në procesin e informimit të MAPAS-it dhe në këtë mënyrë përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i proceseve. Më pas, me ndryshimet në Rregulloren për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional dhe në Rregulloren për anëtarësim në fondin pensional vullnetar, u përcaktua mundësia e lidhjes digjitale të kontratës për anëtarësim në fondin pensional të detyrueshëm/vullnetar dhe u mundësua që komunikimi ndërmjet shoqërisë pensionale dhe MAPAS-it të bëhet edhe në formë elektronike në përputhje me Ligjin për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime Konfidenciale. Me ndryshimin e Rregullores për investimin e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare dhe Rregullores për investimin e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale, u reduktuan kufizimet për investimin e mjeteve të fondeve pensionale me qëllim të rritjes së numrit të instrumenteve të lejuara për investim dhe zgjerim të universumit investues. Gjithashtu u zvogëlua niveli i vlerësimit të kërkuar të kredisë për cilësinë e të gjitha instrumenteve dhe u përcaktua niveli më i ulët i vlerësimit brenda kufijve të ligjit, përkatësisht vlerësimit të rekomanduar për investim sipas agjensioneve ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë. Me këtë ndryshim zgjerohen mundësitë për investime në shtetet tjera anëtare të OECD-së ose të BE-së. Me miratimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje u përcaktua forma dhe përmbajtja e urdhërpagesës për kundërvajtje në procedurën e barazimit të cilën e zbatojnë personat e autorizuar të Agjensionit.

Gjatë vitit 2021 MAPAS-i i azhurnoi udhëzimet ekzistuese dhe përgatiti të reja, dhe i miratoi udhëzimet në vijim:

1. Udhëzimi për shfrytëzimin e portalit për këmbim të dokumenteve ndërmjet shoqërive pensionale dhe MAPAS-it (maj 2021);
2. Udhëzimi teknik për definimin e formateve të të dhënave dhe këmbim të datotekave për Modulin Kontribute në finansimin kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional (prill 2021);
3. Udhëzimi teknik për definimin e formateve të të dhënave dhe këmbim të skedarëve për Modulin Anëtarësimi në finansimin kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional (prill 2021);



## Të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionale

# 4

Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2021 4.1

Rezultati financiar i shoqërive pensionale 4.2

Kapitali, kapitali themeltar dhe mjetet individuale të shoqërive pensionale 4.3

Indikatorët 4.4

## Të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionale

Shoqëria pensionale Sava sh.a. Shkup dhe KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup dhe në vitin 2021, realizuan rezultat financiar pozitiv. Të dyja shoqëritë pensionale e mbaruan vitin 2021 me fitim neto dhe realizuan fitim gjithëpërfshirës total dhe atë, Shoqëria pensionale Sava sh.a. Shkup në shumë prej afro 106 milionë denarë dhe KB Shoqëria e parë pensionale SHA Shkup në shumë prej afro 160 milionë denarë. SHOQËRIA PENSIONALE TRIGLLAV SHA Shkup shënon rezultat financiar negativ edhe në vitin e tretë të punës së saj. Fondet pensionale me të cilat menaxhon kjo shoqëri disponojnë me numër relativisht të vogël të anëtarëve dhe mjetet janë me vëllim më të vogël gjë që ndikon në shumën më të vogël të të ardhurave nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër ka shpenzime të konsiderueshme për menaxhim me shoqërinë dhe fondet.

### 4.1 Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2021

Për kryerjen e veprimtarisë së vetme - menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale, shoqëritë pensionale financohen përmes kompensimeve të përcaktuara me ligj, përkatësisht paguajnë kompensim të kontributeve, kompensim të mjeteve të fondeve pensionale dhe kompensim për kalim. Gjithashtu, shoqëritë pensionale kanë edhe të ardhura financiare si rezultat i investimit të mjeteve të lira monetare në depozita dhe letra me vlerë, të cilat lejohen në përputhje me Ligjin për sigurim vullnetar pensional me finansim kapital. Të ardhurat e tre shoqërive pensionale për vitin 2021 janë dhënë në tabelën 4.1

(në denarë)

Tabela 4.1. Të ardhurat e shoqërive pensionale në vitin 2021

| Arsyeja e arkëtimit                                                 | SAVA        |         | KB e para   |         | TRIGLAV    |         |
|---------------------------------------------------------------------|-------------|---------|-------------|---------|------------|---------|
| Shpenzime për menaxhimin me fondin e detyruar pensional             |             |         |             |         |            |         |
| Shuma që arkëtohen nga kontributet                                  | 89.020.848  | 31,25%  | 96.444.642  | 29,78%  | 8.271.749  | 45,55%  |
| Shuma që arkëtohen nga mjetet                                       | 159.814.930 | 56,10%  | 181.009.705 | 55,90%  | 6.910.074  | 38,05%  |
| Shuma që arkëtohen nga transferimi                                  | 925         | 0,00%   | 2.776       | 0,00%   | 6.548      | 0,04%   |
| Totali i të ardhurave të menaxhimit të fondit të detyruar pensional | 248.836.703 | 87,35%  | 277.457.123 | 85,68%  | 15.188.371 | 83,64%  |
| Të ardhura nga menaxhimi i fondit vullnetar pensional               |             |         |             |         |            |         |
| Shuma që arkëtohen nga kontributet                                  | 4.572.944   | 1,61%   | 5.824.524   | 1,80%   | 51.404     | 0,28%   |
| Shuma që arkëtohen nga mjetet                                       | 12.572.735  | 4,41%   | 11.580.706  | 3,58%   | 5.741      | 0,03%   |
| Shuma që arkëtohen nga transferimi                                  | 1.232       | 0,00%   | 0           | 0,00%   | 0          | 0,00%   |
| Totali i të ardhurave të menaxhimit të fondit vullnetar pensional   | 17.146.911  | 6,02%   | 17.405.230  | 5,37%   | 57.145     | 0,31%   |
| Të ardhura financiare                                               | 17.659.611  | 6,20%   | 28.598.931  | 8,83%   | 2.361.392  | 13,00%  |
| Të ardhura të tjera të shoqërisë                                    | 1.217.900   | 0,43%   | 358.094     | 0,11%   | 551.659    | 3,04%   |
| Totali i të ardhurave                                               | 284.861.125 | 100,00% | 323.819.378 | 100,00% | 18.158.567 | 100,00% |

(në denarë)

Tabela 4.2. Shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2021

| Arsyeja e arkëtimit                                            | SAVA       |        | KB e para  |        | TRIGLAV    |        |
|----------------------------------------------------------------|------------|--------|------------|--------|------------|--------|
| Shpenzime për menaxhimin me fondin e detyruar pensional        |            |        |            |        |            |        |
| Shpenzime për agjentët e shoqërisë                             | 1.180.164  | 0,70%  | 1.267.809  | 0,87%  | 7.723.842  | 13,65% |
| Shpenzime për marketing                                        | 15.019.723 | 8,95%  | 10.733.387 | 7,33%  | 4.844.331  | 8,56%  |
| Shpenzime për transaksione                                     | 103.216    | 0,06%  | 0          | 0,00%  | 0          | 0,00%  |
| Shpenzime për MAPAS                                            | 35.588.836 | 21,21% | 38.557.046 | 26,32% | 3.312.371  | 5,86%  |
| Shpenzime për Kujdestarin e pasurisë                           | 14.619.672 | 8,71%  | 16.842.777 | 11,50% | 971.443    | 1,72%  |
| Shpenzime për Fondin SPIM                                      | 4.417.063  | 2,63%  | 4.820.001  | 3,29%  | 403.739    | 0,71%  |
| Shpenzime të tjera nga menaxhimi me Fondin                     | 1.155.327  | 0,69%  | 1.211.330  | 0,83%  | 1.223.181  | 2,16%  |
| Shpenzime totale për menaxhimin me fondin e detyruar pensional | 72.084.001 | 42,97% | 73.432.350 | 50,12% | 18.478.907 | 32,67% |

|                                                                        |                    |                |                    |                |                   |                |
|------------------------------------------------------------------------|--------------------|----------------|--------------------|----------------|-------------------|----------------|
| Shpenzime për menaxhimin me fondin vullnetar pensional                 |                    |                |                    |                |                   |                |
| Shpenzime për agjentët e shoqërisë                                     | 4.221.540          | 2,52%          | 1.818.198          | 1,24%          | 19.769            | 0,03%          |
| Shpenzime për marketing                                                | 815.631            | 0,49%          | 868.747            | 0,59%          | 12.399            | 0,02%          |
| Shpenzime për transaksione                                             | 68.406             | 0,04%          | 0                  | 0,00%          | 0                 | 0,00%          |
| Shpenzime për MAPAS                                                    | 1.532.823          | 0,91%          | 1.714.967          | 1,17%          | 11.406            | 0,02%          |
| Shpenzime për Kujdestarin e pasurisë                                   | 2.286.216          | 1,36%          | 772.843            | 0,53%          | 1.032             | 0,00%          |
| Shpenzime të tjera nga menaxhimi me Fondin                             | 62.389             | 0,04%          | 389.448            | 0,27%          | 3.131             | 0,01%          |
| <b>Shpenzime në total për menaxhimin me fondin vullnetar pensional</b> | <b>8.987.005</b>   | <b>5,36%</b>   | <b>5.564.203</b>   | <b>3,80%</b>   | <b>47.737</b>     | <b>0,08%</b>   |
| Shpenzime për menaxhimin me shoqërinë                                  |                    |                |                    |                |                   |                |
| Pagesa dhe kompensime për punonjësit                                   | 52.521.787         | 31,31%         | 37.268.570         | 25,44%         | 18.847.988        | 33,32%         |
| Shpenzime për shërbimet                                                | 14.250.045         | 8,49%          | 7.363.414          | 5,03%          | 11.721.608        | 20,72%         |
| Shpenzime për lëndë të para dhe materiale të tjera                     | 1.338.622          | 0,80%          | 946.891            | 0,65%          | 691.502           | 1,22%          |
| Amortizimi                                                             | 2.159.548          | 1,29%          | 4.080.690          | 2,79%          | 3.106.868         | 5,49%          |
| Shpenzime financiare                                                   | 1.759.228          | 1,05%          | 10.860.912         | 7,41%          | 0                 | 0,00%          |
| Shpenzime të tjera të punës                                            | 13.865.381         | 8,27%          | 6.635.793          | 4,53%          | 4.303.244         | 7,61%          |
| Rezervime për shpenzime dhe rrezeqe                                    | 793.899            | 0,47%          | 355.470            | 0,24%          | -632.177          | -1,12%         |
| <b>Shpenzime në total nga menaxhimi me shoqërinë</b>                   | <b>86.688.510</b>  | <b>51,67%</b>  | <b>67.511.740</b>  | <b>46,08%</b>  | <b>38.039.033</b> | <b>67,25%</b>  |
| <b>Shpenzime në total</b>                                              | <b>167.759.516</b> | <b>100,00%</b> | <b>146.508.293</b> | <b>100,00%</b> | <b>56.565.677</b> | <b>100,00%</b> |

\* Për shpenzimet të dhënat që nuk mund të ndahen sipas fondit të detyruar dhe vullnetar pensional, shoqëria pensionale si ponder për ndarje e përdor numrin e anëtarëve në fondin e detyruar, përkatësisht vullnetar pensional.

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre të vetme, shoqëritë pensionale kanë shpenzime, në përgjithësi, për menaxhimin e mjeteve të fondeve pensionale, për vlerësimin e mjeteve, për anëtarësimin, mbajtjen e llogarive të anëtarëve dhe për njoftimin e anëtarëve, si dhe për pagesën e kompensive për MAPAS-in, për Fondin SIPMV-ja dhe për rojtarin e pronës dhe për mbulimin e shpenzimeve lidhur me funksionimin e shoqërive pensionale. Shpenzimet e shoqërive pensionale ndahen në tri grupe: shpenzimet për menaxhimin e fondit të detyrueshëm pensional, shpenzimet për menaxhimin e fondit pensional vullnetar dhe shpenzimet për menaxhimin e shoqërisë. Shpenzimet e tre kompanive pensionale në vitin 2021 janë paraqitur në tabelën 4.2.


Në kuadër të anës të ardhurave dhe te SAVA dhe KB Prvo vërehet rritje të të ardhurave të përgjithshme në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 dhe atë me rreth 10% te SAVA dhe 13% te KB Prvo. Gjithashtu, pjesa më e madhe e të ardhurave të SAVA dhe KB Prvo, në vitin 2021, rrjedh nga kompensimet e mjeteve nga fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (rreth 61% te SAVA dhe 59% te KB Prvo), me ç'rast vijon kompensimi nga kontributet në fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (rreth 33% në SAVA dhe 32% në KB Prvo). Lidhur me vitin paraprak, pjesëmarrja në përqindje e të ardhurave nga kompensimet nga kontributet, në të ardhurat e përgjithshme, edhe te të dyja shoqëritë pensionale është ulur për rreth dy pikë përqindje te SAVA dhe rreth tre pikë përqindje te KB Prvo. Rrjedhimisht, përqindja e të ardhurave nga kompensimi i mjeteve është rritur rreth katër pikë përqindje edhe te SAVA edhe te KB Prvo. Lidhur me vitin 2020, pjesëmarrja në përqindje e të ardhurave financiare te SAVA është ulur me rreth një pikë përqindje, ndërsa te KB Prvo mbetet afërsisht në të njëjtin nivel. Pjesëmarrja në përqindje e të ardhurave tjera të shoqërive është më e vogël (më pak se 1%) te të dyja shoqëritë pensionale.

Në kuadër të anës së shpenzimeve në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 edhe te SAVA edhe te KB Prvo vërehet rritje e shpenzimeve të përgjithshme dhe atë rreth 10% te SAVA dhe rreth 12% te KB Prvo. Gjithashtu te SAVA pjesa më e madhe e shpenzimeve përkatësisht rreth 52% e shpenzimeve kanë të bëjnë me punën e shoqërisë në të cilat pjesa më e madhe janë shpenzimet për rroga dhe kompensime për të punësuarit, me ç'rast vijnë shpenzimet për shërbime dhe shpenzimet tjera të punës. Te KB Prvo në vitin 2021 shpenzimet që kishin të bëjnë me punën e shoqërisë janë rreth 46%. Përsëri pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve kanë të bëjnë me shpenzimet për rroga dhe kompensimet për të punësuarit, pastaj me shpenzimet financiare dhe shpenzimet për shërbime. 54% të shpenzimeve të KB Prvo kanë të bëjnë me shpenzimet për menaxhim me fondet pensionale. Te SAVA shpenzimet për menaxhim me fondet pensionale ishin rreth 48%. Pastaj, shpenzimet për marketing dhe agjentë janë rreth 13% të shpenzimeve të përgjithshme te SAVA dhe rreth 10% të shpenzimeve të përgjithshme te KB Prvo, që në krahasim me vitin paraprak do të thotë se janë rritur për dy pikë përqindje te SAVA dhe për tri pikë përqindje te KB Prvo. Rreth 35% të shpenzimeve te SAVA dhe 43% të shpenzimeve te KB Prvo kanë të bëjnë me kompensimet për MAPAS, Fondin e SIPMV-së dhe për rojtarët e pronës.


TRIGLLAV filloi me aktivitetet e menaxhimit të fondeve pensionale dhe me punë të marketingut të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar dhe anketimin e opinionit publik nga 1.4.2019. Fondi pensional vullnetar Trigllav - Shkup filloi me punë më 1.3.2021. Është i dukshëm dallimi në shumat dhe shpërndarjet në bazë të të ardhurave dhe shpenzimeve lidhur me SAVA dhe KB Prvo të cilat punojnë gjashtëmbëdhjetë vite. Te TRIGLLAV në anën e të ardhurave pjesëmarrje më të madhe kanë të ardhurat nga kompensimi i kontributeve, përkatësisht rreth 46% e të ardhurave të përgjithshme. Të ardhurat nga kompensimi

i mjeteve kanë pjesëmarrje më të ulët prej rreth 38%. Kjo gjithashtu edhe pritet, sepse në vitet e para të punës së fondit, mjetet e fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar janë me vëllim më të vogël. Pastaj, të ardhurat financiare prej rreth 13% në të ardhurat e përgjithshme të TRIGLLAV, ndërsa pjesëmarrje më të ulët të të ardhurave tjera (rreth 3%). Lidhur me shpenzimet, pjesa më e madhe e shpenzimeve përkatësisht rreth 67% e shpenzimeve kanë të bëjnë me punën e shoqërisë, ku më të mëdha janë shpenzimet për rroga dhe kompensimet për të punësuarit, pas së cilës vijojnë shpenzimet për shërbime dhe shpenzimet tjera të punës. Shpenzimet për menaxhim me fondet pensionale janë rreth 33%. Gjithashtu shpenzimet për marketing dhe agjentë arrijnë në rreth 33%. Rreth 8% e shpenzimeve kanë të bëjnë me tarifat për MAPAS, Fondi i SIPMV dhe për rojtarët e pronës dhe rreth 14% janë shpenzime tjera të menaxhimit me fondet pensionale.

Grafiku 4.1. Struktura e të ardhurave të shoqërive për vitet 2020 dhe 2021



Grafiku 4.2. Struktura e shpenzimeve të shoqërive për vitet 2020 dhe 2021



## 4.2 Rezultati financiar i shoqërive pensionale

SAVA dhe KB Prvo edhe në vitin 2021, realizuan rezultat financiar pozitiv. Të dy shoqëritë pensionale e përfunduan vitin 2021 me fitim neto (fitimi pas tatimit). KB Prvo ka realizuar fitim më të madh neto nga SAVA, gjë që më së shumti është si rezultat i faktit se KB Prvo ka realizuar të ardhura më të larta, e njëkohësisht ka edhe më pak shpenzime se SAVA, për vitin 2021. Të dy shoqëritë pensionale, në vitin 2021 shënojnë fitim më të madh neto në krahasim me vitin 2020 dhe atë, SAVA për vitin 12% dhe KB Prvo për 14%. Gjithashtu, të dyja shoqëritë pensionale realizuan fitim të përgjithshëm dhe atë SAVA në shumë prej 106 milionë denarë dhe KB Prvo në shumë prej rreth 160 milionë denarë. Fitimi i akumuluar (përfundimisht me 31.12.2021) i SAVA është rreth 500 milionë denarë dhe e KB Prvo është rreth 613 milionë denarë. TRIGLLAV shënon rezultat financiar negativ edhe në vitin e tretë të punës së tyre. Në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon TRIGLLAV ende janë anëtarë një numër relativisht i vogël i anëtarëve dhe mjetet janë në vëllim të vogël gjë që ndikon në shumën më të vogël të të ardhurave nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër ka shpenzime të dukshme për shkak të mirëmbajtjes së infrastrukturës së shoqërisë dhe të punësuarve, për shkak të shpenzimeve për marketing, si dhe shpenzimeve rrjedhëse për menaxhim me fondin. Gjithashtu, fondi pensional vullnetar me të cilin menaxhon TRIGLLAV punon vetëm dhjetë muaj dhe disponon me numër relativisht të vogël të anëtarëve dhe vëllim të vogël të mjeteve. Të dhëna më të hollësishme për rezultatin financiar të shoqërive pensionale janë paraqitur në tabelën 4.3.

Tabela 4.3. Rezultati financiar i shoqërive pensionale për vitin 2021

(në denarë)

| Përshkrimi*                                                   | SAVA        | KB e para   | TRIGLLAV    |
|---------------------------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|
| Fitimi/Humbja (për vitin 2021)                                | 117.102.000 | 177.311.000 | -38.407.000 |
| Fitimi/Humbja pas tatimit (për vitin 2021)                    | 109.470.000 | 159.659.000 | -38.407.000 |
| Shpenzime të çrregullta                                       | 0           | 0           | 0           |
| Fitimi neto (për vitin 2021)                                  | 109.470.000 | 159.659.000 | -38.407.000 |
| Fitimi tjetër gjithëpërfshirës **                             | -3.510.000  | 0           | 0           |
| Fitimi total gjithëpërfshirës ***                             | 105.960.000 | 159.659.000 | -38.407.000 |
| Fitimi i akumuluar/ Humbja e transferuar (deri më 31.12.2021) | 499.015.000 | 612.880.000 | -51.302.000 |

\*Të dhënat për fitim tjetër gjithëpërfshirës dhe për fitim të përgjithshëm gjithëpërfshirës janë nga raportet e rishikuara financiare të shoqërive pensionale për vitin 2021.

\*\*Të dhënat për fitimin tjetër gjithëpërfshirës përfshijnë fitimet e përfundimtare ose humbjet që nuk janë paraqitur në bilancin e suksesit.

\*\*\*Të dhëna për përfitimin total gjithëpërfshirës përfshin fitimin neto dhe fitimin tjetër gjithëpërfshirës.

## 4.3 Kapitali, kapitali themeltar dhe mjetet individuale të shoqërive pensionale

Është shumë e rëndësishme që sistemi dhe anëtarët e shoqërive pensionale të jenë institucione të fuqishme dhe të qëndrueshme dhe të kenë kryegjë themelore adekuate. Të tre shoqëritë pensionale duhet të kenë kryegjë themelore në lartësi prej së paku 1,8 milionë euro, në kundërvlerë me denarë, sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të RMV-së. Në rast të rritjes së mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe/ose vullnetar, me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria është e detyruar që ta rrisë kryegjënë, në pajtim me dispozitat ligjore.

Kryegjëja themelore e shoqërisë pensionale paguhet vetëm në mjete monetare. Me qëllim për ta rritur fuqinë financiare të shoqërisë pensionale, nuk lejohet që kryegjëja themelore të rrjedhë nga huat dhe kreditë dhe nuk mund të ngarkohet në çfarëdo mënyre. Kryegjëja themelore e shoqërisë doemos duhet të rrjedhë nga burimet ligjore dhe të tatimohet në pajtim me rregullat e RMV-së dhe me rregullat e vendit në të cilin çdo aksionar i huaj është themeluar si person juridik.

Shoqëria është e detyruar që në çdo kohë, ta mbajë shumën e kryegjësë por jo më pak se një gjysmë të shumës së kryegjësë themelore. Shoqëria është e detyruar që në çdo kohë, të mbajë mjete personale, në shumë jo më të vogël se një gjysmë e shumës së kryegjësë themelore.

Tabela 4.4. Kapitali, kapitali themeltar dhe mjetet e shoqërive pensionale

(në denarë)

| Përshkrimi                                                          | SAVA        | KB e para   | TRIGLAV     |
|---------------------------------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|
| Kapitali dhe rezervat                                               | 686.062.786 | 766.930.266 | 94.744.722  |
| Kapitali themeltar                                                  | 130.001.478 | 110.459.024 | 184.483.800 |
| Kapitali shtesë mbi minimumin e përcaktuar me ligj                  | 13,61%      | 24,46%      | 71,17%      |
| Mjetet individuale*                                                 | 601.707.613 | 710.020.125 | 80.648.643  |
| Mjete shtesë (excess) individuale mbi minimumin e caktuar me ligj** | 126,77%     | 130,45%     | 45,71%      |

\*Mjetet e shoqërive janë përlogarit sipas Rregullores për metodologjinë e përlogaritjes së mjeteve individuale të shoqërisë pensionale.

\*\* Në përputhje me obligimin juridik, SAVA, që nga shkurti 2021, është e detyruar të mbajë kryegjë të rritur lidhur me kryegjë të themelore, përkatësisht kryegjë në shumë prej 8,8 milionë euro në kundërvlerë me denarë, për shkak se lartësia e mjeteve të fondit pensional detyrueshëm dhe vullnetar me të cilin menaxhon e tejkaloi shumën prej 700 milionë euro. Pastaj, që nga nëntori i vitit 2021, ai është i detyruar të mbajë kryegjë të rritur lidhur me kryegjë të themelore, përkatësisht kryegjë në shumë prej 9,8 milionë euro në kundërvlerë me denarë, për shkak se lartësia e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me të cilin menaxhon, e tejkaloi shumën prej 800 milionë eurosh.

KB Prvo, që nga marsi 2021, është i detyruar të mbajë kryegjë të rritur lidhur me kryegjë të themelore, përkatësisht kryegjë në shumë prej 9,8 milion euro në kundërvlerë me denarë, për shkak se lartësia e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me të cilin menaxhon e tejkaloi shumën prej 800 milionë eurosh. Pastaj, KB Prvo, nga nëntori 2021, është i detyruar të mbajë kryegjë të rritur lidhur me kryegjë të themelore, përkatësisht kryegjë në shumë prej 10 milionë euro në kundërvlerë me denarë, për shkak se lartësia e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, me të cilat menaxhon e tejkaloi shumën prej 900 milionë eurosh.

## 4.4 Indikatorët

Gjatë analizës së të dhënave financiare të shoqërive pensionale është e rëndësishme lëvizja e treguesve të caktuar për anëtar si dhe koeficienti për efikasitet. Në tabelën 4.5 janë paraqitur treguesit më të rëndësishëm për anëtar dhe koeficienti për efikasitet të të tre shoqërive pensionale për vitin 2021.

Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat mesatare për anëtar shënojnë rritje prej 8% te SAVA, 11% te KB Prvo edhe te TRIGLLAV prej 10%. Më pas, në krahasim me vitin 2020, shpenzimet mesatare për anëtar shënojnë rritje prej 8% te SAVA dhe 10% te KB Prvo, ndërsa te TRIGLLAV shënojnë ulje prej 21%. Ndërkaq, te të dy shoqëritë që punojnë më shumë se gjashtëmbëdhjetë vite ka rritje të fitimit për anëtar lidhur me vitin 2020 në shumë prej 9% te SAVA dhe 12% te KB Prvo. Gjithashtu vihet re se koeficienti për efikasitetin të të dyja shoqëritë tregon ulje të vogël krahasuar me vitin 2020. Në vitin 2021, TRIGLLAV shënon rënie të humbjes për anëtar prej rreth 31% krahasuar me vitin 2021, njëkohësisht edhe koeficienti i efikasitetit tregon përfaqësim të madh të shpenzimeve të përgjithshme lidhur me të ardhurat e përgjithshme.

Në grafikun 4.3 dhe tabelën është paraqitur lëvizja e indikatorëve për leverdi ROA (fitimi neto/mjete të përgjithshme), krahasuar me SAVA dhe KB Prvo, për periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2021 dhe për TRIGLLAV për periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2021. Mund të vërehet se në vitin 2021, në krahasim me vitin 2020, shkalla e kthimit të mjeteve shënon rritje te SAVA dhe KB Prvo. Shkalla e kthimit të kapitalit në vitin 2021, në krahasim me vitin 2020 te SAVA shënon rritje të vogël, ndërsa te KB Prvo shënon ulje të vogël. Koeficienti ROA dhe ROE për TRIGLLAV janë negativë dhe në vitin 2021 (-39% ROA dhe -41% ROE).

Tabela 4.5. Indikatorët

(në denarë)

| Përshkrimi                                                              | SAVA     | KB e para | TRIGLAV   |
|-------------------------------------------------------------------------|----------|-----------|-----------|
| Indikatorët për të ardhurat dhe shpenzimet për çdo anëtar               |          |           |           |
| Të ardhura mesatare për çdo anëtar                                      | 1.081,60 | 1.137,32  | 602,11    |
| Shpenzime mesatare për çdo anëtar                                       | 636,98   | 514,57    | 1.875,64  |
| Fitimi/Humbja për çdo anëtar                                            | 444,63   | 622,75    | -1.273,53 |
| Indikatorët e efikasitetit                                              |          |           |           |
| Koeficienti i efikasitetit (totali i shpenzime / totali i të ardhurave) | 58,89%   | 45,24%    | 311,51%   |

Grafiku 4.3. ROA dhe ROE sipas shoqërive dhe viteve




Tabela 4.6. Indikatorë për profitabilitet

| Shoqëri Pensionale<br>Viti / Përshkrim | SAVA   |        | KB e para |        | TRIGLAV |         |
|----------------------------------------|--------|--------|-----------|--------|---------|---------|
|                                        | ROA    | ROE    | ROA       | ROE    | ROA     | ROE     |
| 2006                                   | -0,60% | 0,00%  | -2,69%    | -4,45% |         |         |
| 2007                                   | 4,97%  | 5,57%  | 7,19%     | 10,19% |         |         |
| 2008                                   | 18,66% | 20,55% | 21,30%    | 28,53% |         |         |
| 2009                                   | 15,09% | 16,26% | 21,80%    | 26,54% |         |         |
| 2010                                   | 16,66% | 17,60% | 20,24%    | 23,00% |         |         |
| 2011                                   | 14,09% | 14,75% | 20,02%    | 22,03% |         |         |
| 2012                                   | 15,21% | 15,84% | 20,84%    | 22,31% |         |         |
| 2013                                   | 18,88% | 19,68% | 22,71%    | 23,80% |         |         |
| 2014                                   | 13,94% | 15,09% | 22,35%    | 23,71% |         |         |
| 2015                                   | 14,77% | 15,65% | 20,20%    | 21,00% |         |         |
| 2016                                   | 16,34% | 17,34% | 20,23%    | 21,09% |         |         |
| 2017                                   | 16,35% | 17,23% | 22,89%    | 23,78% |         |         |
| 2018                                   | 16,79% | 17,49% | 22,96%    | 23,71% |         |         |
| 2019                                   | 13,70% | 14,26% | 20,52%    | 21,24% | -10,99% | -11,55% |
| 2020                                   | 14,13% | 15,43% | 19,66%    | 21,29% | -23,13% | -24,18% |
| 2021                                   | 15,38% | 15,96% | 22,46%    | 20,82% | -38,77% | -40,54% |



## 5 Informacione për fondet e detyruara pensionale

---

- 5.1 Anëtarësimi në fondet e detyruara pensionale
- 5.2 Të dhëna për anëtarësim në fondet e detyruara pensionale
- 5.3 Transferimi i një anëtar nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër
- 5.4 Kontributet në fondet e detyrueshme pensionale
- 5.5 Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve të detyrueshme pensionale
- 5.6 Mjetet neto, njësia llogaritare dhe shkalla e kontributit të fondeve të detyrueshme pensionale
- 5.7 Kompensimet tek fondet e detyrueshme pensionale
- 5.8 Pagesa e pensioneve nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital

## 5. Informacione për fondet e detyruara pensionale të detyrueshme

Numri total i anëtarëve dhe i të siguarve të shpërndarë përkohësisht në shtyllën e dytë, përfundimisht me vitin 2021 është 550.477, që do të thotë rritje për afro 3,87% krahasuar me vitin 2020. Rritja e anëtarësisë në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 e mban rritjen e njëjtë të ngadalësuar si vitin e kaluar. Lëvizja në trendin e kalimeve të anëtarëve nga njëri në tjetrin fond të detyrueshëm pensional që u nxit me fillimin e punës së fondit të tretë të detyrueshëm pensional në vitin 2019 vazhdoi në vitin 2021

Gjatë vitit 2021 në fondet e detyrueshme pensionale u transferuan kontributet në shumë prej afro 9,68 miliardë denarë. Krahas kontributeve, Fondi i SIPMV-së transferoi gjithsej afro 162 milionë denarë si kompensim për transferim jo në kohë të kontributeve për anëtarët për të cilët nuk i ka transferuar kontributet në llogaritë e fondeve të zgjedhura të detyrueshme pensionale në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kontributeve.

Si rezultat i rritjes së kontributeve të arkëtuara dhe rezultateve financiare, mjetet totale të fondeve të detyrueshme pensionale në vitin 2021 u rritën për 21% dhe arritën 105,66 miliardë denarë, gjë që paraqet afro 14,61% të PBV-së së RMV-së. Struktura e portofolit investues të fondeve të detyrueshme pensionale nuk dallohet dukshëm krahasuar me vitin e kaluar dhe përbëhet nga investime vendore që përfshijnë letra shtetërore me vlerë (59,87%), depozita (6,82%), aksione (2,89%), pjesëmarrje në fonde investuese (0,27%) dhe obligacione korporative (0,02%), si dhe investime jashtë vendit që përfshijnë pjesëmarrje të fondeve investuese (25,57%) dhe aksione (4,13%).

Në vitin 2021 vlera e njësisë kontabël ishte më e qëndrueshme lidhur me lëvizjet në vitin 2020 që u shkaktuan nga gjendjet e pavolitshme të tregjeve financiare në kushte të pandemisë me virusin Korona. Në fund të vitit, vlera e njësisë kontabël të SAVAd shënoi rritje prej 9,53% krahasuar me vitin 2020, të KPBD rritje prej afro 10,85%, ndërsa të TRIGLLAVD rritje prej 8,32%.

Në nivel të shtyllës së dytë, në periudhën shtatëvjeçare 2015 - 2021, janë realizuar të ardhura mesatare të reduktuar në nivelin vjetor prej 5.91% në shumë nominale, përkatësisht 4.41% në shumë reale, të llogaritura përmes ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësisë kontabël të fondeve të detyrueshme pensionale.

Në vitin 2021 u realizuan pensione dhe pagesa për 442 anëtarë të shtyllës së dytë.

### 5.1 Anëtarësimi në fondet e detyruara pensionale

I siguruari mund të fitojë anëtarësi në fondin e detyrueshëm pensional në dy forma:

1) me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësi në fondin e detyrueshëm pensional dhe me regjistrimin në Regjistrin e anëtarëve që e mban MAPAS,

2) me shpërndarjen në fondin e detyrueshëm pensional sipas zgjedhjes së rastësishme nga ana e Fondit të SPIM, në rast kur i siguruari, që është i detyruar të bëhet anëtar i fondit pensional të detyruar nuk ka nënshkruar marrëveshje anëtarësie në periudhën e zgjedhjes së fondit të detyruar pensional dhe me regjistrimin në Regjistrin e anëtarëve që e mban MAPAS.

Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me finansim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 245/2018 nga 28.12.2018 dhe nr. 180/2019 nga 2.9.2019) parashohin disa ndryshime esenciale lidhur me anëtarësimin në sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital të cilat janë të vlefshme nga 1.1.2019.

Gjegjësisht, ekzistojnë dy kategori të të siguarve që janë anëtarë në shtyllën e dytë:

- Anëtarë të detyrueshëm –

- o të siguarit që janë punësuar, përkatësisht që janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, për herë të parë pas 1 janarit 2003 dhe që janë lindur pas 1 janarit 1967;

- o të siguarit që janë punësuar, përkatësisht në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, për herë të parë pas 1 janarit 2019 dhe të cilat në datën e anëtarësimit janë më të rinj 40 vite

- Anëtarë vullnetarë –

- o të siguarit që janë punësuar për herë të parë para 1 janarit 2003 të cilat sipas zgjedhjes personale me lidhje të marrëveshjes për anëtarësim janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital dhe që kanë lindur pas 1 janarit 1967;

- o të siguarit që janë punësuar për herë të parë, para 1 janarit 2003, të cilat sipas zgjedhjes personale me lidhje të marrëveshjes për anëtarësim janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital, kanë lindur para 1 janarit 1967 e që kanë nënshkruar deklaratë për vazhdimin e anëtarësisë në sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital.


Të siguruarit të cilëve stazhi i sigurimit u llogaritet me kohëzgjatje të shtuar dhe të siguruarit që përkasin në kapitullin VII – “Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të caktuara të të siguruarve nën kushte të veçanta të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor” (të punësuarit me stazh të beneficuar në MPB, shtëpitë korrigjuese-penale, ARM dhe ngjashëm) nuk përfshihen në shtyllën e dytë, nëse kanë stazh të mbushur të sigurimit me kohëzgjatje të shtuar, që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizim të të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vjet. Kur të siguruarit që janë anëtarë të fondit të detyrueshëm pensional do të mbushin stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar që mundëson uljen e kufirit të pleqërisë për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit në përputhje me nenin 118 paragrafi (3) i Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, kanë të drejtë të zgjedhin për ta vazhduar anëtarësimin në shtyllën e dytë me deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësimin në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej tre muajsh nga mbushja e stazhit të sigurimit. Nëse këta anëtarë nuk japin deklaratë me shkrim, u ndërpritet anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional pas skadimit të këtij afati.

## 5.2 Të dhëna për anëtarësim në fondet pensionale të detyrueshme

Të siguruarit që janë anëtarë të detyrueshëm në finansimin kapital të sigurimit pensional janë të detyruar të anëtarësohen në fondin e detyrueshëm pensional, në afat prej tre muajsh, llogaritur nga data e punësimit të parë. Fondi i SIPMV-së, i sistemon përkohësisht këto të siguruar në fondet e detyrueshme pensionale, sipas zgjedhjes së rastit, nga momenti i punësimit të tyre, me qëllim mjetet e tyre të investohen menjëherë pas punësimit. Nëse në afatin ligjor nuk nënshkruajnë kontratë për anëtarësim me asnjë shoqëri, këto të siguruar mbeten anëtarë të fondit të detyrueshëm pensional në të cilin janë sistemuar përkohësisht paraprakisht.

Ponderi, sipas të cilit bëhet sistemimi i përkohshëm i të siguruarve në fondet e detyrueshme pensionale sipas zgjedhjes së rastit, përcaktohet nga ana e MAPAS-it për secilin fond të detyrueshëm pensional, në ditën e parë të punës të secilit muaj. Ponderi varet nga vlera e kompensimit nga kontributet që e paguan shoqëria pensionale dhe nga të ardhurat në shumën minimale që e ka realizuar fondi pensional, me ç'rast ndikim më të madh kanë të ardhurat (70%) në krahasim me kompensimin nga kontributet (30%). Ponderët që janë shfrytëzuar për sistemim të të siguruarve në fondet e detyrueshme pensionale, gjatë vitit 2021, janë paraqitur në grafikun 5.1.

Grafiku 5.1. Ponder për shpërndarjen e anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme



Më datë 1.4.2019 filloi me punë fondi i detyrueshëm pensional TRIGLAVd, me çka duke filluar nga muaji prill 2019 të siguruarit shpërndahen në tre fonde të detyrueshme pensionale. Me qëllim për të mbështetur punën në vitet fillestare të punës së fondit të detyrueshëm pensional, e në pajtim me dispozitat e definuara në rregullativën, nëse fondi i detyrueshëm pensional punon më pak se 12 muaj si vlerë për të ardhura (për shkak të përlogaritjes së ponderit) merret mesatarja e të ardhurave në shumë minimale të fondeve të detyrueshme ekzistuese pensionale. Pastaj, nëse fondi punon më pak se 36 muaj, e më shumë se 12 muaj, atëherë vlera për të ardhura (për shkak të përlogaritjes së ponderit) merret vlera më e madhe ndërmjet: të ardhurave në shumë nominale të fondit të detyrueshëm pensional dhe mesatarja e të ardhurave në shumë nominale të të gjithë fondeve të detyrueshme pensionale duke përfshirë edhe të ardhurat në shumë nominale të fondit të detyrueshëm pensional. Ky parim i shpërndarjes së të siguruarve është i arsyetuar për nxitjen e konkurrencës në finansimin kapital të sigurimit pensional, me qëllim të rritjes së zgjedhjes së fondeve pensionale për anëtarët dhe të

nxiten rezultate më të mira investuese të fondeve pensionale. Duke marrë parasysh faktin se gjatë vitit 2021 tre shoqëritë pensionale paguanin kompensim të kontributeve në shumën e njëjtë, në shumën e ponderit më së shumti ndikuan shumën e të ardhurave të realizuara të fondeve të detyrueshme pensionale. Gjegjësisht, në vitin 2021, ponderi i TRIGLLAVd është më i vogël në krahasim me SAVAd dhe KBPd sepse në përlogaritjen e ponderit për të ardhurat e TRIGLLAVd merret mesatarja e të ardhurave në shumë nominale të të gjitha tre fondeve të detyrueshme pensionale. Pastaj gjatë gjithë vitit 2021, vlera e ponderit të KBPd është më pak më e madhe (mesatarisht për një pikë përqindje) në krahasim me vlerën e ponderit të SAVAd.


Numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe të siguruarve të shpërndarë përkohësisht në fondet e detyrueshme pensionale, përfundimisht me 31 dhjetor 2021 është 550.477 që do të thotë rritje të numrit të anëtarëve në shtyllën e dytë për 20.494 ose për afro 3,87% në krahasim me vitin 2020. Rritja e anëtarësisë në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 e mban rritjen e njëjtë të ngadaltë si dhe vitin e kaluar.

Në lidhje me shpërndarjen e anëtarësisë në fondet e detyrueshme pensionale, është e pritur që edhe në vitin 2021 numri më i madh i të siguruarve të jenë anëtarë të SAVAd dhe KBPd. Do të thotë, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe të siguruarve të shpërndarë përkohësisht në fondet e detyrueshme pensionale, me gjendje më 31.12.2021, 49% janë në KBPd, 46% janë në SAVAd dhe 5% janë në TRIGLLAVd. Pastaj lidhur me vitin 2020 vërehet pjesëmarrje më e vogël në përqindje të anëtarësisë edhe në SAVAd dhe në KBPd (për rreth një pikë përqindje), përkatësisht pjesëmarrje më e madhe në përqindje të anëtarësisë në TRIGLLAVd (për rreth dy pikë përqindje).

Nga numri i përgjithshëm i shtyllës së dytë, 62.403 ose 11% janë anëtarë vullnetarë, ndërsa 488.074 ose 89% janë anëtarë të detyrueshëm. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të detyrueshëm, 177.204 anëtarë kanë nënshkruar kontratë për anëtarësim, 281.347 nuk kanë nënshkruar kontratë dhe janë sistemuar përgjithmonë dhe 29.523 të siguruar janë sistemuar përkohësisht. Në vitin 2021 vërehet rritje e numrit të të siguruarve të rinj që kanë nënshkruar kontratë për anëtarësim. Gjegjësisht, mund të vërehet se edhe në vitin 2021 rreth 15% e të siguruarve që kanë obligim të anëtarësohen në fondin e detyrueshëm pensional në vitin 2021 dhe për të cilat ka skaduar afati për zgjedhje të fondit të detyrueshëm pensional, kanë nënshkruar kontratë për anëtarësim, ndërsa të tjerët, rreth 85% nuk kanë nënshkruar kontratë dhe kanë mbetur në fundin ku kanë qenë të sistemuar më parë.

Në strukturën e anëtarëve dhe të siguruarve të sistemuar përkohësisht sipas statusit të anëtarësisë, në vitin 2021 për SAVAd dhe KBPd nuk kanë ndodhur disa ndryshime të papritura dhe të rëndësishme. Struktura e anëtarëve dhe të siguruarve të sistemuar përkohësisht sipas statusit të anëtarësisë, në vitin 2021 është e ngjashme me SAVAd dhe KBPd. Ndërkaq mund të vërehet se në çdo tremujor, pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve vullnetarë zvogëlohet, ndërsa pjesëmarrja e anëtarëve të detyrueshëm rritet, gjë që është edhe e pritur, sepse çdo vit rritet vëllimi i anëtarëve të detyrueshëm. Gjithashtu, mund të vërehet se pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve të detyrueshëm të cilat kanë nënshkruar kontratë për anëtarësim, gradualisht zvogëlohet nga tremujori në tremujor për dallim nga pjesëmarrja e anëtarëve të detyrueshëm të cilët janë shpërndarë përgjithmonë, gjë që rritet gradualisht nga tremujori në tremujor. Struktura e anëtarëve dhe të siguruarve të sistemuar përkohësisht sipas statusit të anëtarësisë së TRIGLLAVd dallohet në krahasim me SAVAd dhe KBPd, gjë që është edhe e pritur, sepse TRIGLLAVd punon më pak se tre vite. Mund të vërehet se në vitin 2020 në TRIGLLAVd më e madhe është pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve të detyrueshëm të cilët janë sistemuar dhe pastaj vijon pjesëmarrja në përqindje e të siguruarve të sistemuar përkohësisht. Në tremujorët vijues rritet gradualisht pjesëmarrja edhe e anëtarëve të detyrueshëm që kanë nënshkruar kontratë për anëtarësim megjithëse në mënyrë minimale gradualisht rritet edhe pjesëmarrja e anëtarëve vullnetarë. Anëtarët vullnetarë në TRIGLLAVd janë të siguruarit që kanë nënshkruar kontratë për kalim nga SAVAd ose KBPd në TRIGLLAVd. Gjithashtu, në tremujorët vijues rritet pjesëmarrja në përqindje e anëtarëve të detyrueshëm të cilët janë të sistemuar, ndërsa zvogëlohet pjesëmarrja e të siguruarve të sistemuar përkohësisht. Struktura e anëtarëve dhe e të siguruarve të sistemuar përkohësisht në fondet e detyrueshme pensionale dhe sipas statusit të anëtarëve në vitin 2021 është paraqitur në nivel tremujor, në grafikën 5.2.


Grafiku 5.2. Struktura e anëtarëve dhe të të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarësisë në FPD




Analiza e strukturës së anëtarëve sipas moshës tregon se anëtarët, në numrin më të madh janë persona të rinj. Anëtarët e detyrueshëm janë persona të rinj, me ç'rast 77% e anëtarëve të detyrueshëm janë në moshë deri në 40 vjet, ndërsa anëtarët vullnetarë janë pak më të rritur dhe 77% e tyre janë në moshë deri në 50 vjet. Mosha mesatare e anëtarëve të detyrueshëm është 34 për meshkuj dhe 35 për femra, ndërsa e anëtarëve vullnetarë është 47 vjet (edhe për meshkuj edhe për gra), ndërsa e të gjithë anëtarëve, gjithsej është 36 vjet. Struktura e anëtarëve të sistemit pensional dyshtyllësh sipas moshës, gjinisë dhe kategorisë së anëtarësimit është paraqitur në grafikun 5.3.

Sipas të dhënave të ESHS, në fund të vitit 2021 numri i përgjithshëm i popullsisë e aftë për punë<sup>3</sup> në RMV është 1.682.799, ndërsa popullsia e përgjithshme aktive<sup>4</sup> është 943.004. Me gjendje në fund të vitit 2021, rreth 33% e popullsisë së përgjithshme të aftë për punë në RMV janë anëtarë të sistemit dyshtyllësh, përkatësisht rreth 58% e popullsisë së përgjithshme aktive në RMV janë anëtarë të sistemit pensional dyshtyllësh. Struktura e anëtarëve në sistemin pensional dyshtyllësh, në popullsinë e përgjithshme e aftë për punë dhe popullsinë aktive në RMV, sipas grupmoshave dhe sipas gjinisë, me gjendje më 31.12.2021, është paraqitur në grafikun 5.4. Mund të vërehet se përqindje e konsiderueshme (mbi 74%) e popullsisë aktive në moshë nga 15 deri 49 vjet është përfshirë në sistemin pensional dyshtyllësh.

Grafiku 5.3. Struktura e anëtarëve të sistemit pensional me dy shtylla sipas moshës, gjinisë dhe kategorisë së anëtarësimit



Grafiku 5.4. Struktura e anëtarëve në sistemin pensional me dy shtylla në popullsinë e përgjithshme dhe popullsinë aktive sipas grupmoshave dhe gjinisë




Burimi : MAPAS dhe Enti shtetëror statistikor – popullata aktive në RMV Rezultatet e Anketës së fuqisë puntore, 2021

<sup>3</sup>Popullata e aftë për punë – e përbëjnë të gjithë personat nga moshja 15 deri në 79 vjeç.

<sup>4</sup>Popullatë ekonomikisht aktive – e përbëjnë të gjithë të punësuarit dhe të papunët.

Në pajtim me të dhënat e Fondit të SIPMV për numrin e të siguruarve përfundimisht me 31.12.2021, rreth 96% të numrit të përgjithshëm të të siguruarve në Fondin e SIPMV janë anëtarë të sistemit pensional dyshtyllësh. Në grafikën 5.5. mund të shihet rritja e pjesëmarrjes së anëtarëve në sistemin pensional dyshtyllësh në numrin e përgjithshëm të të siguruarve në Fondin e SIPMV nga Fillimi i punës së shtyllës së dytë.


Grafiku 5.5. Pjesmarja e anëtarëve në sistemin pensional në dy shtylla në të siguruarit në Fondin SPIM sipas viteve 2006-2021



Burimi: MAPAS dhe fondi SPIM

Struktura e anëtarëve në fondet e detyrueshme pensionale, sipas rajoneve statistikore<sup>5</sup> në RMV është dhënë në grafikun 5.6. Më së shumti anëtarë edhe në tre fondet e detyrueshme pensionale ka nga Rajoni i Shkupit. Më së paku anëtarë në SAVAd ka nga rajoni i verilindor, më së paku anëtarë në KBPd ka nga rajoni juglindor, e më së paku anëtarë në TRIGLLAVd ka në rajonin juglindor.

Grafiku 5.6. Struktura e anëtarëve në shtyllën e dytë sipas rajoneve statistikore



<sup>5</sup>Rajonet statistikore janë definuar sipas Entit shtetëror të statistikave – njësitë territoriale. Nomenklatura e njësive territoriale bazohet në organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë dhe është harmonizuar me klasifikimin e Bashkimit Evropian

### 5.3 Transferimi i një anëtarë nga një fond i detyrueshëm pensional në një tjetër

Çdo anëtar i fondit të detyrueshëm pensional ka të drejtë të kalojë në fond tjetër të detyrueshëm pensional nëse nuk është i kënaqur nga fondi i detyrueshëm pensional ku është anëtar, përkatësisht nga shoqëria që menaxhon me të. Nëse personi ka qenë anëtar në fondin e detyrueshëm pensional më pak se 24 muaj, gjatë kalimit, ai është i detyruar që të paguajë kompensim për kalim. Nëse personi ka qenë anëtar në ndonjë fond më gjatë se 24 muaj, atëherë kalimi në fond tjetër është falas.

Në tabelën 5.1. janë dhënë të dhëna për numrin e anëtarëve që kanë kaluar nga njëri fond në tjetrin fond të detyrueshëm pensional dhe për shumën e mjeteve të bartura nga njëri në tjetrin fond të detyrueshëm pensional, gjatë vitit 2021.


Tabela 5.41 Transferimet e anëtarëve nga një fond pensional i detyruar në një tjetër

| 2021                                                                     |          | Anëtarët që kanë kaluar NË një fond i detyruar pensional dhe mjete që janë transferuar NË një fond i detyruar pensional (në denarë) |            |               |               |
|--------------------------------------------------------------------------|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|---------------|---------------|
|                                                                          |          | SAVAd                                                                                                                               | KBPd       | TRIGLAVd      | Totali        |
| Anëtarët që kanë kaluar NGA një fond i detyruar pensional                | SAVAd    | -                                                                                                                                   | 91         | 2.848         | 2.939         |
|                                                                          | KBPd     | 125                                                                                                                                 | -          | 3.167         | 3.292         |
|                                                                          | TRIGLAVd | 3                                                                                                                                   | 5          | -             | 8             |
|                                                                          | Totali   | 128                                                                                                                                 | 96         | 6.015         | 6.239         |
| Mjetet që janë transferuar NGA një fond i detyruar pensional (në denarë) | CABA3    | -                                                                                                                                   | 36.698.580 | 623.236.491   | 659.935.071   |
|                                                                          | KBPd     | 29.752.874                                                                                                                          | -          | 705.050.958   | 734.803.832   |
|                                                                          | TRIGLAVd | 1.174.753                                                                                                                           | 1.147.414  | -             | 2.322.167     |
|                                                                          | Totali   | 30.927.627                                                                                                                          | 37.845.994 | 1.328.287.449 | 1.397.061.070 |

Lëvizja në trendin e kalimeve të anëtarëve nga një fond në tjetrin fond të detyrueshëm pensional që u nxit me fillimin e punës së fondit të tretë të detyrueshëm pensional në vitin 2019, vazhdoi edhe në vitin 2021. Gjatë vitit 2021, numri i përgjithshëm i anëtarëve në fondet e detyrueshme pensionale, të cilët kanë kaluar nga një fond në tjetrin fond të detyrueshëm pensional, është 6239, që përbën 1,13% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Edhe pse përqindja e anëtarëve që kanë bërë ndryshim në fondin e detyrueshëm pensional në numrin e përgjithshëm të anëtarëve është ende e vogël, megjithatë në vitin 2021, numri i anëtarëve që kanë bërë ndryshim në fondin e detyrueshëm pensional është dukshëm më i lartë krahasuar me vitin 2020. Ndërkaq, 128 anëtarë kaluan në SAVAd, 96 në KBPd dhe 6,015 anëtarë kaluan në TRIGLLAVd. Gjatë kalimit, në SAVAd janë transferuar rreth 31 milionë denarë, në KBPd janë transferuar rreth 38 milionë denarë dhe në TRIGLLAVd janë transferuar rreth 1,34 miliardë denarë

Në grafikun 5.7 është dhënë pasqyrë e të gjitha kalimeve të anëtarëve nga njëri fond në tjetrin fond të detyrueshëm pensional nga viti 2008 deri në vitin 2021.

Grafiku 5.7. Transferimi i një anëtarë nga një fond i detyruar pensional në tjetër, në vite 2008-2021






## 5.4 Kontributet në fondet e detyrueshme pensionale

Pagesa e kontributeve për sigurimin pensional dhe invalidor e bën debitori për pagimin e kontributit, përkatësisht punëdhënësi në emër të të punësuarit. Drejtoria e të ardhurave publike bën pagesën e integruar të kontributeve nga sigurimi i detyruar social (kontribut për sigurimin pensional dhe invalidor, kontribut për sigurimin shëndetësor dhe kontribut për punësim në rast papunësie) dhe tatimin personal mbi të ardhurat.

Grafiku 5.8. Paraqitja skematike e pageses dhe shpërndarja e kontributeve



Për të siguruarit që marrin pjesë në sistemin njëshpyllësh, kontributi i përgjithshëm i paguar mbetet në Fondin e SIPMV-së (për vitin 2021 ishte 18,8% e pagës bruto). Për personat e siguruar që përfshihen në sistemin dyshtyllësh, Fondi i SIPMV kryen shpërndarjen e kontributit të paguar ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë. Masa e kontributit, që transferohet në fondin e detyrueshëm pensional, është 6% e pagës bruto dhe në Fondin e SIPMV-së mbetet kontributi në lartësinë që fitohet si dallim ndërmjet kontributit të përgjithshëm për sigurimin pensional dhe invalidor dhe kontributit të paguar në fondin e detyrueshëm pensional (për vitin 2021, ishte 12,8% e pagës bruto (12,8% = 18,8% - 6%).

Menjëherë dhe jo më vonë se pesë ditë pune nga pranimi i kontributeve, Fondi SIPMV-së i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë individuale në fondet e zgjedhura të detyrueshme pensionale, me kusht që në afatin e njëjtë të jenë të pranuar edhe të dhënat e duhura në përputhje me ligjin, që i mundësojnë Fondit të SIPMV-së ta kryejë atë obligim. Nëse FSIPMV nuk i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të zgjedhura të detyrueshme pensionale menjëherë dhe jo më vonë se pesë ditë pune nga dita e pranimi të kontributeve për shkak të mungesës së të dhënave adekuate, Fondi i SIPMV-së është i detyruar që në afat jo më gjatë se tre muaj nga dita e pranimi të kontributeve të sigurojë të dhëna të përshtatshme dhe të bëjë transferimin e kontributeve të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në fondet e zgjedhura të detyrueshme pensionale të rojtari i pronës. Më pas, Fondi i SIPMV-së dorëzon të dhënat të shoqëritë dhe MAPAS-i për transferimin e kryer të kontributeve.

Gjatë vitit 2021, në fondet e detyrueshme pensionale janë transferuar kontribute në vlerë prej rreth 9,68 miliardë denarë, që paraqet rreth 1,34% të PBV-së së RMV-së. Kontributet e përgjithshme të paguara në fondet e detyrueshme pensionale në vitin 2021 janë rritur për 4,69% krahasuar me kontributet e përgjithshme të paguara në vitin 2020. Kontributet e detajuara të paguara sipas muajve (në milionë denarë) janë paraqitur në tabelën 5.2.

Tabela 5.2. Kontributet e pagura në shtyllën e dytë


(në milione denare)

|          | Gjithsej<br>2020 | Jan. | Feb. | Mar. | Prill | Maj | Qer. | Korr. | Gusht | Shat. | Tet. | Nen. | Dhjet. | Totali<br>2021 |
|----------|------------------|------|------|------|-------|-----|------|-------|-------|-------|------|------|--------|----------------|
| SAVAd    | 4.328            | 272  | 370  | 362  | 359   | 380 | 358  | 415   | 355   | 356   | 359  | 377  | 486    | 4.449          |
| KBPd     | 4.710            | 299  | 403  | 392  | 391   | 410 | 388  | 447   | 384   | 386   | 388  | 408  | 525    | 4.820          |
| TRIGLAVd | 211              | 19   | 26   | 27   | 28,48 | 31  | 33   | 39    | 35    | 37    | 38   | 42   | 59     | 413            |
| Totali   | 9.249            | 590  | 799  | 780  | 778   | 822 | 779  | 901   | 774   | 779   | 785  | 827  | 1.070  | 9.682          |

Në grafikun 5.9. janë paraqitur kontributet e përgjithshme (në milionë denarë), të paguara në shtyllën e dytë, çdo muaj, nga fillimi i punës së finansimit kapital të sigurimit të detyrueshëm pensional deri më 31.12.2021 dhe numri i përgjithshëm i anëtarëve, në fund të çdo muaji në periudhën e njëjtë.

Mund të vërehet se, në përgjithësi me rritjen e numrit të anëtarëve, rriten edhe kontributet e paguara në fondet e detyrueshme pensionale (megjithëse trendi i pagesave nuk është plotësisht linear, por ka disa rënie dhe rritje më të mëdha në muaj të caktuar). Rritjet më të mëdha të kontributeve të paguara në muajt në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2019 janë ndoshta për shkak të kontributeve të paguara për të siguruarit të cilat nuk janë shpërndarë në kohë në shtyllën e dytë. Zvogëlimi i gjendjes së anëtarësisë në muajin e parë të vitit 2019 është si rezultat i ndërprerjes së anëtarësimit të kategorive të caktuara të të siguruarve më 1.1.2019 në pajtim me ndryshimet e ligjit.

Grafiku 5.9. Kontribute të pagura dhe anëtarë në shtyllën e dytë



Burimi për PBV: ESHS- Njoftim – prodhimi bruto vendor, tremujori i katërt i vitit 2021 – të dhëna të vlerësuara.

## 5.4.1 Kompensim për vonesë të transferit të kontributeve

Ndryshimet në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me finansim kapital nga 28.12.2018 parashikojnë obligim të Fondit të SIPMV-së për të paguar kompensim për transferimin jo në kohë të kontributeve në rast se Fondi SIPMV-së nuk i ka sistemuar të siguruarit që kanë qenë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë në përputhje me kriteret para miratimit të ndryshimeve të ligjit, në rast nëse Fondi i SIPMV-së nuk bën sistemin e të siguruarve të cilët janë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë në përputhje me kriteret e reja të anëtarësimit brenda tre muajve pas anëtarësimit të tyre në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor dhe në rast se Fondi i SIPMV nuk i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të zgjedhura të detyrueshme pensionale në afat prej tre brenda tre muajsh nga dita e pranimit të kontributeve. Mjetet për finansimin kapital të sigurimit pensional, të realizuara në bazë të pagesës së jo në kohë dhe jo të plotë të kontributit, transferohen në llogarinë individuale të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional.

Shuma e kompensimit për transferim jo në kohë të kontributeve përcaktohet<sup>6</sup> në bazë të vlerësimit të gjendjes së llogarisë hipotetike individuale të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional që ka histori identike të pagesave të kontributeve me të siguruarin me sistemim jo në kohë përkatësisht në bazë të një vlerësimit të gjendjes së mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional, shuma e kontributeve të përgjithshme të transferuara jo në kohë dhe kompensimeve të kontributeve që i paguan shoqëria pensionale.

Në vitin 2021, në fondet e detyrueshme pensionale Fondi i SIPMV-së transferoi gjithsej rreth 1,62 milionë denarë si kompensim për transferim jo në kohë të kontributeve për anëtarët për të cilët nuk i ka transferuar kontributet në llogaritë e fondeve të zgjedhura të detyrueshme pensionale në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kontributeve. Në tabelën 5.3. janë paraqitur të dhënat e detajuara për kompensimet e transferuara për transferim jo në kohë të kontributeve në fondet.

<sup>6</sup>Formula për llogaritjen e kompensimit për transferimin jo në kohë të kontributeve është e përshkruar në Rregulloren për transferimin jo në kohë të kontributeve.

Tabela 5.3. Kompensime te paguara per vonese transferit te kontributeve per vonese te transferit kontributeve ne shtyllen e dyte per vitin 2021

| Fondi pensional i detyrueshem | Kompensim per vones te trasferit te kontributeve |
|-------------------------------|--------------------------------------------------|
| SAVAd                         | 0,62                                             |
| KBPd                          | 0,97                                             |
| TRIGLAVd                      | 0,03                                             |
| Gjithsej                      | 1,62                                             |

## 5.4.2 Mjetet e kthyer ne Fondin SPIM

Gjatë vitit 2021, një pjesë e mjeteve të paguara në fondet e detyrueshme pensionale (rreth 372 milionë denarë) u kthye në Fondin e SIPMV për shkak të disa arsyeve:

- Realizimi i të drejtës së pensionit invalidor dhe familjar;
- Teprica e kontributeve të paguara në shtyllën e dytë për shkak të gabimeve teknike ose teprica e pagesave nga ana e punëdhënësit
- Prishja e kontratave për anëtarësim ose anulimi i shpërndarjes;
- Ndërprerja e anëtarësimit të të siguruarve të cilët gjatë sigurimit kanë mbushur stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar gjë që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit.

Në vitin 2021 pjesa më e madhe e mjeteve të kthyer në Fondin e SIPMV (67%) kanë të bëjnë me ndërprerjen e anëtarësisë së të siguruarve të cilët gjatë sigurimit kanë mbushur stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të shtuar gjë që mundëson zvogëlim të kufirit të pleqërisë për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për së paku një vit dhe nuk kanë dhënë deklaratë me shkrim për vazhdimin e anëtarësisë në fondin e detyrueshëm pensional në afat prej tre muajsh nga mbushja e stazhit të sigurimit.

Struktura e mjeteve të kthyer në Fondin e SIPMV, pas fondeve të detyrueshme pensionale, është paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën 5.4.

Tabela 5.4. Struktura e mjeteve të thyera ne fondin SPIM, sipas FPD

(milione denare)

| Shkaqet                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Nga Fondi pensional i detyrueshem |          |          | Totali   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|----------|----------|----------|
|                                                                                                                                                                                                                                                                                               | SAVAd                             | KBPd     | TRIGLAVd |          |
| Pension i realizuar                                                                                                                                                                                                                                                                           | 50,88                             | 52,35    | 3,98     | 107,21   |
| - pension invalidi                                                                                                                                                                                                                                                                            | 8,07                              | 8,88     | 0,46     | 17,41    |
| - pension familjar                                                                                                                                                                                                                                                                            | 42,81                             | 43,47    | 3,52     | 89,80    |
| Teprice pagesave kontributeve                                                                                                                                                                                                                                                                 | 0,18                              | 0,14     | 0,005    | 0,33     |
| Nderpreja e kontrates dhe anulimi i shperndarjeve                                                                                                                                                                                                                                             | 5,50                              | 8,67     | 0,05     | 14,22    |
| Nderprerja e anetarsise                                                                                                                                                                                                                                                                       | 124,68                            | 123,01   | 2,48     | 250,17   |
| - anetare te punesuar pas 1.1.2003 dhe lindur para 1.1.1967                                                                                                                                                                                                                                   | 124,68                            | 123,01   | 2,48     | 250,17   |
| - anetare te punesuar para 1.1.2003 lindura para 1.1.1967 te cilet kane nenshkruajtir deklarate per nderprejen e anetarsimit ne FPDk                                                                                                                                                          | 181,24                            | 184,18   | 6,518    | 371,93   |
| - anetare te punesuar pas 1.1.2003 dhe lindur para 1.1.1967, te cilet nuk nenshkruajten deklaratea                                                                                                                                                                                            | 545,03                            | 760,24   | 0,00     | 1.305,27 |
| - Anëtarë të cilët gjatë sigurimit kanë plotësuar stazhin e sigurimit me rritje të vazhdueshme që u mundëson zvogëlimin e kufirit të moshës për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë më së paku për një vit dhe të cilët nënshkruan deklaratë për vazhdimin e anëtarësisë në FPD | 1.043,10                          | 1.303,86 | 0,00     | 2.346,96 |
| - anetare te siguruar si bujq individual                                                                                                                                                                                                                                                      | 74,98                             | 83,01    | 0,00     | 157,99   |
| Totali                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 2.206,08                          | 2.772,55 | 0,001    | 4.978,63 |

## 5.5 Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve të detyrueshme pensionale

Zakonisht, në sistemet e detyrueshme pensionale të finansimit kapital, në fazën fillestare shfrytëzohet kontrolli proaktiv dhe kufizimet kualitative dhe kuantitative të investimeve. Duke nisur nga kjo, në ligjin dhe në aktet nënligjore janë përcaktuar qëllimet dhe parimet e investimit, llojet e instrumenteve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale, kushtet që duhet të plotësojnë tregjet të rregulluara dytësore të kapitalit, ku tregtohet me mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale, cilësia e instrumenteve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale, shtetet ose grupet në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale, kufizimet investuese në kuadër të instrumenteve dhe emetuesve, investimet e ndaluara, tejkalimi i kufizimeve investuese etj.

Shoqëria është e detyruar që mjetet e fondit të detyrueshëm pensional t'i investojë në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe strategjinë e saj të investimit, me qëllim për të realizuar të ardhura më të larta, vetëm në dobi të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm pensional dhe përmes diversifikimit dhe analizës financiare për të minimizuar rrezikun nga humbjet të shkaktuara si rezultat i mospagesës nga emetuesi ose pala tjetër kontraktuese që rrjedhin nga ndikimi në tregjet financiare vendore dhe të huaja, humbjet në vlerën reale të mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional për shkak të inflacionit dhe humbjeve që janë si rezultat i shitjes së mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional për shkak të sigurimit të likuiditetit të fondin të detyrueshëm pensional. Ndërkaq, anëtari i këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës në shoqëri, në menaxhimin dhe kontrollin e investimit të mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, është i detyruar që të aplikojë shkallë të kujdesit, efektivitetit dhe shkathtësisë, të cilat do t'i aplikojë person i arsyeshëm gjatë investimit të mjeteve personale. Çdo anëtar i këshillit drejtues dhe i këshillit mbikëqyrës në shoqërinë duhet ta përmbushë obligimin e tij në përputhje me detyrat e tij fiduciare dhe duhet të sigurojë aplikim të tyre nga çdo i punësuar dhe i angazhuar me punë në shoqërinë.

Në Ligjin dhe në aktet nënligjore është rregulluar se mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale mund të investohen në depozita bankare dhe në certifikata për depozita, obligacione dhe në letra tjera debitorë me vlerë, në aksione dhe bono komerciale, të lëshuara nga emetues me seli në RMV dhe jashtë vendit, në shtete-anëtare të BE-së ose OECD-së. Duke pasur parasysh se është e domosdoshme të arrihet diversifikimi adekuat ndërmjet llojeve të ndryshme të investimeve, janë paraparë kufizime maksimale për investim në kompani të caktuara dhe kufizime maksimale të shumave të cilat mund të investojnë në lloje të caktuara instrumentesh. Me qëllim për të parandaluar investimet në instrumente të cilat nuk janë të përshtatshme për investim në fondet e detyrueshme pensionale, ndalohen ligjërisht investimet në aksione, obligacione dhe në letra tjera me vlerë të cilat nuk kotojnë në tregun zyrtar ose me të cilat nuk tregtohet publikisht, instrumente të cilat nuk mund të jenë në dispozicion juridikisht, instrumente të cilat nuk mund të vlerësohen menjëherë, numri më i madh i formave të pronës që nuk mund të vlerësohen menjëherë dhe zërat nga vlera e pasigurt, për shembull antikuitete, vepra artistike, etj.

Duke pasur parasysh atë që mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale janë në rritje të vazhdueshme, rritja e tyre është e shoqëruar me mundësinë për dalje në numër më të madh të tregjeve të kapitalit dhe në vëllim më të madh, sepse tregu vendor mbetet i vogël lidhur me nevojat për investim të mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale, si dhe me qëllim të mundësimin të diversifikimit më të madh të mjeteve gjatë investimit të tyre dhe zgjedhjes më të madhe të kompanive për investim të mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale nga ana e shoqërive. Kufizimet investuese maksimale janë paraqitur në tabelën 5.5.


Tabela 5.5. Kufizimet maksimale investuese

| Lloji i instrumentit                                                                                                                                                | Limiti maksimal |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Investimet jashtë vendit (BE dhe OECD))                                                                                                                             | 50%             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>kambiale dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga qeveri të huaja dhe banka qendrore</li> </ul>                           | 50%             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>letra me vlerë të lëshuara nga kompani të huaja joshitetërore, banka ose fonde investimi</li> </ul>                          | 30%             |
| Letra me vlerë të lëshuara ose garantuara nga RM dhe tregu vendas ose BPRM                                                                                          | 80%             |
| Depozita bankare, certifikata depozitash, kambiale, letra me vlerë mbi bazën e hipotekës dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga bankat vendase                 | 60%             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>depozitat bankare</li> </ul>                                                                                                 | 30%             |
| Kambialet e lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe nga shoqëritë aksionare vendase, që nuk janë banka dhe akte komerciale nga shoqëritë aksionere vendase | 40%             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>kambialet të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale</li> </ul>                                                         | 10%             |
| Aksionet e lëshuara nga shoqëritë aksionare vendase                                                                                                                 | 30%             |
| Dokumente për pjesëmarrje dhe aksione në fondet e hapura, të mbyllura dhe private në RMV                                                                            | 5%              |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>dokumente për pjesëmarrje në fondet private investuese</li> </ul>                                                            | 1,5%            |


MAPAS-i mund të precaktojë kufizime të investimeve të llojeve të caktuara të instrumenteve të ndryshme nga kufiimet e precaktuara në ligjin, të cilat do të vlejnjë në afat gjithashtu të precaktuar nga MAPAS-i, por jo më gjatë se pesë vite. Në vitin 2019 u miratuan vendime për kufizime plotësuese në pajtim me përqindjen maksimale të vlerës së mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar të cilat mund të investohen në depozita në banka që kanë leje të lëshuar nga BPRMV-ja, nëse bartin kamatë përkatësisht në obligacione dhe në letra tjera me vlerë që i lëshon ose për të cilat garanton RMV-ja në tregun vendor, në periudhë prej një viti nga data e pagesës së parë në fondin pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, është 100%.

Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale SAVAd dhe KPBD, nga fillimi i funksionimit të sistemit (për periudhën 2006-2020, në nivel vjetor, e për vitin 2021 në nivel tremujor) është paraqitur në grafikun 5.10. dhe në grafikun 5.11. Struktura e investimeve të fondit të detyrueshëm pensional TRIGLLAVd nga fillimi i punës së fondit (1.4.2019) dhe në nivel tremujor për vitin 2021 është paraqitur në grafikun 5.12.


Grafiku 5.10. Struktura e Investimeve ne SAVAd



Grafiku 5.11. Struktura e Investimeve ne KBPD




Grafiku 5.12. Struktura e Investimeve TRIGLAVd



Struktura e investimeve të fondeve të detyruara pensionale, me gjendjen më 31.12.2019 nuk dallohet shumë krahasuar me struktura të investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale me gjendjen më 31.12.2021 nuk dallohet shumë në krahasim me strukturën e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale me gjendjen më 31.12.2020 dhe ajo është paraqitur në grafikun 5.13. Pjesëmarrja në obligacione vendore të cilat përfshijnë obligacione shtetërore vendore (59,85%) dhe obligacion korporativ (obligacion perpetual të emetuar nga banka – 0,02%) është 59,87% që do të thotë është rritur në mënyrë minimale në krahasim me gjendjen më datë 31.12.2020 (59,75%). Pjesëmarrja e depozitave bankare është zvogëluar dhe është 6,82%. Aksioneve vendore u përket një pjesë e vogël e portofolit (2,89%) dhe kjo pjesëmarrje mbetet pothuajse në nivelin e njëjtë lidhur me gjendjen më datë 31.12.2020.


Një pjesë shumë e vogël e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale bën pjesë te investimet në pjesëmarrjen e fondeve investuese vendore (0,27%). Në vitin 2021 pjesëmarrja e investimeve jashtë vendit është rritur në krahasim me vitin paraprak, dhe është 29,70%. Investimet në letra të huaja me vlerë përfshijnë investimet në pjesëmarrje të fondeve investuese (25,57%) dhe investime në aksione (4,13%). Mjetet tjera janë mjete monetare 0,20% dhe kërkesa 0,25%.

Grafiku 5.13. Struktura e investimeve në shtyllën e dytë, gjendja 31.12.2021



Te KBPd mund të shënohet “tejkallim pasiv” i kufizimit të investimit në pjesëmarrje në fondet investuese nga emetues të huaj, gjë që është si rezultat i ndryshimit të çmimeve tregtare dhe valutave dhe është në pajtim me rregullativën. Në grafikun 5.14 është paraqitur pjesëmarrja procentuale në portofolin sipas klasave të mjeteve të SAVAd, KBPd dhe TRIGLLAVd dhe kufizimet ligjore me gjendje më datë 31.12.2021.

Grafiku 5.14. Klasat e mjeteve në portofolin e fondeve të detyruara pensionale krahasuar me kufizimet ligjore




Gjatë vitit 2021 tre fondet e detyrueshme pensionale në kuadër të kufizimeve investuese maksimale. Te KBPd mund të shënohet “tejkallim pasiv” i kufizimit të investimet në pjesëmarrje në fondet investuese nga emetues të huaj, gjë që është si rezultat i ndryshimit të çmimeve tregtare dhe valutave dhe është në pajtim me rregullativën. Në grafikun 5.14 është paraqitur pjesëmarrja procentuale në portofolin sipas klasave të mjeteve të SAVAd, KBPd dhe TRIGLAVd dhe kufizimet ligjore me gjendje më datë 31.12.2021.

Ashtu si edhe në vitin paraprak, edhe në vitin 2021, një përqindje e vogël e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale (2,89%) janë investuar në aksione të emetuesve vendas. Në vitin 2021, si në SAVAd, ashtu edhe në KBPd, ekspozimi në aksione, krahasuar me vitin 2020, është pothuajse në të njëjtin nivel. Pra, ekspozimi i aksioneve në emetuesit vendas është dy herë më i lartë te SAVAd (4,17%) krahasuar me KBPd (1,89%). Ekspozimi ndaj aksioneve të emetuesve vendas të TRIGLAVd në vitin e tretë të punës së vet krahasuar me vitin 2020 u ul dhe arriti 0,67%.

Në krahasim, lëvizja<sup>7</sup> e vlerës së Indeksit të Bursës së Maqedonisë - IBM10, Indeksi i Obligacioneve të Bursës së Maqedonisë - OBM dhe vlerave të njësive të kontabilitetit të fondeve të detyrueshme pensionale, gjatë vitit 2021, janë paraqitur në grafikun 5.15. Vlera e njësisë së kontabilitetit të SAVAd shënoi rritje prej 9,53%, njësia e kontabilitetit të KBPd rritje prej 10,85% dhe njësia e kontabilitetit TRIGLAVd rritje prej 8,32%. IBM10, gjatë vitit 2021 shënoi rritje me rreth 30,79% . OBM-ja, gjatë vitit 2021, shënoi rritje me rreth 0,46%<sup>11</sup>.

Grafiku 5.15. Levizje krahasuese e vlerës së IBM, BRM dhe njësive llogaritese të FPD, për vitin 2021




Burimi : MAPAS dhe Bursa e Maqedonisë SHA Shkup- Buletini vjetor i statistikave 2021.

<sup>7</sup>Lëvizjet janë paraqitur nëpërmjet ndryshimit të indekseve / njësive në lidhje me indeksin fillestar të barabartë me 100, më 31.12.2020




Gjysma e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale edhe në vitin 2021 u përkasin letrave shtetërore me vlerë, përkatësisht letrave shtetërore vendase me vlerë (55,42% në SAVAd, 63,83% në KBPd dhe 58,39% në TRIGLAVd). Shikuar sipas sektorëve, më pas, rreth një e treta e mjeteve të të tria fondeve pensionale janë investime në instrumentet nga emetuesit / shoqëritë aksionare nga sektori financiar, përkatësisht 32,17% të SAVAd, 34,04% të KBPd dhe 35,94% të TRIGLAVd nga mjetet e përgjithshme të fondit. Në kuadër të këtij sektori, SAVAd ka pjesëmarrjen më të madhe të aksioneve në fondet e investimeve të huaja dhe vendase (63,9%) dhe depozitave bankare vendase (32,17%) dhe ka pjesëmarrjen më të vogël të shërbimeve financiare (3,5%), të aksioneve në bankat vendase dhe të huaja (0,3%) dhe obligacioneve të emetuara nga bankat vendase (0,1%). Në KBPd në kuadër të sektorit financiar dominon pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja dhe vendase (89,5%), e ndjekur nga depozitat bankare vendase (10,5%). Edhe në TRIGLAVd në kuadër të sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja dhe vendase (74,5%), e ndjekur nga depozitat bankare vendase (25,5%). Përveç sektorëve të lartpërmendur, fondet e detyrueshme pensionale investojnë edhe në sektorë të tjerë: farmaci, të mirat e konsumit, industri, të mirat themelore, teknologji informatike, shërbimet e komunikimit dhe energji, por me pjesëmarrje shumë më të vogël (nga 0,05% në 2,85%). Struktura e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale sipas sektorëve është paraqitur në grafikun 5.16.

Grafiku 5.16 Struktura e investimeve FPD sipas sektor




Grafiku 5.17. Struktura valutore e mjeteve te FPD 2020-2021



Sipas strukturës së valutës së mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale, që është paraqitur në grafikun 5.17, mund të vërehet se edhe në vitin 2021 edhe në SAVAd (40,98%) edhe në KBPd (40,46%), pjesa më e madhe e mjeteve janë investuar në euro, ku në SAVAd shënoi rënie të pjesëmarrjes në instrumentet, në euro, krahasuar me vitin paraprak, ndërsa në KBPd pjesëmarrja në instrumentet në euro në vitin 2021 mbetet pothuajse në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2020. Ndërsa, pjesëmarrja në instrumentet, në valutën vendase, është 35,63% të SAVAd dhe 35,03% të KBPd, ku në të dyja fondet pensionale mund të vërehet rritje krahasuar me vitin paraprak. Më pas, në SAVAd (22,39%) mund të vërehet rritje e pjesëmarrjes në instrumentet, në dollarë amerikanë, krahasuar me vitin 2020, ndërsa në KBPd (24,51%) mund të vërehet ulje e pjesëmarrjes në instrumentet, në dollarë amerikanë. Një pjesë shumë e vogël e mjeteve të SAVAd janë investuar në franga zvicerane (1,00%). Struktura e valutës së TRIGLAVd dallon në krahasim me strukturën e valutës së SAVAd dhe KBPd. Megjithatë, struktura e valutës së TRIGLAVd në vitin e tretë të punës së tij dallon në krahasim me strukturën e valutës në vitin 2020. Pësia e mjeteve të TRIGLAVd është ende në anën e mjeteve të investuara në instrumentet në denarë (69,85%), më pas 19,73% e mjeteve janë investuar në instrumentet në dollarë amerikanë, ndërsa pjesa tjetër 10,10% në instrumentet në euro dhe 0,32% në franga zvicerane.

Nëse bëhet krahasimi me vendet e rajonit që kanë sisteme të ngjashme pensionale me atë të Maqedonisë, mund të vërehen ngjashmëritë, por edhe dallimet e theksuara në portfolet e investimeve të fondeve të detyrueshme pensionale. Në grafikun 5.18 janë paraqitur portfolet e fondeve pensionale (që korrespondojnë me fondet e detyrueshme pensionale në Maqedoninë e Veriut) në disa vende dhe në RMV, më 31.12.2021.

Grafiku 5.18 Portfolet e fondeve pensionale në disa vende dhe në Republikën e Maqedonisë



Burime: [www.hanfa.hr](http://www.hanfa.hr); [www.fsc.bg](http://www.fsc.bg); [www.asfromania.ro](http://www.asfromania.ro) dhe përllëgaritjet individuale.

Nëse portfolet e fondeve të detyrueshme pensionale shqyrtohen sipas llojeve të instrumenteve, mund të vihet re se, përveç në Bullgari, në të gjitha vendet, 50% e mjeteve të fondeve pensionale janë investuar në obligacione dhe në letra të tjera me vlerë, për të cilat garanton shteti, ose pushteti lokal (60% në Rumani, Kroaci V<sup>8</sup> dhe në Maqedoninë e Veriut dhe 48% në Bullgari). Pjesa tjetër e mjeteve janë investuar në mënyra të ndryshme. Në aksionet dhe pjesëmarrjet më së shumti investohet në Kroaci V (35%), e ndjekur nga Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria (33%) dhe Rumania (29%). Më së shumti investime në depozita kanë fondet pensionale në Maqedoni (7%), pasuar nga Rumania (2%), Kroacia V (1%) dhe Bullgaria (më pak se 1%). Fondet pensionale kanë investuar edhe në obligacionet korporative, 8% në Bullgari, 7% në Rumani, 2% në Kroaci V. Krahasuar me fondet pensionale në vendet e tjera, pjesëmarrja e investimeve në obligacionet korporative në Maqedoninë e Veriut është dukshëm më e ulët, 0,02%. Investime në pronën e patundshme kanë vetëm fondet pensionale në Bullgari (1%) (në vendet e tjera, ky instrument, zakonisht, nuk lejohet). Lidhur me ekspozimin e portfoleve të fondeve të detyrueshme pensionale në instrumentet e emetuara nga emetues të huaj<sup>9</sup>, mund të vërehet se ekspozimin më të madh jashtë vendit e kanë fondet pensionale në Maqedoninë e Veriut (30%), pasuar nga Kroacia V (25%) dhe Rumania (12%)<sup>10</sup>.

<sup>8</sup>Në Kroaci janë zbatuar multifondet, përkatësisht tre kategori të fondeve pensionale: A (me rrezikun më të madh), B (portfolet ekzistuese në momentin e zbatimit të multifondeve) dhe C (me më pak rrezik).

<sup>9</sup>Të dhënat për investimet jashtë vendit për Bullgarinë, me gjendjen e datës 31.12.2021, nuk u gjetën në kuadër të të dhënave të mara.

<sup>10</sup>Të dhënat për investimet jashtë vendit për Rumaninë janë më 30.11.2021.

## 5.6 Mjetet neto, njësia llogaritare dhe shkalla e kontributit të fondeve të detyrueshme pensionale

Kontributet e paguara në fondet e detyrueshme pensionale, të zvogëluara për kompensimin e kontributeve, investohen menjëherë. Kontributi i përgjithshëm i realizuar u atribuohet mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional, përkatësisht llogarive individuale të anëtarëve. Një herë në muaj, shoqëritë arkëtojnë edhe kompensim për menaxhimin e mjeteve, e cila llogaritet çdo ditë si përqindje e neto-mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional. Në mënyrë plotësuese, në çdo transaksion, me mjetet e fondit të detyrueshëm pensional arkëtohen provizionet e transaksionit nga fondi i detyrueshëm pensional. Çdo ditë bëhet vlerësimi i vlerës së mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional. Kjo përcaktohet në bazë të vlerës së tregut të çdo mjeti veçmas ose në bazë të vlerës së amortizuar të mjetit, nëse instrumenti mbahet deri në maturim, ose në portofolin e disponueshëm për shitje, ose nëse nuk mund të vlerësohet vlera e tij e tregut.

Ndryshimet në mjetet e fondeve të detyrueshme pensionale nga fillimi deri në fund të vitit ndodhin për shkak të:

- të hyrave të kontributeve,
- të hyrave të kompensimeve për transferimin e parakohshëm të kontributeve në rast të transferimit të parakohshëm të kontributeve,
- të dalave për shkak të kompensimeve dhe provizioneve të transaksionit,
- të hyrave për shkak të transferimit nga fondi tjetër i detyrueshëm pensional (për personat që përkohësisht ishin sistematizuar në fondin tjetër, dhe më pas kanë nënshkruar kontratë me fondin aktual dhe për personat që kanë qenë anëtarë të fondit tjetër, dhe më pas janë transferuar në fondin aktual),
- të dalave për shkak të transferimit nga fondi tjetër i detyrueshëm pensional (për personat që përkohësisht ishin sistematizuar në fondin përkatës, dhe më pas kanë nënshkruar kontratë me fondin tjetër dhe personat që kanë qenë anëtarë të fondit përkatës, dhe më pas janë transferuar në fondin tjetër),
- të dalave për personat që i kanë ndërprerë kontratat e anëtarësimit, të dalave për shkak të tepicës së kontributit të paguar, të dalave për shkak të realizimit të së drejtës së pensionit invalidor ose familjar dhe të dalave për personat të cilëve u ka përfunduar anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional të cilët gjatë sigurimit e kanë kryer stazhin e sigurimit me zgjatjen e shtuar që mundëson uljen e kufirit të moshës për realizimin e së drejtës së pensionit të pleqërisë për të paktën një vit,
- të dalave për shkak të pagesës së trashëgimisë,
- të dalave për shkak të pagesave të njëhershme për personat që nuk e kanë realizuar të drejtën e pensionit të pleqërisë,
- të dalave për shkak të pagesës së pensionit të pleqërisë - tërheqjeve të programuara,
- fitimeve ose humbjeve të (pa)realizuara nga investimet.


Duke u nisur nga vlera e neto-mjeteve, në fund të vitit paraprak, dhe duke i marrë parasysh të gjitha ndryshimet e mësipërme, vijmë te vlera e neto-mjeteve, në fund të vitit, që është paraqitur në tabelën 5.6.

Tabela 5.6. Ndryshimet e mjeteve të fondeve pensionale të detyruara

(në milionë denarë)

|                                                                                                          | SAVAd     | KBPd      | TRIGLAVd |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----------|----------|
| Mjetet neto 31.12.2020                                                                                   | 40.500,92 | 45.638,47 | 1.117,71 |
| Kontributet                                                                                              | 4.449,07  | 4.820,00  | 413,30   |
| Kompensimet nga kontributet                                                                              | 89,02     | 96,44     | 8,27     |
| Kontributet e reduktuara për kompensimet e kontributeve                                                  | 4.360,05  | 4.723,56  | 405,03   |
| Надоместок за ненавременно пренесување на придонеси                                                      | 0,62      | 0,97      | 0,03     |
| Kompensimet e mjeteve                                                                                    | 159,81    | 181,01    | 6,91     |
| Shpenzimet për provizione ndërmjetësuese                                                                 | 1,80      | 1,42      | 0,21     |
| Transferimi nga fondi tjetër                                                                             | 31,99     | 39,07     | 1.328,87 |
| Transferimi në fondin tjetër                                                                             | 661,20    | 735,57    | 3,15     |
| Transferimi në FSPIM për shkak të ndërprerjes së marrëveshjes, kthimi i kontributit dhe dalja në pension | 181,24    | 184,18    | 6,52     |
| Pagesa e trashëgimisë                                                                                    | 7,01      | 14,73     | 0,00     |
| Pagimi i pensionit të moshës – tërheqje të programuara                                                   | 0,25      | 0,62      | 0,00     |
| Pagesa e vetme                                                                                           | 0,00      | 0,01      | 0,00     |
| Fitimi bruto nga investimet                                                                              | 4.177,98  | 5.321,87  | 161,87   |
| Fitimi neto nga investimet                                                                               | 4.016,36  | 5.139,44  | 154,75   |
| Mjetet neto më 31.12.2021                                                                                | 48.059,63 | 54.605,42 | 2.996,68 |

Grafiku 5.19 Rritja e mjeteve neto të SAVAd dhe KBPd në përqindje në raport me vitin paraardhës




Neto-mjetet e përgjithshme të fondeve të detyrueshme pensionale, më 31.12.2021, arritën rreth 105,66 miliardë denarë ose rreth 1,72 miliardë euro, që është rreth 14,61% e BPV-së së RMV-së.

Në grafikun 5.19, janë paraqitur vlerat e neto-mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale, në fund të çdo viti (2008 - 2021) dhe rritja e tyre në përqindje, krahasuar me neto-mjetet në vitin paraprak. Më pas mund të vërehet se neto-mjetet edhe të SAVAd, edhe të KBPd rriten me ritëm të ngjashëm. Rritja më e madhe edhe të SAVAd dhe KBPd është shënuar në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008. Te TRIGLAVd shënohet rritje e madhe e neto-mjeteve në vitet fillestare të punës së fondit.


Lëvizja e vlerës së neto-mjeteve dhe kontributeve kumulative, si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e neto-mjeteve të SAVAd dhe KBPd, që nga fillimi i punës së sistemit (respektivisht nga data e pagesës së parë, më 1.1.2006) deri më 31.12.2021, janë paraqitur në grafikun 5.20. dhe në grafikun 5.21. Rritja e neto-mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale është implikuar nga rritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultatet e investimeve. Për vitin 2021, më shumë se gjysma e rritjes së neto-mjeteve është për shkak të kontributeve të paguara. Krahasuar me vitet e para të punës së fondeve, pjesëmarrja e kontributeve të paguara në rritjen e përgjithshme të neto-mjeteve është gradualisht në rënje. Gjithashtu, mund të vërehet se, gjatë viteve të para, pjesëmarrja e kontributeve kumulative në neto-mjetet e përgjithshme është dukshëm e madhe, pastaj gradualisht zvogëlohet dhe në pesë vitet e fundit, mesatarisht është 80%.

Grafiku 5.20. Rritja e mjeteve neto në krahasim me kontributet e paguara në SAVAd




<sup>11</sup>Burimi për PVB: Enti shtetëror i statistikave – njoftim - prodhimi vendas bruto, tremujori i katërt i vitit 2019 – të dhëna të vlerësuara

Grafiku 5.21. Rritja e mjeteve neto në krahasim me kontributet e paguara në KBPd



Grafiku 5.22. Rritja e mjeteve neto në krahasim me kontributet e paguara në TRIGLAVd



Te SAVAd dhe KBPd, neto-mjetet dhe kontributet kumulative janë rritur vazhdimisht që nga fillimi i funksionimit të sistemit. Rritja më e madhe e neto-mjeteve (rreth 150%) si dhe e kontributeve të paguara (rreth 40%) edhe te SAVAd, edhe te KBPd është shënuar në vitin 2007. Kjo ndoshta për shkak të rritjes më të madhe në përqindje të anëtarësimit, përkatësisht kontributeve në krahasim me vitin paraprak, si dhe rritjes mjaft të lartë të njësisë. Kjo pasohet nga rënia e rritjes edhe të neto-mjeteve, edhe të kontributeve të paguara. Me kalimin e viteve ka pasur stabilizim gradual, kështu që rritja e neto-mjeteve, në pesë vitet e fundit, mesatarisht, është rreth 16%, ndërsa rritja e kontributeve të paguara në të njëjtën periudhë, mesatarisht, është rreth 10%. Në vitin 2021, ka parametra më të mëdhenj krahasuar me vitin 2020, përkatësisht rritja e neto-mjeteve prej 19% te SAVAd dhe 20% te KBPd, ndërsa shënohet rritja më e ulët e kontributeve të paguara që është rreth 3% te SAVAd dhe 2% te KBPd.

Tabela 5.7. Vlera e njësise llogaritese nga fillimi i sistemit


| Data        | Vlera e njësise llogaritese (ne denare ) |            |            |
|-------------|------------------------------------------|------------|------------|
|             | SAVAd                                    | KBPd       | TRIGLAVd   |
| 31.12.2006  | 105,929336                               | 106,265900 |            |
| 31.12.2007  | 115,511364                               | 115,303221 |            |
| 31.12.2008  | 100,155213                               | 107,116421 |            |
| *31.12.2009 | 116,874672                               | 120,667142 |            |
| 31.12.2010  | 125,009646                               | 129,590887 |            |
| 31.12.2011  | 129,003093                               | 130,697013 |            |
| 31.12.2012  | 139,225567                               | 142,372582 |            |
| 31.12.2013  | 151,117506                               | 153,757419 |            |
| 31.12.2014  | 160,733889                               | 164,578077 |            |
| 31.12.2015  | 170,193521                               | 174,392410 |            |
| 31.12.2016  | 179,771032                               | 184,786292 |            |
| 31.12.2017  | 189,686331                               | 195,037486 |            |
| 31.12.2018  | 193,113009                               | 196,706281 |            |
| 31.12.2019  | 213,757775                               | 218,317207 | 101,578448 |
| 31.12.2020  | 220,489334                               | 227,667060 | 101,665261 |
| 31.03.2021  | 226,768762                               | 235,877944 | 103,621892 |
| 30.06.2021  | 232,208920                               | 241,444823 | 105,787286 |
| 30.09.2021  | 234,693799                               | 243,890373 | 106,826622 |
| 31.12.2021  | 241,504146                               | 252,373824 | 110,128711 |

\*Në gjysmën e dytë të vitit 2009, të dyja SAVA dhe KB Prvo miratuan vendime për riklasifikimin e instrumenteve finansiare të mbajtura deri në maturim në kategorinë e instrumenteve finansiare të disponueshme për shitje dhe, në këtë procedurë, shoqëritë rivlerësuan vlerën e instrumenteve finansiare, duke zbatuar vlerën objektive, të drejtë dhe e përcaktuan vlerën e mjeteve, neto-mjeteve, vlerën e njësive të kontabilitetit dhe numrin e njësive të kontabilitetit, gjë që shkaktoi korrigjim relativisht të lartë në vlerën e njësive të kontabilitetit


Lëvizja e vlerës së neto-mjeteve dhe kontributeve kumulative si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e neto-mjeteve të TRIGLAVd, për tre vitet e para të punës së TRIGLAVd, 2019, 2020 dhe 2021, janë paraqitur në grafikun 5.22. Edhe te TRIGLAVd shënohet rritje e neto-mjeteve dhe kontributeve kumulative në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Rritja e neto-mjeteve të TRIGLAVd, përveçse është implikuar nga rritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultatet e investimit, në masë të madhe (mbi 70%) është si pasojë e mjeteve të transferuara në TRIGLAVd nga SAVAd dhe KBPD në bazë të kontratave të lidhura për transferimin e anëtarëve të transferuar nga SAVAd dhe KBPD në TRIGLAVd.

Për evidencën e mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale përdoren njësitet e kontabilitetit. Një njësi kontabiliteti është pjesë proporcionale e neto-mjeteve të përgjithshme të fondit të detyrueshëm pensional. Vlera e njësitetit të kontabilitetit është e barabartë me vlerën e neto-mjeteve të ndarë me numrin e përgjithshëm të njësive të kontabilitetit të të gjitha llogarive dhe nënlllogarive individuale. Vlera fillestare e njësitetit të kontabilitetit të fondit pensional është 100 denarë. Fondet pensionale, duke i përfshirë edhe fondet e Maqedonisë, u nënshtrohen dukurive dhe lëvizjeve ciklike, që nënkupton rritje ose ulje të vlerave të njësive të tyre të kontabilitetit, në varësi të investimit të mjeteve dhe nga lëvizja e vlerës së instrumenteve në të cilat janë investuar mjetet e fondeve pensionale, si dhe nga arkëtimi i kompensimeve dhe provizioneve.

Grafiku 5.22. Vlera e njësise llogaritese nga fillimi i sistemit te FPD



Grafiku 5.23. Vlera e njësise llogaritese se FPD per vitin 2021



Lëvizja e vlerës së njësive të kontabilitetit të fondeve të detyrueshme pensionale, nga fillimi i funksionimit të sistemit deri më 31.12.2021, është dhënë në tabelën 5.7, në grafikun 5.23. dhe në grafikun 5.24. Pra, që nga fillimi i punës së SAVAd dhe KBPd, ka trend të rritjes së njësive të kontabilitetit. Më 1.4.2019 filloi të punojë fondi i tretë i detyrueshëm pensional, TRIGLAVd. Në vitin 2021, vlera e njësive të kontabilitetit ka qenë më e qëndrueshme në raport me lëvizjet e vitit 2020 të shkaktuara nga kushtet e pavolitshme në tregjet finansiare në kushtet e pandemisë së virusit korona. Gjatë vitit 2021, njësitet e kontabilitetit të tria fondeve të detyrueshme pensionale shënuan rritje. Në fund të vitit, vlera e njësive të kontabilitetit të SAVAd shënoi rritje prej 9,53%, krahasuar me vitin 2020, rritje të KBPd prej rreth 10,85%, dhe rritje të TRIGLAVd prej 8,32%. Megjithatë, fondet pensionale, për nga natyra e tyre, punojnë në afat të gjatë, ndaj performancat e tyre duhet të vlerësohen në afat të gjatë.

Zakonisht, kontributi për fondet pensionale llogaritet për disa vitet e fundit, të reduktuar në nivel vjetor. Kështu, edhe në sistemin pensional të Maqedonisë është e rregulluar me ligj që kontributi të llogaritet për periudhë shtatëvjeçare (periudha e llogaritjes), të reduktuar në nivel vjetor, në shumën nominale dhe reale. Nëse fondi ekziston më shkurt se 84 muaj, por më gjatë se 12 muaj, kontributi llogaritet në fund të qershorit, përkatësisht dhjetorit, për periudhën nga 1 qershori, përkatësisht dhjetori, pas themelimit të fondit, deri në fund të qershorit, përkatësisht dhjetorit, kur llogaritet. Në këtë rast, periudha e llogaritjes është 78, 72, 66, 60, 54, 48, 42, 36, 30, 24, 18 ose 12 muaj<sup>11</sup>.

Tabela 5.8. Të ardhurat e fondeve të detyruara pensionale\*

| Periudha**              | SAVAd             |                | KBPd              |                | TRIGLAVd          |                |
|-------------------------|-------------------|----------------|-------------------|----------------|-------------------|----------------|
|                         | Në shumë nominale | Në shumë reale | Në shumë nominale | Në shumë reale | Në shumë nominale | Në shumë reale |
| 01.01.2006 - 31.12.2008 | 0,05%             |                | 2,32%             |                |                   |                |
| 31.12.2006 - 31.12.2009 | 3,33%             |                | 4,32%             |                |                   |                |
| 31.12.2007 - 31.12.2010 | 2,67%             |                | 3,97%             |                |                   |                |
| 31.12.2008 - 31.12.2011 | 8,80%             |                | 6,86%             |                |                   |                |
| 31.12.2009 - 31.12.2012 | 6,00%             |                | 5,66%             |                |                   |                |
| 31.12.2006 - 31.12.2013 | 5,20%             | 2,16%          | 5,41%             | 2,37%          |                   |                |
| 31.12.2007 - 31.12.2014 | 4,83%             | 2,67%          | 5,21%             | 3,05%          |                   |                |
| 31.12.2008 - 31.12.2015 | 7,87%             | 6,45%          | 7,21%             | 5,80%          |                   |                |
| 31.12.2009 - 31.12.2016 | 6,34%             | 4,74%          | 6,27%             | 4,67%          |                   |                |
| 31.12.2010 - 31.12.2017 | 6,13%             | 4,63%          | 6,01%             | 4,51%          |                   |                |
| 31.12.2011 - 31.12.2018 | 5,93%             | 4,72%          | 6,01%             | 4,80%          |                   |                |
| 31.12.2012 - 31.12.2019 | 6,31%             | 5,74%          | 6,29%             | 5,72%          |                   |                |
| 31.12.2013 - 31.12.2020 | 5,54%             | 4,84%          | 5,76%             | 5,06%          | -                 | -              |
| 31.03.2014 - 31.03.2021 | 5,83%             | 4,99%          | 6,11%             | 5,27%          | -                 | -              |
| 31.06.2019 - 31.03.2021 | -                 | -              | -                 | -              | 1,94%             | 0,50%          |
| 30.06.2014 - 30.06.2021 | 5,91%             | 4,81%          | 6,16%             | 5,06%          | -                 | -              |
| 30.06.2019 - 30.06.2021 | -                 | -              | -                 | -              | 2,75%             | 0,55%          |
| 30.09.2014 - 30.09.2021 | 5,83%             | 4,55%          | 6,11%             | 4,82%          | -                 | -              |
| 30.06.2019 - 30.09.2021 | -                 | -              | -                 | -              | 2,88%             | 0,49%          |
| 31.12.2014 - 31.12.2021 | 5,98%             | 4,48%          | 6,29%             | 4,79%          | -                 | -              |
| 30.06.2014 - 31.12.2021 | -                 | -              | -                 | -              | 3,84%             | 1,01%          |
| Filimi*** - 31.12.2021  | 5,66%             | 3,50%          | 5,95%             | 3,79%          | 3,57%             | 0,93%          |

\*\*Deri në miratimin e ndryshimeve të Ligjit për finansimin e detyrueshëm kapital të sigurimit pensional nga janari 2013, kontributi i fondit të detyrueshëm pensional është llogaritur për periudhë 3-vjeçare, vetëm në shumën nominale.

\*\*\* Fillimi i punës së SAVAd dhe KBPd është 1.1.2006. Fillimi i punës së TRIGLAVd është 1.4.2019

Kontributi në shumën nominale<sup>12</sup> është ndryshimi (rritja) në përqindjet e vlerës së njësive të kontabilitetit në datën e fundit të vlerësimit të periudhës së llogaritjes dhe vlerës së njësive të kontabilitetit në ditën e fundit të muajit që paraprin muajit të parë të periudhës së llogaritjes, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit në shumën nominale. Kontributi në shumën

<sup>11</sup>TRIGLAVd përfshihet në analizat krahasuese të kontributit me kontributin e llogaritur për periudhat përkatëse, në pajtim me rregullativën, sepse ekziston më gjatë se 12 muaj, por më shkurt se 84 muaj.

<sup>12</sup>Formulat për llogaritjen e kontributit në shumën nominale dhe reale janë të përcaktuara në Rregulloren për vlerësimin e mjeteve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale.




reale, për çdo periudhë të llogaritjes, të konvertuar në shkallë vjetore ekuivalente të kontributit në shumën reale, llogaritet në bazë të shkallës vjetore të kontributit në shumën nominale dhe ndryshimit të nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhën e llogaritjes, të reduktuar në nivel vjetor. Kontributi i fondeve të detyrueshme pensionale, sipas periudhave, i reduktuar në nivel vjetor, është paraqitur në tabelën 5.8.

Kontributi në llogarinë individuale është i ndryshueshëm dhe varet nga kontributi i fondit të detyrueshëm pensional dhe nga kompensimet e arkëtuara nga shoqëria. Kontributi, përkatësisht fitimi, është parametër që nuk mund të parashikohet realisht, sepse varet nga kushtet e tregut të kapitalit dhe nga ekonomia e përgjithshme.

Duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të sigurimit pensional, është e rëndësishme të llogaritet edhe kontributi i fondeve të detyrueshme pensionale që nga fillimi i sistemit, përkatësisht nga fillimi i punës së fondit të detyrueshëm pensional të reduktuar në nivel vjetor, i cili për SAVAd është 5,66% në shumën nominale ose 3,50% në shumën reale, për KBPd 5,95% në shumën nominale, përkatësisht 3,79% në shumën reale. Kontributi që nga fillimi i punës së TRIGLAVd i reduktuar në nivel vjetor është 3,57% në shumën nominale, përkatësisht 0,93% në shumën reale.


Grafiku 5.24. Te ardhura per SAVAd dhe KBPd

(ne shume nominale)



Lëvizja e kontributit në shumën nominale, gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve të ekzistimit të finansimit të detyrueshëm kapital të sigurimit pensional, mund të shihet në grafikun 5.25, ku janë paraqitur kontributet sipas periudhave (nga fillimi i sistemit deri në datën përkatëse), nga fillimi i sistemit deri më 31.12.2021, sipas fondeve (për SAVAd dhe KBPd). Në grafikun janë paraqitur edhe kontributet sipas periudhave nga fillimi i punës së TRIGLAVd deri në datën përkatëse. Në fillim të ekzistimit të sistemit vihet re rritja e kontributit, kështu që në fund të viteve 2006 dhe 2007 ka kontribute të larta, ndërsa në fund të vitit 2008 vihen re kontribute më të ulëta, si rezultat i zhvillimeve negative në tregjet finansiare vendase dhe të huaja. Kjo pasohet nga rimëkëmbja graduale nga kriza dhe rritja e kontributeve, deri në fund të vitit 2009, si dhe në fund të vitit 2010. Në fund të vitit 2011, ka

Grafiku 5.25. E ardhur ne vlere nominale dhe reale ne FPD, 2013-2021



pasur rënie të lehtë të kontributit, krahasuar me fundin e vitit 2010. Gjatë viteve në vijim vërehet rritje (me lëshime të vogla nga rritja e kontributeve deri në fund të vitit 2015 dhe në gjysmën e parë të vitit 2016 dhe kontributeve në vitin 2018). Shumat më të vogla të kontributeve në vitin 2018 janë kryesisht për shkak të ndikimit të çmimeve në tregjet finansiare botërore, të cilat shënuan luhatshmëri më të madhe gjatë vitit 2018 dhe zvogëlim në fund të vitit 2018. Gjatë vitit 2019 shënohet rritja graduale e kontributeve. Në vitin 2020 vërehen kontribute më të vogla krahasuar me vitin 2019 të SAVAd dhe KBPd, më së shumti për shkak të gjendjeve të pavolitshme në tregjet finansiare në kushtet e pandemisë së virusit korona. TRIGLAVd në vitet e para të punës së tij dhe në rrethana të jashtëzakonshme për shkak të gjendjeve të pavolitshme në tregjet finansiare në kushtet e pandemisë së virusit korona, vërejtje kontribut në shumën nominale më të vogël se zero, i cili tashmë u kompensua në periudhën e ardhshme. Në vitin 2021 shënohet rritja e kontributeve të tria fondet pensionale.

Lëvizja e kontributit në shumën nominale dhe reale, në periudhën 2013 - 2020 (në nivel vjetor) dhe në vitin 2021 (në nivel tremujor), pas periudhave shtatëvjeçare, të konvertuar në shkallën ekuivalente vjetore të kontributit, për fondin e detyrueshëm pensional, mund të shihen në grafikun 5.26. Në këtë grafik është paraqitur edhe lëvizja e kontributit në shumën nominale dhe reale të TRIGLAVd, për periudhat përkatëse në përputhje me rregullativën, sepse ekziston më gjatë se 12 muaj, por më shkurt se 84 muaj. Në vitin 2021, kontributi në shumën nominale u rrit edhe te SAVAd (nga 5,83% në 5,98%) edhe te KBPd (nga 6,11% në 6,29%). Megjithatë, kontributi në shumën reale u zvogëlua edhe te SAVAd (nga 4,99% në 4,48%) edhe KBPd (nga 5,27% në 4,79%). Pra, shuma më e ulët e kontributit në shumën nominale është shënuar në tremujorin e parë dhe të tretë të fondeve pensionale që ekzistojnë më shumë se shtatë vjet. Në fund të vitit 2021 vërehen shuma më të mëdha krahasuar me vitin 2020, por te SAVAd ende nuk është në nivelin e kontributit shtatëvjeçar të arritur në fund të vitit 2019. Për sa i përket kontributit në shumën reale, kontributi më i ulët është shënuar në tremujorin e fundit të vitit 2021. Kontributi i fondit të tretë të detyrueshëm pensional që filloi me punë në prill 2019 u rrit në vitin 2021 dhe për periudhën 30.06.2019 - 31.12.2021 shënoi kontribut edhe në shumën nominale, edhe në shumën reale që në mënyrë solide e tejkalon kontributin e realizuar për periudhën 30.06.2019 - 31.12.2020. Në periudhën në shqyrtim (2013 - 2021), ndryshimi i nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhat e llogaritjes, të reduktuar në nivel vjetor, deri në vitin 2019 ka shënuar rënie, gjë që ndikon në përafrimin gradual të kontributeve në shumën reale ndaj kontributeve në shumën nominale, ndërkohë që në periudhën pas vitit 2019 ka shënuar rritje që ndikon në largimin gradual të kontributeve në shumën reale nga kontributet në shumën nominale.

Kontributi shtatëvjeçar në nivelin e finansimit të detyrueshëm kapital të sigurimit pensional për periudhën 31.12.2014 - 31.12.2021, të llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit të fondeve të detyrueshme pensionale, të reduktuar në nivel vjetor është 5,91% në shumën nominale, përkatësisht 4,41% në shumën reale.

## 5.7 Kompensimet tek fondet e detyrueshme pensionale

Për kryerjen e funksioneve të tij të menaxhimit të mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, vlerësimit të mjeteve, anëtarësimit, mbajtjes së llogarive individuale të anëtarëve dhe njoftimit të anëtarëve, si dhe për pagesën e kompensimeve për MAPAS-in, për Fondin e SPIMV-së dhe për kujdestarin e pronës dhe mbulimin e shpenzimeve të veta, shoqëritë, në përputhje me Ligjin, arkëtojnë kompensim të kontributeve, kompensim të mjeteve dhe kompensim për transferim.

Mënyra e tillë e finansimit të shoqërive pensionale është e zakonshme për shoqëritë që funksionojnë në sistemin pensional të ngjashëm me sistemin pensional të Maqedonisë. Kompensimi që arkëtohet si përqindje e kontributeve, paguhet një herë nga pagesa e kontributit, dhe më pas ai kontribut investohet deri në tërheqjen e mjeteve, ndërsa kompensimi që arkëtohet nga mjetet, arkëtohet në fund të çdo muaji, nga mjetet e përgjithshme të cilat menaxhohen. Kompensimet e bazuara në kontribute, kanë peshë “në fillim”, përkatësisht janë relativisht të mëdha në vitet fillestare. Kompensimet e bazuara në mjete kanë peshë “në fund”, pasi mjetet e akumuluar janë shumë më të mëdha aq sa janë më afër daljes në pension. Shikuar në afat të gjatë, kompensimi i kontributeve nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në lartësinë e pensionit të anëtarit, ndërsa kompensimi i mjeteve do të bëhet më i rëndësishëm me kalimin e viteve.

Llojet dhe lartësia e kompensimeve, të cilat i arkëtojnë shoqëritë që menaxhojnë fondet e detyrueshme pensionale në vitin 2021 janë paraqitur në tabelën 5.9.

<sup>14</sup>Administrative Charges for Funded Pensions: An International Comparison and Assessment, Edward Whitehouse, June 2000.

Tabela 5.9. Kompensimet qe arketojne shoqerite qe administrojne me fonde pensionale te detyrueshme per vitin 2021

| Lloji kompensimit                                                          | SAVA                            | KB e Para                       | TRIGLAV                         |
|----------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| Kompensim nga kontributet                                                  | 2,00%*                          | 2,00%*                          | 2,00%                           |
| Kompensim mujor nga vlere e neto mjeteve ne fodni pensional te detyrueshem | 0,030%**                        | 0,030%**                        | 0,030%                          |
| Kompensim per kalim                                                        |                                 |                                 |                                 |
| Nr i diteve ****                                                           | Vlera e kompensimit per kalim   | Vlera e kompensimit per kalim   | Vlera e kompensimit per kalim   |
| Nr i diteve ≤ 720                                                          | 15 euro                         | 15 euro                         | 15 euro                         |
| Nr i diteve > 720                                                          | Nuk paguhet kompensim per kalim | Nuk paguhet kompensim per kalim | Nuk paguhet kompensim per kalim |

\* Lartësia është e barabartë me maksimumin e përcaktuar ligjërisht për vitin 2020 (paraprakisht ishte 2,25% të të gjitha FDP-të).

\*\* Lartësia është e barabartë me maksimumin e përcaktuar ligjërisht për vitin 2019 (paraprakisht ishte 0,035% edhe te SAVAd, edhe te KBPd).

\*\*\* Lartësia është e barabartë me maksimumin e përcaktuar ligjërisht për vitin 2019. (Nga prilli vitit 2019).

\*\*\* Numri i ditëve llogaritet nga data për të cilën anëtarë ka fituar statusin e anëtarit në fondin ekzistues të detyrueshëm pensional (ose nga dita e parë e muajit për të cilin anëtarë ka fituar të drejtën e kontributit në fondin ekzistues të detyrueshëm pensional, në rastin e anëtarësimit të parë) deri në datën e transferimit të mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional.

Fillimisht, kompensimi i kontributeve ishte përcaktuar në tender, ndërsa kompensimi që e arkëtuan SAVA dhe KB Prvo ishte 8,50%. Më tej, me zhvillimin e sistemit dhe me zvogëlimin e kompensimeve që i arkëtojnë institucionet shtetërore nga shoqëritë, si dhe me rritjen e kontributeve dhe mjeteve, të cilat janë bazë për llogaritjen e kompensimeve, pasoi zvogëlimi i vazhdueshëm gradual i këtij kompensimi. Lartësia e kompensimeve të kontributeve, të cilat u arkëtuan nga fillimi i ekzistimit të sistemit, deri në vitin 2021, është paraqitur në tabelën 5.10.

Tabela 5.10. Niveli i kompensimeve të kontributeve që arkëtojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e dyte

|      | shuma | Data e zbatimit               |           | shuma | Data e zbatimit               |         | shuma | Data e zbatimit   |
|------|-------|-------------------------------|-----------|-------|-------------------------------|---------|-------|-------------------|
| SAVA | 9,90% | Ne tender                     | KB e Para | 9,90% | Ne tender                     | TRIGLAV | 2,25% | Nga Prilli 2019 v |
|      | 8,50% | Nga fillimi i sistemit 2006 v |           | 8,50% | Nga fillimi i sistemit 2006 v |         | 2,00% | Nga janari 2020 v |
|      | 7,90% | Nga korriku 2007 v            |           | 7,90% | Nga korriku 2007 v            |         |       |                   |
|      | 6,90% | Nga shkurti 2008 v.           |           | 6,80% | Nga shkurti 2008 v.           |         |       |                   |
|      | 6,50% | Nga maji 2009 v.              |           | 5,50% | Nga janari 2010 v             |         |       |                   |
|      | 5,50% | Nga janari 2010 v.            |           | 4,50% | Nga janari 2011 v             |         |       |                   |
|      | 4,50% | Nga janari 2011 v.            |           | 4,00% | Nga janari 2012 v             |         |       |                   |
|      | 4,00% | Nga janari 2012 v             |           | 3,75% | Nga qershori 2013 v           |         |       |                   |
|      | 3,75% | Nga qershori 2013 v           |           | 3,50% | Nga janari 2013 v             |         |       |                   |
|      | 3,50% | Nga janari 2014 v             |           | 3,25% | Nga janari 2014 v             |         |       |                   |
|      | 3,25% | Nga janari 2015 v             |           | 3,00% | Nga janari 2015 v             |         |       |                   |
|      | 3,00% | Nga janari 2016 v             |           | 2,75% | Nga janari 2016 v             |         |       |                   |
|      | 2,75% | Nga janari 2017 v             |           | 2,50% | Nga janari 2017 v             |         |       |                   |
|      | 2,50% | Nga janari 2018 v             |           | 2,25% | Nga janari 2018 v             |         |       |                   |
|      | 2,25% | Nga janari 2019 v             |           | 2,00% | Nga janari 2020 v             |         |       |                   |
|      | 2,00% | Nga janari 2020 v             |           |       |                               |         |       |                   |

Kompensimi i mjeteve ishte përcaktuar me ligj dhe, përfundimisht në maj 2013 ishte 0,05% në muaj e vlerës së neto-mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, pastaj përfundimisht në dhjetor 2014 ishte 0,045%. Në janar 2015, kompensimi ishte 0,04%, përfundimisht në dhjetor 2016. Në janar 2017, kompensimi ishte 0,035%. Nga janari 2019 kompensimi i mjeteve ishte 0,030%.

Nga viti 2013, me ligj ishte përcaktuar lartësia maksimale e kompensimit të kontributeve dhe kompensimit të mjeteve, që do të mund ta arkëtojnë shoqëritë pensionale dhe ishte parashikuar zvogëlimi i mëtejshëm i tyre gradual.

Arkëtimi i kompensimeve (në milionë denarë) nga shoqëritë gjatë vitit 2021 është paraqitur në tabelën 5.11.

Tabela 5.11. Arkëtimi i kompensimeve nga ana e shoqërive për vitin 2021

|                 | Jan.  | Shku. | Mar.  | Prill. | Maj   | Qer.  | Korr. | Gusht | Shat. | Tet.  | Nen.  | Dhje. | Toatli |
|-----------------|-------|-------|-------|--------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|--------|
| SAVAd – totali  | 17,68 | 19,90 | 19,91 | 20,09  | 20,62 | 20,44 | 21,75 | 20,72 | 20,89 | 21,08 | 21,74 | 24,01 | 248,84 |
| Nga kontributet | 5,43  | 7,41  | 7,24  | 7,18   | 7,61  | 7,17  | 8,30  | 7,10  | 7,12  | 7,18  | 7,54  | 9,73  | 89,02  |
| Nga mjetet      | 12,25 | 12,49 | 12,67 | 12,90  | 13,02 | 13,27 | 13,45 | 13,62 | 13,77 | 13,90 | 14,19 | 14,28 | 159,81 |
| KBPd-totali     | 19,83 | 22,19 | 22,16 | 22,43  | 22,94 | 22,75 | 24,17 | 23,13 | 23,32 | 23,52 | 24,29 | 26,73 | 277,45 |
| Nga kontributet | 5,99  | 8,05  | 7,83  | 7,81   | 8,21  | 7,76  | 8,94  | 7,69  | 7,73  | 7,76  | 8,17  | 10,51 | 96,44  |
| Nga mjetet      | 13,84 | 14,14 | 14,33 | 14,62  | 14,73 | 14,99 | 15,23 | 15,44 | 15,60 | 15,76 | 16,12 | 16,22 | 181,01 |
| TRIGLAVd-totali | 0,72  | 0,88  | 0,94  | 1,02   | 1,12  | 1,20  | 1,37  | 1,35  | 1,42  | 1,50  | 1,63  | 2,03  | 15,18  |
| Nga kontributet | 0,37  | 0,51  | 0,53  | 0,57   | 0,63  | 0,66  | 0,77  | 0,71  | 0,74  | 0,77  | 0,84  | 1,17  | 8,27   |
| Nga mjetet      | 0,35  | 0,37  | 0,40  | 0,45   | 0,49  | 0,54  | 0,60  | 0,64  | 0,68  | 0,73  | 0,80  | 0,86  | 6,91   |

Provizionet e transaksionit, në lidhje me transaksionet për fitimin ose për transferimin e mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional, paguhet nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional për personat juridikë të përzgjedhur që ofrojnë shërbime me letra me vlerë, brenda dhe jashtë vendit. Provizionet e transaksionit llogariten si përqindje e vlerës së çdo transaksioni të lidhur.

Gjatë vitit 2021, nga SAVAd janë arkëtuar gjithsej 1,80 milionë denarë provizione të transaksionit, nga KBPd janë arkëtuar gjithsej 1,42 milionë denarë dhe nga TRIGLAVd janë arkëtuar gjithsej 0,21 milionë denarë provizione të transaksionit.

## 5.8 Pagesa e pensioneve nga sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital

Kushtet për fitimin e së drejtës së pensionit janë të njëjta edhe për shtyllën e parë, edhe për shtyllën e dytë: kufiri i moshës 64 vjeç për meshkujt, përkatësisht 62 vjeç për femrat, me minimum 15 vjet stazh pune.

Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit familjar dhe pensionit invalidor, si dhe nga pensioni minimal. Pensioni nga shtylla e parë llogaritet si pension i përkufizuar sipas formulës së caktuar paraprakisht (përqindja e caktuar, në varësi të viteve të stazhit, të shumëzuar me bazën pensionale, të përcaktuar me rroga të valorizuara për gjithë kohëzgjatjen e punës).

Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, në formën e zgjedhur nga anëtar:

- anuiteti pensional me të gjithë shumën e mjeteve, të akumuluar në llogarinë individuale të anëtarit; anuiteti paguhet deri në fund të jetës, nga shoqëria e sigurimit, e autorizuar për këtë qëllim, ose

- tërheqjet e programuara, nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale të anëtarit dhe paguhet nga shoqëria që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional, ose

- kombinimi i metodave të lartpërmendura.

Sigurimi i anuiteteve pensionale dhe tërheqjeve të programuara rregullohet me Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga finansimi kapital i sigurimit pensional.

Nëse i siguruari i cili e ka realizuar të drejtën e pensionit invalidor është anëtar i shtyllës së dytë, shuma e përgjithshme e mjeteve në llogarinë e këtij anëtar transferohet në Fondin e SPIMV-së dhe pagesa e plotë e pensionit invalidor paguhet nga Fondi i SPIMV-së. Me përjashtim, nëse mjetet e akumuluar në llogarinë e anëtarit janë më shumë se shuma e nevojshme për pagesën e pensionit invalidor, në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, atëherë anëtar mund të zgjedhë në vend të atij pensioni të përdorë pensionin e shtyllës së dytë.

Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional të shtyllës së dytë, anëtarët e të cilit kanë të drejtën e pensionit familjar, shuma e përgjithshme e mjeteve në llogarinë e këtij anëtar transferohet në Fondin e SPIMV-së dhe pagesa e plotë e pensionit familjar paguhet nga Fondi i SPIMV-së. Me përjashtim, nëse mjetet e akumuluar në llogarinë e anëtarit janë më shumë se shuma e nevojshme për pagesën e pensionit familjar, në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, atëherë përdoruesi i pensionit familjar mund të zgjedhë, në vend të atij pensioni, të përdorë pensionin e shtyllës së dytë.

Në vitin 2021 ishin realizuar 70 pensione invalidore dhe 286 pensione familjare nga anëtarët e shtyllës së dytë, përkatesisht anëtarët e familjes së anëtarit të vdekur, për çka mjetet e akumuluaru të tyre ishin transferuar në Fondin e SPIMV-së, nga ku paguhet pensioni invalidor, përkatesisht pensioni familjar. Në vitin 2021, për 10 anëtarë të shtyllës së dytë filloi të paguhet pensioni i pleqërisë nga shtylla e dytë, nëpërmjet tërheqjeve të programuara. Ndërsa në vitin 2021, u pagua pensioni i pleqërisë nga shtylla e dytë nëpërmjet tërheqjeve të programuara, për gjithsej 17 anëtarë të pensionuar (duke i përfshirë anëtarët që filluan t'i tërheqin mjetet në vitet paraprahe).

Parashihen edhe raste në të cilat bëhet pagesa e mjeteve të llogarisë individuale të anëtarit, dhe më pas mos të realizojë të drejtën e pensionit, si:

- kur anëtari i vdekur i fondit të detyrueshëm pensional nuk ka anëtarë të familjes të cilët kanë të drejtën e pensionit familjar, atëherë mjetet në llogarinë e atij anëtari bëhen pjesë e trashëgimisë së trashëgimtarit dhe me to veprohet në përputhje me Ligjin për trashëgiminë;

- kur anëtari i fondit të detyrueshëm pensional nuk do ta fitojë të drejtën e pensionit të pleqërisë sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, për shkak se nuk ka stazh të pensionit të paktën 15 vjet, mund të marrë pensionin vetëm nga mjetet e shtyllës së dytë, nëse pensioni është më i madh ose i barabartë me 40% të shumës më të ulët të pensionit dhe nëse shumë e llogaritur e pensionit është më e vogël se 40% e shumës më të ulët të pensionit, fondi i detyrueshëm pensional anëtarit papritur do t'ia paguajë mjetet e akumuluaru në llogarinë e tij. Realizimi i pensionit vetëm nga mjetet e shtyllës së dytë dhe pagesa e gjithsej mjeteve të akumuluaru në këto raste mund të bëhet pas mbushjes së moshës 65 vjeç.

Gjatë vitit 2021 janë paguar mjetet si trashëgimi nga llogaritë individuale të 75 anëtarëve të vdekur. Gjithashtu, janë paguar mjete të njëhershme për 1 person.


Një pasqyrë më e detajuar e pensioneve dhe pagesave të realizuara për anëtarët e shtyllës së dytë në vitin 2021, sipas fondeve të detyrueshme pensionale, është dhënë në tabelën 5.12.

Tabela 5.12. Pensionët e realizuara dhe pagesat në emër të anëtarëve të shtyllës së dytë në vitin 2021

| Lloji i pensionit dhe pagesës / Fondi i detyruar pensional | SAVAd | KBPd | TRIGLAVd | Totali |
|------------------------------------------------------------|-------|------|----------|--------|
| Pension invaliditeti                                       | 34    | 33   | 3        | 70     |
| Pension familjar                                           | 130   | 149  | 7        | 286    |
| Pension moshe – tërheqje të programuara                    | 4     | 6    | 0        | 10     |
| Pagesë e njëhershme – anëtar                               | 0     | 1    | 0        | 1      |
| Pagesë e njëhershme – trashëgimi                           | 45    | 30   | 0        | 75     |
| Totali                                                     | 213   | 219  | 10       | 442    |

Në grafikun 5.27. është paraqitur struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e dytë, në katërmbëdhjetë vitet e ekzistimit të shtyllës së dytë, përfundimisht me vitin 2021. Numri i pagesave është shumë i vogël, sepse anëtarët janë të rinj. Pjesa më e madhe e pagesave janë në rastet e vdekjes së anëtarit, përmes pensionit të realizuar familjar, ose pagesës së trashëgimisë, pastaj pagesat në bazë të pensionit të realizuar invalidor, ndërsa më i vogël është numri i pagesave të njëhershme për anëtarët dhe pagesave për anëtarët përmes tërheqjeve të programuara.

Grafiku 5.27. Struktura e pensioneve të realizuara dhe pagesave nga shtylla e dytë nga fillimi i sistemit



## 6 Të dhëna për fondet pensionale vullnetare

---

- 6.1 Qëllimi i sigurimit pensional vullnetar me financim kapital
- 6.2 Anëtarësia në fondet pensionale vullnetare
- 6.3 Kalimi i një anëtari nga një llogari në një tjetër, brenda të njëjtit ose në një fond tjetër pensional vullnetar
- 6.4 Kontributet në fondet pensionale vullnetare
- 6.5 Investimi dhe struktura e portfolit të fondeve pensionale vullnetare
- 6.6 Mjetet neto, njësia llogaritare dhe norma e të ardhurave të fondeve pensionale vullnetare
- 6.7 Kompensimet e fondeve pensionale vullnetare
- 6.8 Pagesa e kompensimeve pensionale të sigurimit pensional vullnetar me financim kapital

## 6. Të dhëna për fondet pensionale vullnetare

Në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, mund të vërehet rritje të rritur të anëtarësimit në shtyllën e tretë. Në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital, përfundimisht me vitin 2021 ka gjithsej 27.772 anëtarë, që do të thotë rritje të anëtarësimit për vitin përkatës për afro 6,75%. Nga numri total i anëtarëve në shtyllën e tretë afro 44% janë anëtarë me llogari individuale vullnetare, ndërsa afro 56% janë pjesëmarrës në skemë pensioni me llogari profesionale. Fondi i ri pensional vullnetar bëri një lëvizje modeste në kalimet e anëtarëve nga një në tjetër fond pensional vullnetar në vitin 2021.

Gjatë vitit 2021, në fondet pensionale vullnetare janë paguar gjithsej afro 407,71 milionë denarë.

Mjetet totale të fondeve pensionale vullnetare u rritën për 25% dhe arritën afro 2,87 miliardë denarë, gjë që paraqet afro 0,40% të PBV-së së RMV-së. Struktura e portofolit investues të fondeve pensionale vullnetare, gjithashtu, nuk dallohet dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Fillimi i punës së fondit të tretë pensional vullnetar nuk ndikoi shumë në strukturën totale të investimeve të fondeve pensionale vullnetare duke pasur parasysh faktin se në vitet fillestare të punës fondi i ri ende disponon me mjete që janë me vëllim të vogël lidhur me mjetet totale të fondeve pensionale vullnetare.

Në vitin 2021 vlera e njësishë kontabël të SAVAv shënoi rritje prej 10,22% të KBPv rritje prej afro 10,48%, ndërsa vlera e njësishë kontabël të TRIGLLAVv shënoi rritje prej 3,48% nga fillimi i punës.

Në nivel të shtyllës së tretë, në periudhën shtatëvjeçare 2015-2021, u realizuan të ardhura mesatare të reduktuar në nivel vjetor prej 5,85% në shumë nominale përkatësisht 4,35% në shumë reale, të përlogaritur përmes ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive kontabël të fondeve pensionale vullnetare.

Në vitin 2021 u realizuan 264 kompensime dhe pagesa pensionale nga shtylla e tretë.

### 6.1 Qëllimi i sigurimit pensional vullnetar me financim kapital

Qëllimi primar i finansimit kapital vullnetar të sigurimit pensional është sigurimi i të ardhurave më të larta pas daljes në pension, për personat e siguruar që tashmë janë të siguruar në sistemin pensional njëshpyllësh dhe/ose dyshtyllësh, për të siguruar pension për personat që nuk janë të përfshirë nga sigurimi i detyrueshëm pensional personalisht për veten ose nga personat e tjerë dhe sigurimin e parakushteve për vendosjen e skemave pensionale profesionale në procesin e harmonizimit të sistemit të sigurimit social në RMV me sistemet e BE-së. Parimet themelore të finansimit kapital vullnetar të sigurimit pensional janë: sigurimi i mjeteve shtesë në rast të pleqërisë, anëtarësimi në bazë vullnetare, finansimi kapital në parimin e kontributeve të përcaktuara, investimi i mjeteve në bazë të sigurisë, diversifikimi i rrezikut dhe mbajtja e likuiditetit adekuat, si dhe transparencja.

Sigurimi pensional vullnetar mundëson mbulimin e grupit të madh personash nga popullsia e RMV-së, si dhe të personave që nuk janë shtetas të RMV-së. Kjo mundëson kursimin shtesë për pleqërinë, gjë që rrit sigurinë materiale në pleqëri. Për më tepër, në përputhje me praktikën e zakonshme në shumë vende evropiane, ku ekzistojnë skemat pensionale profesionale, përmes të cilave punëdhënësit, ose shoqatat e qytetarëve, organizojnë dhe financojnë sigurim pensional shtesë për të punësuarit e tyre, përkatësisht anëtarët, kjo është e mundur edhe në RMV. Meqë sistemet evropiane të sigurimit social janë nën presion, që vazhdimisht rritet, pensionet profesionale në të ardhmen do të luajnë gjithnjë e më shumë rol në plotësimin e të ardhurave pas daljes në pension. Për këto shkaqe, duhet të zhvillohen pensione profesionale, në mënyrë shtesë të sigurimit social, me qëllim të ofrimit të sigurimit të sigurt, të përhershëm dhe efikas social, që duhet të garantojë standard të mirë jetësor në pleqëri. Në shtyllën e tretë, punëdhënësi, ose shoqata e qytetarëve (siguruesi), mund të organizojë dhe të financojë skemën pensionale profesionale dhe të paguajë kontribut në fondin pensional vullnetar për të punësuarit dhe anëtarët e tij. Më shumë punëdhënës, ose më shumë shoqata të qytetarëve, mund të organizojnë dhe të financojnë së bashku skema pensionale profesionale. Siguruesi nënshkruan kontratë me shoqërinë që ka zgjedhur për të menaxhuar fondin pensional vullnetar, ku do të përfshihet edhe skema pensionale profesionale.

Pritet që finansimi kapital vullnetar i sigurimit pensional të ketë ndikim të rëndësishëm shtesë në ekonominë në tërësi, nëpërmjet rritjes së kursimit të popullsisë, rritjes së fuqisë së investimit dhe nxitjes së zhvillimit dhe thellimit të tregut të kapitalit, nëpërmjet investimit të mjeteve në fondet pensionale vullnetare, rritjes së kërkesave për instrumente të reja dhe nëpërmjet shërbimeve të reja finansiare, etj.

Finansimi kapital vullnetar i sigurimit pensional u bë operativ në gjysmën e dytë të vitit 2009, ashtu që shoqërive ekzistuese u janë dhënë leje për menaxhimin e fondeve pensionale vullnetare. Fondi i hapur pensional vullnetar "NLB Pension Plus" - Shkup filloi me punë më 15.7.2009, ndërsa KB Prvo Fondi i Parë i Hapur Pensional Vullnetar - Shkup, më 21.12.2009. Në qershor 2018, MAPAS dha leje për ndryshimin e emrit të fondit pensional Fondi i Hapur Pensional Vullnetar - "NLB Pensioni Plus" Shkup në Fondin e Hapur Pensional Vullnetar Sava Pensioni Plus. Fondi i Hapur i Detyrueshëm Pensional Triglav - Shkup filloi me punë më 1.3.2021.



## 6.2 Anëtarësia në fondet pensionale vullnetare

Një person mund të fitojë anëtarësinë në fondin pensional vullnetar në tre forma:


- 1) Me nënshkrimin e kontratës për anëtarësim në fondin pensional vullnetar ndërmjet personit dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë individuale vullnetare,
- 2) Me nënshkrimin e kontratës për anëtarësim në fondin pensional vullnetar ndërmjet personit, personit fizik që paguan në emër dhe për llogari të personit (paguesit) dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë individuale vullnetare,
- 3) Me pjesëmarrjen në skemën pensionale profesionale, të organizuar nga punëdhënësi i tij ose nga shoqata në të cilën është anëtar dhe me hapjen e llogarisë profesionale.

NNjë person mund të ketë vetëm një llogari individuale vullnetare dhe një llogari profesionale. Këto llogari mund të jenë në të njëjtin fond ose në fondin e ndryshëm pensional vullnetar.

Në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 mund të shohim rritjen e anëtarësimit në fondet pensionale vullnetare. Në finansimin kapital vullnetar të sigurimit pensional, me gjendjen më 31.12.2021 ka gjithsej 27.772 anëtarë, që do të thotë 1.756 anëtarë më shumë krahasuar me 31.12.2020, përkatësisht ka rritje të anëtarësimit prej rreth 6,75%. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve në shtyllën e tretë, 12.088 ose rreth 44% janë anëtarë me llogari individuale vullnetare, ndërsa 15.684 ose rreth 56% janë pjesëmarrës në skemën pensionale me llogari profesionale. Meqë fondi i ri pensional vullnetar ka numër relativisht të vogël të anëtarëve (0,35% e anëtarëve janë në TRIGLAVv), për sa i përket shpërndarjes së anëtarëve sipas fondeve pensionale vullnetare, me gjendjen më 31.12.2021, në fondet pensionale vullnetare që punojnë që nga viti 2009 nuk ka ndryshim evident krahasuar me gjendjen e vitit të kaluar, përkatësisht rreth 43,67% e anëtarëve janë në SAVAv, ndërsa rreth 56,06% janë në KBPv.

Nga grafiku 6.1, është paraqitur struktura e anëtarëve sipas fondeve pensionale vullnetare dhe sipas llojit të anëtarësimit, në vitin 2021, në nivel tremujor, mund të vërehet dallimi i dukshëm për sa i përket llojit të anëtarësimit të të tria fondet pensionale vullnetare. Pra, SAVAv ka numër më të madh të anëtarëve me llogaritë individuale vullnetare (66,42%), KBPv ka më shumë anëtarë në skemat pensionale me llogaritë profesionale (76,37%), ndërsa TRIGLAVv ka shpërndarjen më të barabartë të anëtarësimit edhe pse një numër pak më i madh janë anëtarë me llogaritë individuale vullnetare (56,00%). Sa i përket strukturës së anëtarëve sipas llojit më 31.12.2021, edhe te SAVAv, edhe te KBPv nuk ka ndryshim të rëndësishëm në krahasim me gjendjen në vitin e kaluar.

Grafiku 6.1. Struktura e anëtarëve sipas fondeve pensionale vullnetare dhe sipas llojit të anëtarësisë




Nga përvoja e deritanishme, më së shpeshti, anëtarët që kanë llogari individuale vetë i paguajnë mjetet, ndërsa në një numër të vogël të rasteve ka anëtarë për të cilët kontribut paguan paguesi (nga gjithsej 12.088 anëtarë që kanë llogari individuale, vetëm 621 anëtarë ose 5% kanë pagues). Finansimi kapital vullnetar i sigurimit pensional mundëson anëtarësimin e personave që nuk janë shtetas të RMV-së. Në ekzistimin e deritanishëm të shtyllës së tretë ka shumë pak anëtarë që janë shtetas të huaj (0,02% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve).


Lidhur me pjesëmarrjen e anëtarëve në skemat pensionale profesionale, në SAVAv, 4.072 anëtarë janë pjesëmarrës në 1.205 skema pensionale profesionale, në KBPv 11.579 anëtarë janë pjesëmarrës në 2.910 skema pensionale profesionale dhe në TRIGLAVv, 33 anëtarë janë pjesëmarrës në 5 skemat pensionale profesionale. Ekzistojnë skema pensionale profesionale me disa dhjetëra anëtarë dhe

skema pensionale profesionale vetëm me 1 deri në 2 anëtarë. Nga numri i përgjithshëm i skemave, 19 skemat pensionale profesionale kanë mbi 100 anëtarë, katër skema kanë mbi 500 anëtarë, njëra prej të cilave ka mbi 1.000 anëtarë. Shpërndarja e anëtarëve në skemat pensionale profesionale sipas fondeve është dhënë në grafikun 6.2., ku në mënyrë të veçantë janë paraqitur vetëm skemat që kanë më shumë se 100 anëtarë, ndërsa skemat e tjera përfshihen në zërin “të tjerët”.

Grafiku 6.2. Struktura e anëtarëve sipas fondeve pensionale vullnetare dhe llojit të anëtarësisë



Grafiku 6.3. Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë sipas moshës, gjinisë dhe llojit të anëtarësisë




Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë, sipas moshës, gjinisë dhe llojit të anëtarësisë është paraqitur në grafikun 6.3.

Nga kjo pasqyrë grafike mund të vërehet se në shtyllën e tretë në krahasim me shtyllën e dytë ka më shumë anëtarë më të vjetër. Diçka rreth 60% e anëtarëve me llogari individuale vullnetare janë të moshës deri në 45 vjeç, ndërsa rreth 60% e anëtarëve me llogari profesionale janë të moshës deri në 50 vjeç. Anëtarët që kanë llogari profesionale janë më të vjetër se anëtarët me llogari individuale. Mosha mesatare e anëtarëve me llogari individuale është 44 vjeç për meshkujt dhe 43 vjeç për femrat, ndërsa mosha mesatare e anëtarëve me llogari profesionale është 48 vjeç për meshkujt dhe 48 vjeç për femrat, ndërsa mosha mesatare e të gjithë anëtarëve gjithsej është 46 vjeç.

Pjesëmarrja e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të shtyllës së tretë në popullsinë e përgjithshme të aftë për punë dhe në popullsinë e përgjithshme aktive është modeste. Me gjendjen në fund të vitit 2021, vetëm rreth 1,7% e popullsisë së përgjithshme të aftë për punë në RMV janë anëtarë të shtyllës së tretë, përkatësisht rreth 2,9% e popullsisë së përgjithshme aktive në RMV janë anëtarë të shtyllës së tretë. Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë, në popullsinë e përgjithshme të aftë për punë dhe popullsinë aktive në RMV, sipas grupmoshave dhe sipas gjinisë, më 31.12.2021, është paraqitur në grafikun 6.4.

Grafiku 6.4. Struktura e anetareve ne shtyllen e trete ne numrin e pergjithshem te popullatese se afte per pune dhe populltes aktive, baze mohe,grupit dhe gjinise




Nga kjo pasqyrë grafike mund të vërehet se sipas grupmoshave pjesëmarrjen më të madhe në finansimin kapital vullnetar të sigurimit pensional e zë popullsia aktive në moshën mbi 65 vjeç (rreth 11% meshkuj dhe rreth 17% femra). Ky rezultat tregon se ka potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e shtyllës së tretë.

Struktura e anëtarëve në fondet pensionale vullnetare sipas rajoneve statistikore në RMV është dhënë në grafikun 6.5.

Shumica e anëtarëve në të dyja fondet pensionale vullnetare janë nga Rajoni i Shkupit, 6.685 anëtarë në KBPv, 4.984 anëtarë në SAVAv dhe 57 anëtarë në TRIGLAVv. Më pak anëtarë në SAVAv janë nga Rajoni i Pollogut (682 anëtarë në SAVA dhe), më pak anëtarë në KBPv janë nga Rajoni Juglindor (627), ndërsa te TRIGLAVv nuk ka fare anëtarë nga Rajoni Lindor.

Grafiku 6.5. Struktura e anëtarëve të shtyllës së tretë sipas rajoneve statistikore



<sup>15</sup>Rajonet statistikore janë definuar sipas Entit shtetëror të statistikave – njësi territoriale. Nomenklatura e njësi territoriale është bazuar mbi organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë dhe është harmonizuar me klasifikimin e Bashkimit Evropian.

## 6.3 Kalimi i një anëtari nga një llogari në një tjetër, brenda të njëjtit ose në një fond tjetër pensional vullnetar

Personat kanë të drejtën e zgjedhjes së fondit pensional vullnetar dhe të drejtën e ndryshimit të fondit të zgjedhur pensional vullnetar, sipas dëshirës të tyre, në çdo kohë. Nëse anëtari është anëtar i fondit ekzistues pensional vullnetar për më shkurt se 12 muaj, gjatë transferimit duhet të paguajë kompensimin për transferim. Përndryshe, transferimi është falas. Gjatë transferimit transferohen edhe mjetet e përgjithshme nga llogaria e anëtarit. Gjithashtu, në rast transferimi të pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale nga njëri sigurues në tjetrin, ai ka të drejtën e transferimit të mjeteve të kursyera në skemën profesionale në llogarinë profesionale ose në llogarinë individuale vullnetare, nëse siguruesi tjetër nuk ka organizuar skemë pensionale profesionale ose nuk e përfshin edhe personin në të. Anëtari, i cili është pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale, ka të drejtën e transferimit të mjeteve në llogarinë individuale vullnetare, nëse nuk është i punësuar ose nuk është anëtar i shoqatës së qytetarëve.

Në tabelën 6.1. janë dhënë të dhënat për numrin e anëtarëve që janë transferuar nga njëri fond pensional vullnetar në tjetrin dhe për shumën e mjeteve të transferuara nga njëri fond pensional vullnetar në tjetrin, mbi këtë bazë, gjatë vitit 2021.

Tabela 6.1. 1 Kalimi i anëtarëve nga një fond pensional vullnetar në një tjetër

| 2021                                         |          | FPV-ja në të cilën janë transferuar anëtarët, përkatësisht në të cilën janë bartur mjetet |           |           |           |
|----------------------------------------------|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
|                                              |          | SAVAv                                                                                     | KBPv      | TRIGLAVv  | Gjithsej  |
| Anëtarët që janë transferuar nga FPV-ja      | SAVAv    | -                                                                                         | 24        | 7         | 31        |
|                                              | KBPv     | 24                                                                                        | -         | 20        | 44        |
|                                              | TRIGLAVv | 0                                                                                         | 0         | -         | 0         |
|                                              | Gjithsej | 24                                                                                        | 24        | 27        | 75        |
| Mjetet e transferuara nga FPV-ja (në denarë) | SAVAv    | -                                                                                         | 2.787.277 | 356.665   | 3.143.942 |
|                                              | KBPv     | 3.244.009                                                                                 | -         | 917.856   | 4.161.865 |
|                                              | TRIGLAVv | 0                                                                                         | 0         | -         | 0         |
|                                              | Gjithsej | 3.244.009                                                                                 | 2.787.277 | 1.274.521 | 7.305.807 |

## 6.4 Kontributet në fondet pensionale vullnetare

Pagesa e kontributit vullnetar mund të bëhet vetëm për personin që i përmbush kushtet për anëtarësim në fondin pensional vullnetar, në përputhje me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me finansim kapital. Pagesa e kontributit vullnetar, në emër dhe për llogari të anëtarit që ka llogari individuale vullnetare, mund të bëhet nga anëtari dhe/ose paguesi. Pagesën e kontributit vullnetar, në emër dhe për llogari të anëtarit që ka llogari profesionale, mund ta kryejë vetëm siguruesi. Pagesat bëhen nga llogaria e transaksionit të anëtarit dhe/ose paguesit ose siguruesit. Kontributi vullnetar paguhet në llogari të veçantë në para të fondit vullnetar, e cila mbahet pranë kujdestarit të pronës dhe shpërndahet në llogarinë individuale vullnetare, ose në llogarinë profesionale të anëtarit, në varësi të mënyrës së anëtarësimit dhe pas përmbushjes së kushteve për anëtarësim.

Anëtari, paguesi dhe siguruesi kanë të drejtë të përcaktojnë lirisht lartësinë e shumës së paguar të kontributit vullnetar dhe dinamikën e pagesës, ndërsa ndryshimi i lartësisë së pagesës, ose ndërprerja e pagesës, nuk ndikojnë në të drejtën e anëtarësimit në fond, përkatësisht nuk do të thotë ndërprerje e anëtarësimit. Shumat e kontributeve vullnetare përcaktohen nga siguruesi, për të gjithë pjesëmarrësit në skemën pensionale profesionale, të cilën ai e organizon dhe e finanson dhe i përcakton si përqindje të roqës së anëtarit, i cili përfshihet në skemën pensionale profesionale.

Gjatë vitit 2021 në fondet pensionale vullnetare janë paguar gjithsej rreth 407,71 milionë denarë, që është rreth 0,06% të BPV-së së RMV-së. Kontributet e detajuara të paguara sipas muajve (në milionë denarë) janë paraqitur në tabelën 6.2.


Tabela 6.2 Kontributet në shtyllën e tretë sipas muajve dhe fondeve

(në milione denare)

|          | Gjithsej 2018 | Jan   | Feb.  | Mar.  | Prill | Maj   | Qer.  | Kor.  | Gusht | Shtat. | Tet.  | Nen.  | Dhjet. | Gjithsej 2019 |
|----------|---------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|--------|-------|-------|--------|---------------|
| SAVAv    | 161,68        | 13,52 | 9,21  | 12,17 | 16,32 | 9,48  | 18,16 | 14,73 | 11,40 | 12,28  | 24,87 | 14,83 | 34,55  | 191,52        |
| KBPv     | 155,07        | 10,52 | 15,57 | 19,37 | 12,59 | 12,01 | 10,75 | 27,15 | 7,76  | 11,28  | 17,39 | 20,23 | 49,78  | 214,39        |
| TRIGLAVv |               |       |       | 0,13  | 0,24  | 0,05  | 0,31  | 0,18  | 0,12  | 0,14   | 0,12  | 0,13  | 0,37   | 1,80          |
| Gjithsej | 316,76        | 24,03 | 24,77 | 31,54 | 28,91 | 21,49 | 28,92 | 41,87 | 19,16 | 23,56  | 42,26 | 35,07 | 84,33  | 407,71        |

Në vitin 2021, kontributet vullnetare të përgjithshme të paguara në shtyllën e tretë shënuan rritje prej 28,71% krahasuar me vitin 2020. Krahasuar me vitin paraprak, shuma e kontributeve vullnetare të përgjithshme të paguara në SAVAv u rrit me rreth 18,45%, ndërsa KBPv rriti shumën e kontributeve vullnetare të përgjithshme të paguara me rreth 38,25%. Në vitin 2021 në KBPv është paguar shumë më e madhe e kontributeve vullnetare në krahasim me SAVAv. Në vitin 2021, pjesëmarrja e kontributeve vullnetare në të tria fondet pensionale vullnetare, të cilat paguhen në llogaritë profesionale është 49%, ndërsa pjesëmarrja e kontributeve vullnetare të paguara në llogaritë individuale vullnetare është 51%. Ekziston dallim i vogël në këtë shpërndarje për sa u përket fondeve, përkatësisht të SAVAv dhe të TRIGLAVv 55% e kontributeve të përgjithshme vullnetare janë paguar në llogaritë individuale vullnetare, ndërsa 45% në llogaritë profesionale, ndërsa të KBPv 52% e kontributeve të përgjithshme vullnetare janë paguar në llogaritë profesionale, ndërsa 48% në llogaritë individuale vullnetare. Shpërndarja e pagesave sipas llojit të llogarisë në të cilën paguhen dhe sipas fondeve, në nivel mujor, është dhënë në grafikun 6.6.

Grafiku 6.6. . Sistemi i pagesave në shtyllën e tretë sipas llojit të llogarisë



## 6.5 Investimi dhe struktura e portfolit të fondeve pensionale vullnetare

Edhe në finansimin kapital vullnetar të sigurimit pensional, si në finansimin e detyrueshëm kapital të sigurimit pensional, në fazën fillestare përdoret kontrolli proaktiv dhe kufizimet sasiore dhe cilësore të investimeve. Megjithatë, në dallim nga finansimi i detyrueshëm kapital i sigurimit pensional, në finansimin kapital vullnetar të sigurimit pensional ka kushte më liberale lidhur me investimin.


Përveç instrumenteve të lejuara në fondet e detyrueshme pensionale, në fondet pensionale vullnetare, për investimet jashtë vendit, lejohet edhe investimi në letrat debitoare me vlerë, të emetuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe Banka Botërore, si dhe nga letrat debitoare me vlerë, të emetuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale. Meqë është e domosdoshme të arrihet diversifikimi adekuat midis llojeve të ndryshme të investimeve dhe fondeve pensionale vullnetare, parashihen kufizimet maksimale për investimin në kompani të caktuar dhe në grup ekonomik të caktuar dhe kufizime maksimale në shumat që mund të investohen në lloje të caktuara instrumentesh. Për t'i parandaluar investimet në instrumentet që nuk janë të përshtatshme për të investuar në fondet pensionale vullnetare, janë të ndaluara me ligj investimet në aksionet, obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë, të cilat nuk kuotojnë në tregun zyrtar ose që nuk tregtohen publikisht, instrumentet me të cilat nuk mund juridikisht të disponohen, instrumentet që nuk mund të vlerësohen menjëherë, më shumë forma të pronës që nuk mund të vlerësohen menjëherë dhe zërat me vlerë të pasigurt. Kufizimet maksimale të investimeve janë paraqitur në tabelën 6.3.

Struktura e investimeve të fondeve pensionale vullnetare SAVAv dhe KBPv, që nga fillimi i punës së fondeve pensionale vullnetare (për periudhën 2009 - 2020, në nivel vjetor dhe për vitin 2021, në nivel tremujor), është paraqitur në grafikun 6.7. dhe në grafikun 6.8. Struktura e investimeve të fondit pensional vullnetar TRIGLAVv nga fillimi i punës së fondit (1.3.2021) në nivel tremujor për vitin 2021 është paraqitur në grafikun 6.9.


Tabela 6.3. Kufizimet maksimale të investimit

| Lloji i instrumentit                                                                                                                                                                                                                                                                  | Limiti maksimal |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|
| Investimet jashtë vendit (BE, OECD)                                                                                                                                                                                                                                                   | 50%             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>kambialet dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga qeveri të huaja dhe banka qendrore të shteteve të huaja dhe letra debitoare me vlerë, të lëshuara nga Banka evropiane qendrore, Banka evropiane e investimeve, Banka Botërore</li> </ul> | 50%             |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>letra debitoare me vlerë të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, kompanive të huaja joqeveritare ose bankave dhe dokumentet për aksione dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga fondet e investimeve</li> </ul>                   | 30%             |
| <b>Letra me vlerë të lëshuara ose të garantuara nga tregu vendas i RM ose BPRM</b>                                                                                                                                                                                                    | <b>80%</b>      |
| <b>Depozita bankare, certifikata depozitash, akte komerciale, obligacione dhe letra të tjera me vlerë, mbi bazën e hipotekave të lëshuara nga bankat vendase.</b>                                                                                                                     | <b>60%</b>      |
| <b>Obligacione të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe shoqëritë aksionare vendase që nuk janë banka dhe akte komerciale nga shoqëritë aksionare vendase që nuk janë banka.</b>                                                                                           | <b>40%</b>      |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>obligacione të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale</li> </ul>                                                                                                                                                                         | 10%             |
| Aksione të lëshuara nga shoqëritë aksionare vendase                                                                                                                                                                                                                                   | 30%             |
| Dokumente për pjesë kapitali dhe aksione të fondeve maqedonase të investimit                                                                                                                                                                                                          | 5%              |


Grafiku 6.7. Struktura e investimeve në fondin pensional vullnetar SAVAv



Grafiku 6.8. Struktura e investimeve në fondin pensional vullnetar KBPv




Grafiku 6.9. Struktura e investimeve në fondin pensional vullnetar TRIGLAV




Struktura e investimeve të fondeve pensionale vullnetare, më 31.12.2021, nuk dallohet shumë në krahasim me strukturën e investimeve të fondeve pensionale vullnetare, më 31.12.2020 dhe kjo është paraqitur në grafikun 6.10. Fillimi i punës së fondit të ri pensional vullnetar nuk ndikoi shumë në strukturën e përgjithshme të investimeve të fondeve pensionale vullnetare, duke pasur parasysh faktin se në vitet fillestare të punës, fondi i ri ka mjete të vëllimit të vogël që paraqesin pjesëmarrje të vogël në mjetet e përgjithshme të fondeve pensionale vullnetare. Në vitin 2021, pjesëmarrja e obligacioneve nga emetuesit vendas, ku përfshihen obligacionet shtetërore vendase (49,88%) dhe obligacioni korporativ (obligacioni perpetual i emetuar nga banka - 0,61%), krahasuar me vitin paraprak, shënoi rritje të vogël dhe është 50,49%. Pjesëmarrja e depozitave në bankat vendase është ulur krahasuar me vitin paraprak dhe është 11,36%. Pjesëmarrja e aksioneve nga emetuesit vendas mbetet pothuajse në të njëjtin nivel, krahasuar me vitin paraprak dhe është 8,21%. Një pjesë shumë e vogël e investimeve të fondeve pensionale vullnetare u përkasin investimeve në aksionet e fondeve vendase të investimeve (0,01%). Në vitin 2021, pjesëmarrja e investimeve jashtë vendit ishte rritur, krahasuar me vitin paraprak, dhe është 29,21% (24,22% në pjesëmarrjet e fondeve të investimeve dhe 4,99% në aksionet). Pjesa tjetër e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare përbëhet nga mjetet në para 0,66% dhe kërkesat 0,06%.

Gjatë vitit 2021, të tria fondet pensionale vullnetare kanë investuar në kuadër të kufijve maksimalë të investimeve. Në grafikun 6.11. është paraqitur pjesëmarrja e përqindjes në portofol sipas klasave të mjeteve të SAVAv, KBPv dhe TRIGLAVv dhe kufizimet ligjore më 31.12.2021.

Grafiku 6.11. Klasat e mjeteve në portfolin e fondeve pensionale vullnetare krahasuar me kufizimet ligjore



Grafiku 6.9. Struktura e investimeve në shtyllën e trete dhe gjendja në 31.12.2019






Fondet pensionale vullnetare kanë ekspozim më të madh ndaj mjeteve në aksionet e emetuesve vendas (8,21%) krahasuar me fondet e detyrueshme pensionale. Kështu, ekspozimi i aksioneve në emetuesit vendas është dukshëm më i madh te SAVAv (13,85%) krahasuar me KBPv (2,72%). TRIGLAVv në vitin e parë të punës së tij nuk ka investime në aksionet e emetuesve vendas.


Në krahasim, lëvizja e vlerës së IBM10, OBM-së dhe vlerës së njësisë së kontabilitetit të fondeve pensionale vullnetare gjatë vitit 2021 është paraqitur në grafikun 6.12. Vlera e njësisë së kontabilitetit të SAVAv shënoi rritje prej 10,22%, ndërsa vlera e njësisë së kontabilitetit të KBPv u rrit prej 10,48% dhe vlera e njësisë së kontabilitetit TRIGLAVv që nga fillimi i punës së tij shënoi rritje prej 3,48%. IBM10, gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2020, shënoi rritje prej rreth 30,79%. OBM-ja, gjatë vitit 2021, shënoi rritje prej 0,46%<sup>3</sup>.

Grafiku 6.12. Lëvizja krahasuese e vlerës së IBM10, OBM-së dhe vlerës së njësisë së kontabilitetit të FPV-së, 2021




Edhe te fondet pensionale vullnetare, pjesa më e madhe e mjeteve në vitin 2021 janë investuar në letra shtetërore vendase me vlerë (43,63% në SAVAv, 56,01% në KBPv dhe 35,30% në TRIGLAVv). Kjo pasohet menjëherë nga investimet në instrumentet nga emetuesit / shoqëritë aksionare në sektorin financiar (34,75% në SAVAv dhe 40,13% në KBPv). Në TRIGLAVv, pjesëmarrja në instrumentet nga emetuesit / shoqëritë aksionare në sektorin financiar është më e ulët dhe arrin 16,28%. Në kuadër të këtij sektori, te SAVAv më e madhe është pjesëmarrja e aksioneve në fondet e investimeve të huaja dhe vendase (56,0%) dhe depozitave bankare vendase (33,1%) dhe më e vogël është pjesëmarrja e aksioneve në bankat vendase (4,3%), obligacionet e emetuara nga bankat vendase (3,5%) dhe shërbimet finansiare (3,1%). Te KBPv në kuadër të sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja (72,0%), ndërsa pjesa tjetër u përket depozitave bankare vendase (28,0%). Edhe në TRIGLAVv në kuadër të sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja dhe vendase (100%). Përveç sektorëve lartpërmendur, fondet pensionale vullnetare investojnë edhe në sektorë të tjerë: të mirat themelore, farmaci, të mirat e konsumit, industri, teknologji informatike, shërbime të komunikimit dhe energji, por me pjesëmarrje shumë më të vogël (nga 0,71% në 5,72%). Struktura e investimeve të fondeve pensionale vullnetare, sipas sektorëve, është paraqitur në grafikun 6.13.

Grafiku 6.12. Struktura e investimeve ne FPV sipas sektoreve



Grafiku 6.13. Struktura valutore e mjeteve ne FPV 2018-2021




Për sa i përket strukturës së valutës së mjeteve të fondeve pensionale vullnetare, të paraqitur në grafikun 6.14, mund të vërehet se pjesa më e madhe e mjeteve të SAVAv janë investuar në instrumentet në valutën vendase (44,34%), ndërsa pjesëmarrja në instrumentet në euro është 32,42%. Në vitin 2021, krahasuar me vitin e kaluar, SAVAv ka rritur pjesëmarrjen në instrumentet në denarë dhe ka zvogëluar pjesëmarrjen në instrumentet në euro. Në KBPv pjesa më e madhe e mjeteve janë investuar në instrumentet në valutën vendase (38,44%), ndërsa pjesëmarrja në instrumentet në euro është 33,72%. Në vitin 2021, krahasuar me vitin e kaluar, në KBPv pjesëmarrja në instrumentet në denarë është rritur, ndërsa pjesëmarrja në instrumentet në euro është zvogëluar. Pjesëmarrja e investimeve në dollarë amerikanë (22,07% të SAVAv dhe 27,84% të KBPv) është rritur krahasuar me vitin paraprak. Struktura e valutës së SAVAv përfshin edhe një pjesë të vogël të instrumenteve të investuara në franga zvicerane 1,18%. Struktura e valutës së TRIGLAVv dallon nga struktura e valutës së SAVAv dhe KBPv. Pësja e mjeteve të TRIGLAVv është në anën e mjeteve të investuara në instrumentet në denarë (75,92%) që pritet për fondin pensional që është ende në fillim të punës së tij. Më pas 12,44% e mjeteve të TRIGLAVv janë investuar në instrumentet në euro, ndërsa 11,65% e mjeteve janë investuar në instrumentet në dollarë amerikanë.

Nëse bëhet krahasimi me vendet që kanë sisteme të ngjashme pensionale me atë të Maqedonisë, mund të vërehen ngjashmëri, por edhe dallime në portfolet e investimeve të fondeve pensionale vullnetare. Në grafikun 6.15. është dhënë krahasimi i investimeve, më 31.12.2021, të fondeve pensionale vullnetare në RMV, me investimet e fondeve pensionale vullnetare në disa nga vendet e rajonit që kanë zbatuar finansimin kapital vullnetar të sigurimit pensional.

Nëse portfolet e fondeve pensionale vullnetare shqyrtohen sipas instrumenteve, mund të vërehet se fondet pensionale në pothuajse të gjitha vendet kanë ekspozimin më të lartë ndaj obligacioneve dhe letrave të tjera me vlerë, të garantuara nga shteti ose pushteti lokal (në Rumani 61%, në Maqedoninë e Veriut 50%, në Kroaci 49%, dhe me përqindjen më të ulët në Bullgari 42%). Ekspozimi ndaj depozitave bankare është më i lartë në Maqedoninë e Veriut me 11%. Në dallim nga Maqedonia e Veriut, në vendet e tjera ekspozimi ndaj depozitave është dukshëm më i ulët: Rumania (2%), Kroacia dhe Bullgaria (më pak se 1%) dhe për sa u përket investimeve në aksione dhe pjesëmarrje, përqindja më e madhe e mjeteve në aksione dhe pjesëmarrje është investuar në fondet pensionale në Bullgari (38%), Maqedoninë e Veriut (37%), pastaj në Kroaci (36%) dhe Rumani (31%). Fondet pensionale investuan edhe në obligacionet korporative 9% në fondet pensionale në Bullgari, 4% në Kroaci dhe në Rumani. Krahasuar me fondet pensionale në vendet e tjera, pjesëmarrja e investimeve në obligacionet korporative të fondet pensionale në Maqedoninë e Veriut është dukshëm më e ulët, 1%. Vetëm në Bullgari fondet pensionale kanë investuar në pronë të patundshme (2%) dhe në vendet e tjera, më së shpeshti, ky instrument edhe nuk lejohet. Lidhur me investimin jashtë vendit, fondet pensionale në Maqedoninë e Veriut kanë ekspozimin më të lartë në investimet e huaja me 29%, të ndjekur nga fondet pensionale në Kroaci 21% dhe Rumani me 9%.

Grafiku 6.14. Portfolio ne fondet pensionale vullnetare ne disa shtete dhe ne Maqedonine e Veriut



Burimet: [www.hanfa.hr](http://www.hanfa.hr); [www.fsc.bg](http://www.fsc.bg); [www.asfromania.ro](http://www.asfromania.ro) dhe përlogaritjet individuale.

<sup>16</sup>Të dhënat për investimet jashtë vendit për Bullgarinë, me gjendjen e datës 31.12.2018, nuk u gjetën në kuadër të të dhënave të marra

## 6.6 Mjetet neto, njësia llogaritare dhe norma e të ardhurave të fondeve pensionale vullnetare

Mënyra e llogaritjes së neto-mjeteve, njësisë së kontabilitetit dhe kontributit të fondeve pensionale vullnetare është e njëjtë si edhe për fondet e detyrueshme pensionale.

Ndryshimet në mjetet e fondeve pensionale vullnetare nga fillimi deri në fund të vitit ndodhin për shkak të:

- të hyrave të kontributeve,
- të dalave për shkak të kompensimeve dhe provizioneve të transaksionit,
- të hyrave për shkak të kthimit të tatimit personal,
- të dalave për shkak të pagesës së gabuar të kontributit të konvertuar,
- të hyrave për shkak të transferimit nga fondi tjetër pensional vullnetar (për personat që kanë qenë anëtarë të fondit tjetër, dhe më pas janë transferuar në fondin aktual),
- të dalave për shkak të transferimit nga fondi tjetër pensional vullnetar (personat që kanë qenë në fondin përkatës, dhe më pas janë transferuar në fondin tjetër),
- të dalave për shkak të pagesës së trashëgimisë,
- të dalave për shkak të pagesës së kompensimeve pensionale (pagesat e njehershme dhe të shumëfishta),
- fitimeve / humbjeve të (pa)realizuara nga investimet.

Duke u nisur nga vlera e neto-mjeteve, në fund të vitit paraprak, dhe duke i marrë parasysh të gjitha ndryshimet e mësipërme, vijmë te vlera e neto-mjeteve, në fund të vitit, (që është paraqitur në tabelën 6.4.).

Tabela 6.4. Ndryshimi i mjeteve në fondet pensionale vullnetare (në milione denare)

|                                                                                          | SAVA <sub>v</sub> | KBP <sub>v</sub> | TRIGLAV <sub>v</sub> |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|------------------|----------------------|
| Mjete neto më 31.12.2020                                                                 | 1.137,61          | 1.154,52         | 0,00                 |
| Kontribute                                                                               | 191,52            | 214,39           | 1,80                 |
| Kompensime nga kontributet                                                               | 4,57              | 5,91             | 0,05                 |
| Kontribute të reduktuara nga kompensimet e kontributeve                                  | 186,95            | 208,48           | 1,75                 |
| Pagesa në llogarinë individuale nga rimbursimi i tatimit personal                        | 0,00              | 0,00             | 0,00                 |
| Të dalat për pagesën e gabuar të kontributit të konvertuar                               | 0,02              | 2,79             | 0,00                 |
| Kompensime nga mjetet                                                                    | 12,57             | 11,58            | 0,01                 |
| Shpenzime por provizione ndërmjetësuese                                                  | 0,13              | 0,06             | 0,00                 |
| Transferimi nga fondi tjetër                                                             | 3,24              | 2,79             | 1,27                 |
| Kalimi në fondin tjetër                                                                  | 3,14              | 4,16             | 0,00                 |
| Pagesa e trashëgimisë                                                                    | 2,82              | 1,96             | 0,00                 |
| Pagesa e kompensimit pensional të pleqërisë – pagesë e njehershme / pagesë e shumëfishme | 27,45             | 33,33            | 0,00                 |
| Fitimi bruto nga investimet                                                              | 134,47            | 138,50           | 0,05                 |
| Fitimi neto nga investimet                                                               | 121,76            | 126,86           | 0,04                 |
| Mjetet neto më 31.12.2021                                                                | 1.416,14          | 1.450,40         | 3,06                 |


Neto-mjetet e përgjithshme në fondet pensionale vullnetare, me 31.12.2021, arritën në rreth 2,87 miliardë denarë ose rreth 46,66 milionë euro, që është rreth 0,40% e BPV-së.

Në grafikun 6.16. janë paraqitur vlerat e neto-mjeteve në fund të të gjitha viteve dhe rritja e tyre në përqindjet krahasuar me neto-mjetet në vitin paraprak. Më pas, mund të vërehet se neto-mjetet e të dyja fondeve pensionale vullnetare rriten me ritëm të ngjashëm. Rritja më e madhe është vërejtur në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010. Në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, ka rritje të neto-mjeteve, edhe te SAVAv, edhe te KBPv.


Lëvizja e vlerës së neto-mjeteve dhe kontributeve kumulative, si dhe rritja e kontributeve të paguara dhe rritja e neto-mjeteve në SAVAv dhe KBPv, janë paraqitur në grafikun 6.17. dhe në grafikun 6.18. Rritja e neto-mjeteve të fondeve pensionale vullnetare është implikuar nga rritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultatet e investimeve. Për vitin 2021, rreth 70% e rritjes së neto-mjeteve ka të bëjë me kontributet e paguara. Pjesëmarrja e kontributeve kumulative në neto-mjetet e përgjithshme gjatë viteve të para është dukshëm e madhe dhe më pas shënorë rënie.

<sup>1/2</sup>Burimi i PVB: Entiteti statistikor u statistikave – Nisqim – Prodhimi vendas bruto - Tremujori i katërti i vitit 2018- Të dhënat e vlerësuara.


Grafiku 6.16. Rritja e neto-mjeteve ne SAVv dhe KBPv ne perqindje ne raport me vitin e kaluar



Grafiku 6.17. Rritja e neto mjeteve ne krahasim me rrijen e kontributeve te paguara ne




Grafiku 6.18. Rritja e neto mjeteve ne krahasim me rrijen e kontributeve te paguara ne KBPv



Te SAVAv, në periudhën fillestare (2009 - 2011), ka rritje të madhe të neto-mjeteve dhe të kontributeve të paguara. Në vitin 2012, krahasuar me vitin 2011, rritja e neto-mjeteve ishte 54%, ndërsa te kontributet e paguara shënon rënie prej 6%. Në gjashtë vitet e ardhshme, rritja e neto-mjeteve të SAVAv zvogëlohet gradualisht nga 49% në 25% në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2019 ka rritje prej 32%. Në vitin 2020, rritja e neto-mjeteve të SAVAv ngadalësohet sërish dhe arrin 14%. Rritja e neto-mjeteve të SAVAv në vitin 2021 rritet dhe është 24%. Ndërsa, te kontributet e paguara në vitin 2014 ka rritje më të madhe, në shumën prej 50%, edhe në vitet e ardhshme, rritja e kontributeve të paguara gradualisht zvogëlohet deri në vitin 2017. Në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, rritja e kontributeve të paguara u rrit sërish dhe arriti 22%, ndërsa në vitin 2019 rritja u zvogëlua dhe është 7%. Në vitin 2020 ka rënie të kontributeve të paguara për 5% krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2021 ka sërish rritje të kontributeve të paguara për 18%.

Gjithashtu, edhe në KBPv, në periudhën fillestare (2010 - 2012), ka rritje të madhe të neto-mjeteve dhe të kontributeve të paguara. Në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012, rritja e neto-mjeteve ishte 90%, ndërsa rritja e kontributeve të paguara ishte rreth 61%. Në vitet e ardhshme, rritja e neto-mjeteve dhe e kontributeve të paguara në KBPv filloi të bjerë gradualisht. Në vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, në KBPv, neto-mjetet janë rritur për 15%, ndërsa kontributet e paguara për 1%. Në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, në KBPv, rritja e neto-mjeteve është rritur dhe është 25%, por shumica e kontributeve të paguara është ulur për 5%. Në vitin 2020 sërish ka rritje të reduktuar të neto-mjeteve, përkatësisht neto-mjetet janë rritur për 17% krahasuar me vitin 2019. Rritja e neto-mjeteve të KBPv në vitin 2021 rritet dhe është 26%. Shuma e kontributeve të paguara në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është rritur për 16%. Në vitin 2021 ka rritje të zmadhuar të kontributeve të paguara në KBPv për 38% krahasuar me vitin 2020.

Grafiku 6.18. Vlera e njësisë llogaritëse që nga fillimi i ekzistimit të fondeve pensionale vullnetare



Grafiku 6.19. Vlera e njësisë llogaritëse të fondeve pensionale vullnetare për vitin 2019




Tabela 6.5. Vlera e njësive llogaritëse që nga fillimi i ekzistimit të fondeve pensionale vullnetare

| Data       | Vlera e njësive llogaritëse |            |            |
|------------|-----------------------------|------------|------------|
|            | SAVAv                       | KBPv       | TRIGLAVv   |
| 15.09.2009 | 100,000000                  | 0,000000   |            |
| 21.12.2009 | 102,815757                  | 100,000000 |            |
| 31.12.2009 | 103,061825                  | 100,204385 |            |
| 31.12.2010 | 107,592926                  | 106,891617 |            |
| 31.12.2011 | 111,854726                  | 112,639593 |            |
| 31.12.2012 | 118,742851                  | 119,129537 |            |
| 31.12.2013 | 130,511147                  | 129,015451 |            |
| 31.12.2014 | 140,946772                  | 139,908803 |            |
| 31.12.2015 | 147,535595                  | 146,709341 |            |
| 31.12.2016 | 154,578083                  | 154,465341 |            |
| 31.12.2017 | 164,155073                  | 162,989756 |            |
| 31.12.2018 | 169,649887                  | 163,696595 |            |
| 31.12.2019 | 188,197689                  | 181,404697 |            |
| 31.12.2020 | 191,209810                  | 188,085163 |            |
| 31.03.2021 | 196,947885                  | 194,717556 | 100,106385 |
| 30.06.2021 | 202,615997                  | 199,186973 | 100,674110 |
| 30.09.2021 | 205,157852                  | 201,140977 | 101,030855 |
| 31.12.2021 | 210,750156                  | 207,793725 | 103,476074 |

Lëvizja e vlerës së njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale vullnetare, nga fillimi i punës së fondeve pensionale vullnetare, deri më 31.12.2021, është dhënë në tabelën 6.5., në grafikun 6.19. dhe në grafikun 6.20. Pra, që nga fillimi i punës së SAVAv dhe KBPv, shënohet trendi në rritje i njësive të kontabilitetit. Më 1.3.2021 filloi të punojë fondi i tretë pensional vullnetar, TRIGLAVv. Në vitin 2021, vlera e njësive të kontabilitetit ka qenë më e qëndrueshme në raport me lëvizjet e vitit 2020 të shkaktuara nga kushtet e pavoritshme në tregjet finansiare në kushtet e pandemisë së virusit korona. Gjatë vitit 2021, njësitet e kontabilitetit të të tria fondeve pensionale vullnetare shënuan rritje. Në fund të vitit, vlera e njësive të kontabilitetit të SAVAv shënoi rritje prej 10,22%, krahasuar me vitin 2020, e KBPv rritje prej rreth 10,48%, ndërsa vlera e njësive të kontabilitetit të TRIGLAVv shënoi rritje prej 3,48% nga fillimi i punës.

Të ardhurat e fondeve pensionale vullnetare sipas periudhave dhe në nivel vjetor janë paraqitur me Tabelën 6.6. Kontributi

Tabela 6.6 Të ardhurat ne FPV9Fondin pensional vullnetar

| Periudha*               | SAVAv             |                | KBPv              |                |
|-------------------------|-------------------|----------------|-------------------|----------------|
|                         | Ne vlere nominale | Ne vlere reale | Ne vlere nominale | Ne vlere reale |
| 31.12.2009 - 31.12.2010 | 4,40%             |                | 6,67%             |                |
| 31.12.2009 - 31.12.2011 | 4,18%             |                | 6,02%             |                |
| 31.12.2009 - 31.12.2012 | 4,83%             |                | 5,93%             |                |
| 31.12.2009 - 31.12.2013 | 6,08%             | 3,00%          | 6,52%             | 3,42%          |
| 31.12.2009 - 31.12.2014 | 6,46%             | 4,09%          | 6,90%             | 4,52%          |
| 31.12.2009 - 31.12.2015 | 6,16%             | 4,25%          | 6,56%             | 4,64%          |
| 31.12.2009 - 31.12.2016 | 5,96%             | 4,36%          | 6,37%             | 4,77%          |
| 31.12.2010 - 31.12.2017 | 6,22%             | 4,72%          | 6,21%             | 4,71%          |
| 31.12.2011 - 31.12.2018 | 6,13%             | 4,91%          | 5,48%             | 4,27%          |
| 31.12.2012 - 31.12.2019 | 6,80%             | 6,22%          | 6,19%             | 5,62%          |
| 31.12.2013 - 31.12.2020 | 5,60%             | 4,90%          | 5,53%             | 4,82%          |
| 31.03.2014 - 31.03.2021 | 5,97%             | 5,13%          | 5,84%             | 5,00%          |
| 30.06.2014 - 30.06.2021 | 6,17%             | 5,07%          | 5,90%             | 4,80%          |
| 30.09.2014 - 30.09.2021 | 6,05%             | 4,76%          | 5,80%             | 4,52%          |
| 31.12.2014 - 31.12.2021 | 5,91%             | 4,41%          | 5,81%             | 4,31%          |
| Fillimi** - 31.12.2021  | 6,17%             | 4,34%          | 6,26%             | 4,40%          |

\* Pas miratimit të ndryshimeve të Ligjit për sigurimin e pensional të detyruar me financim kapital nga janari i vitit 2013, të ardhurat e fondit të detyruar pensional është llogaritur për periudha trevjeçare, vetëm me shumën nominale.

\*\* Fillimi është 15.7.2009 për SAVAv dhe 21.12.2009 v. Per KBPv.


në llogarinë vullnetare individuale dhe/ose profesionale është i ndryshueshëm dhe varet nga kontributi në fondin pensional vullnetar dhe nga kompensimet e arkëtuara nga shoqëria. Kontributi, përkatësisht fitimi, është parametër që nuk mund të parashihet realisht, sepse varet nga kushtet e tregut të kapitalit dhe ekonomia e përgjithshme.

Kontributi i fondeve pensionale vullnetare llogaritet në të njëjtën mënyrë dhe sipas së njëjtës formulë si edhe kontributi i fondeve të detyrueshme pensionale.

Duke pasur parasysh natyrën afatgjate të sigurimit pensional, është mirë të llogaritet edhe kontributi i fondeve pensionale vullnetare që nga fillimi i ekzistimit të tyre, të reduktuar në nivel vjetor, i cili për SAVAv është 6,17% në shumën nominale, përkatësisht 4,34% në shumën reale, ndërsa për KBPv 6,26% në shumën nominale, përkatësisht 4,40% në shumën reale.




Grafiku 6.20. Të ardhurat ne FPV (ne shume nominale)



Lëvizja e kontributit në shumën nominale, sipas periudhave, mund të shihet në grafikun 6.21., ku janë paraqitur kontributet sipas periudhave, nga 31.12.2009 deri më 31.12.2021, sipas fondeve. Në fillim, shënohet rritja e kontributit, kështu që në fund të gjysmës së parë të vitit 2011 janë shënuar kontributet e larta në të dyja fondet pensionale vullnetare, ndërsa në fund të vitit 2011 ka pasur rënie të kontributeve. Më pas, në vitet në vijim ka rritje graduale të kontributit deri në mesin e vitit 2015, pas së cilës shënohet rënia e kontributit deri në mesin e vitit 2016 dhe më pas përsëri shënohet rritja e kontributit, përfundimisht në vitin 2016. Në vitin 2019 shënohet rritja e kontributit krahasuar me kontributin në fund të vitit 2018. Në vitin 2020 shënohen kontributet më të ulëta krahasuar me vitin 2019 në SAVAv dhe KBPv, më së shumti për shkak të gjendjeve të pavoritshme në tregjet finansiare në kushtet e pandemisë së virusit korona. Në vitin 2021 shënohet rritja e kontributeve të të dyja fondeve pensionale.

Grafiku 6.21. Të ardhurat e fondeve pensionale vullnetare (në shumë nominale), 2013- 2021



Lëvizja e kontributit në shumën nominale dhe reale, në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2021 (në nivel vjetor) dhe vitin 2021 (në nivel tremujor), sipas periudhave përkatëse të përcaktuara me ligj, të konvertuar në shkallën vjetore ekuivalente të kontributit, për fondin pensional vullnetar, mund të shihen në grafikun 6.22. Në vitin 2021, kontributi në shumën nominale dhe reale shënoi rënie edhe në SAVAv (nga 5,97% në 5,91% në shumën nominale dhe nga 5,13% në 4,41% në shumën reale) dhe në KBPv (nga 5,84% në 5,81% në shumën nominale dhe nga 5,00% në 4,31% në shumën reale). Kështu, shuma më e madhe e kontributit në shumën nominale është shënuar në tremujorin e dytë edhe te SAVAv, edhe te KBPv. Në fund të vitit 2021, janë shënuar shuma më të mëdha në shumën nominale krahasuar me vitin 2020, por edhe te SAVAv, edhe te KBPv akoma nuk janë në

nivelin e kontributit shtatëvjeçar të arritur në fund të vitit 2019. Për sa i përket kontributit në shumën reale, kontributi më i madh është shënuar në tremujorin e parë të vitit 2021. Në periudhën në shqyrtim (2013 - 2021), ndryshimi i nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhat e llogaritura, të reduktuar në nivel vjetor, deri në vitin 2019 ka shënuar rënie, gjë që ndikon në përafrimin gradual të kontributeve në shumën reale ndaj kontributeve në shumën nominale, ndërsa në periudhën pas vitit 2019 shënoi rritje që ndikon në largimin gradual të kontributeve në shumën reale nga kontributet në shumën nominale.

Kontributi shtatëvjeçar në nivelin e finansimit kapital vullnetar të sigurimit pensional për periudhën 31.12.2014 - 31.12.2021, të llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale vullnetare, të reduktuar në nivel vjetor është 5,85% në shumën nominale, përkatësisht 4,35% në shumën reale.

## 6.7 Kompensimet e fondeve pensionale vullnetare

Për ushtrimin e funksioneve të tij të menaxhimit të mjeteve të fondit pensional vullnetar, vlerësimit të mjeteve, anëtarësimit, mbajtjes së llogarive vullnetare individuale dhe profesionale të anëtarëve dhe njoftimit të anëtarëve, si dhe për pagesën e kompensimeve për MAPAS-in dhe për kujdestarin e pronës, shoqëritë; në përputhje me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me finansim kapital, arkëtojnë kompensim për kontributet, kompensim për mjetet dhe kompensim për transferimin.

Kompensimi i kontributeve arkëtohet si përqindje e çdo kontributi të paguar në fondin pensional vullnetar, përpara shndërrimit të tij në njësitë e kontabilitetit. Ky kompensim arkëtohet nga shoqëria në të njëjtën përqindje, nga të gjithë anëtarët e fondit pensional vullnetar, përveç në rastin e anëtarëve që janë pjesëmarrës në skemën pensionale profesionale ose në rastin e anëtarësimit shumëvjeçar. Kompensimi mujor i mjeteve është përqindja e vlerës së neto-mjeteve të fondit pensional vullnetar, e cila llogaritet në çdo datë të vlerësimit të mjeteve të fondit pensional vullnetar (në përputhje me rregullativën e vlefshme nënligjore, data e vlerësimit është çdo ditë) dhe arkëtohet një herë në muaj. Kompensimi i transferimit arkëtohet në rast të transferimit të anëtarit nga njëri fond pensional vullnetar në fondin tjetër pensional vullnetar, me kusht që anëtari që transferohet të ketë qenë anëtar i fondit ekzistues pensional vullnetar për më shkurt se një vit.

Ligji i përcakton shumat maksimale, ndërsa liria e shoqërive është t'i përcaktojnë shumat e llojeve të veçanta të kompensimeve në kuadër të maksimumit ligjor.

Kompensimet e arkëtuara nga shoqëritë që menaxhojnë fondet pensionale vullnetare në RMV, për vitin 2021, janë paraqitur në tabelën 6.7.

Lartësia e kompensimeve të kontributeve, të cilat janë arkëtuar nga fillimi i punës së shtyllës së tretë, përfundimisht me vitin 2021, është paraqitur në tabelën 6.8.

Tabela 6.7 Kompensimet që i arkëtojnë shoqëritë që menaxhojnë me fondet pensionale vullnetare 2021

| Lloji kompensimit                                                      | SAVA                                    | KB e Para                               |                                         |
|------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|-----------------------------------------|-----------------------------------------|
| Kompensim nga kontributet*                                             | 2,90% <sup>19</sup>                     | 2,90% <sup>20</sup>                     | 2,90%                                   |
| Kompensim mujor nga vlera e neto mjeteve në fondin pensional vullnetar | 0,100% <sup>21</sup>                    | 0,075% <sup>22</sup>                    | 0,075%                                  |
| Kompensim per kalim                                                    |                                         |                                         |                                         |
| Numri i diteve**                                                       | Shuma e kompensimit të transferimit     | Shuma e kompensimit të transferimit     | Shuma e kompensimit të transferimit     |
| Numri i diteve ≤ 360                                                   | 10 euro                                 | 10 euro                                 | 10 euro                                 |
| Numri i diteve > 360                                                   | Nuk arkëtohet kompensimi i transferimit | Nuk arkëtohet kompensimi i transferimit | Nuk arkëtohet kompensimi i transferimit |

\* Per anetaret qe jane pjesemarres ne sekmen pensionale profesionale, shoqeria pensionale mund te percaktoje vlerme te vogel te kompensimit

\*\* Numri i diteve percaktohet ne baze te numrit te diteve kur anetari ka fituar statusin e anetarit ne fondin pensional vullnetar ekzistues deri ne daten e nenshkrimit te kontrates me fondin pensional vullnetar te ardhshem

<sup>18</sup>Llogaritja e raportit rendiment-rrezik bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse edhe llogaritja tek fondet e detyruara pensionale

Tabela 6.8. Vlera e kompensimit nga kontributetqë arketojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e tretë

| Shoqëria pensionale | Vlera | Data e zbatimit                                    |
|---------------------|-------|----------------------------------------------------|
| SAVA                | 5,25% | Nga fillimi i punës së fondit (15 korrik 2009 v.)  |
|                     | 3,80% | Nga 1 marsi 2011 v..                               |
|                     | 2,90% | Nga 1 janari 2017 v.                               |
|                     | 2,90% | Nga 1 janari 2017 v.                               |
| KB e Para           | 5,50% | Nga fillimi i punës së fondit (21 dhjetor 2009 v.) |
|                     | 4,00% | Nga 24 prill 2010 v.                               |
|                     | 2,90% | Nga 1 Qershori 2013 v.                             |
| TRIGLAV             | 2,90% | Nga 1 marsi 2021                                   |

Që nga fillimi i punës së fondeve pensionale vullnetare, shoqëritë pensionale e kanë ulur kompensimin nga kontributet, përkatësisht SAVA tre herë, ndërsa KB Prvo dy herë. Kompensimi i mjeteve që nga fillimi i punës së shtyllës së tretë ishte 0,15% në muaj e vlerës së neto-mjeteve të fondit pensional vullnetar. Gjithashtu, në vitin 2011, të dyja shoqëritë e ulën edhe kompensimin e mjeteve në 0,100% të SAVA dhe në 0,075% të KB Prvo. Në vitin 2021, SAVA edhe një herë e uli kompensimin e mjeteve dhe tani ai është 0,075%.

Arkëtimi i kompensimeve (në mijëra denarë), nga shoqëritë që i menaxhojnë fondet pensionale vullnetare, gjatë vitit 2021, sipas muajve dhe sipas llojit të kompensimit, është dhënë në tabelën 6.9.

Tabela 6.9. Kontribute të paguara nga ana e shoqërive pensionale për vitin 2021 (në milione denare)

|                    | Jan.  | Shku. | Mar.  | Prill | Maj   | Qer.  | Korr. | Gusht | Shat. | Tet.  | Nen.  | Dhjet. | Totali |
|--------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|--------|--------|
| SAVA- Totali       | 1.510 | 1.408 | 1.502 | 1.628 | 1.137 | 1.370 | 1.298 | 1.234 | 1.270 | 1.593 | 1.365 | 1.830  | 17.145 |
| Nga kontributet    | 360   | 231   | 314   | 419   | 218   | 427   | 340   | 264   | 286   | 591   | 336   | 787    | 4.572  |
| Nga mjetet         | 1.150 | 1.177 | 1.189 | 1.209 | 919   | 943   | 959   | 969   | 984   | 1.001 | 1.029 | 1.043  | 12.573 |
| KB e Para -Totali  | 1.163 | 1.320 | 1.457 | 1.283 | 1.271 | 1.254 | 1.743 | 1.204 | 1.315 | 1.503 | 1.605 | 2.368  | 17.488 |
| Nga kontributet    | 287   | 424   | 545   | 352   | 334   | 300   | 771   | 213   | 316   | 491   | 563   | 1.312  | 5.907  |
| Nga mjetet         | 876   | 896   | 912   | 931   | 938   | 954   | 972   | 991   | 1.000 | 1.013 | 1.042 | 1.057  | 11.581 |
| TRIGLAV – gjithsej |       |       | 4     | 7     | 1     | 9     | 6     | 4     | 5     | 4     | 5     | 12     | 57     |
| Nga kontributet    |       |       | 4     | 7     | 1     | 9     | 5     | 3     | 4     | 4     | 4     | 11     | 51     |
| Nga mjetet         |       |       | 0     | 0     | 0     | 0     | 1     | 1     | 1     | 1     | 1     | 1      | 6      |

Provizionet e transaksionit, në lidhje me transaksionet për fitimin ose për transferimin e mjeteve të fondit pensional vullnetar, paguhen nga mjetet e fondit pensional vullnetar dhe arkëtohen nga personat juridikë të përzgjedhur që ofrojnë shërbime me letra me vlerë, brenda dhe jashtë vendit. Provizionet e transaksionit llogariten si përqindje e vlerës së çdo transaksioni të lidhur.

Gjatë vitit 2021, nga SAVAv janë arkëtuar gjithsej rreth 134 mijë denarë provizione të transaksionit, ndërsa nga KBPv janë arkëtuar gjithsej rreth 64 mijë denarë provizione të transaksionit. Në vitin 2021, nga TRIGLAV ishte arkëtuar shumë mjaft e vogël e provizioneve të transaksionit.

<sup>19</sup> Nga 1 maji 2021 (paraprakisht ishte 2,90%).

<sup>20</sup> Nga 1 Qershori 2013 (para ishte 4,00%).

<sup>21</sup> Nga 1 maji 2021 (paraprakisht ishte 0,100%).

<sup>22</sup> Nga 1 janari 2011 e (para ishte 0,15%).

## 6.8 Pagesa e kompensimeve pensionale të sigurimit pensional vullnetar me financim kapital

Kushtet për fitimin e së drejtës së kompensimit pensional dhe mënyra e pagesës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë janë më liberale në krahasim me shtyllën e dytë, por duhet pasur parasysh se ato janë kursime për periudhën pas daljes në pension. Pra, mjetet mund të tërhiqen më së hershmi dhjetë vjet para moshës për fitimin e së drejtës për pensionin e pleqërisë, në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, që për momentin do të nënkuptonte më herët në moshën 54 vjeçare për meshkujt dhe moshën 52 vjeçare për femrat. Gjithashtu, mjetet mund të tërhiqen në rast kur tek anëtarit konstatohet paafërsia e përgjithshme për punë, nga Komisioni për Vlerësimin e Afërsisë për Punë, pranë Fondit të SPIMV-së, pavarësisht moshës. Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit pensional vullnetar, mjetet nga llogaria e anëtarit bëhen pjesë e masës së trashëgimisë dhe me to veprohet në përputhje me Ligjin për trashëgiminë.

Mjetet nga shtylla e tretë përdoren sipas zgjedhjes së anëtarit në llojet e kompensimeve pensionale si në vijim:

- pagesa e njëhershme ose e shumëfishtë e mjeteve;
- anuiteti pensional i paguar nga shoqëria e sigurimit e autorizuar për këtë qëllim;
- tërheqjet e programuara të paguara nga shoqëria që menaxhon fondin pensional vullnetar, ose
- kombinimi i opsioneve të lartpërmendura.

Sigurimi i pensioneve dhe kompensimeve pensionale, të cilat paguhen nga shtylla e dytë dhe e tretë, rregullohet me Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga sigurimi pensional me financim kapital.


Në vitin 2021 janë realizuar 264 kompensime dhe pagesa pensionale nga shtylla e tretë. Pjesa më e madhe e kompensimeve pensionale të realizuara ishin në rastet e përmbushjes së kriterëve të moshës, pjesa më e madhe si pagesa të njëhershme, ndërsa një pjesë e vogël edhe si pagesa të shumëfishta. Një pjesë e vogël e pagesave në shtyllën e tretë ishin në rastin e vdekjes së anëtarit, me pagesën e trashëgimisë. Pasqyra e detajuar e kompensimeve të realizuara pensionale dhe pagesave për anëtarët e shtyllës së tretë, sipas fondeve pensionale vullnetare dhe llojit të llogarisë për vitin 2021, janë dhënë në tabelën 6.10.

Tabela 6.10. Kompensimet që i arkëtojnë shoqëritë që menaxhojnë me fondet pensionale shtyllës së tretë dhe pagesat e anëtareve

| Lloji kompensimit pensional dhe pagesat/ Fondi Pensional vullnetar | SAVAv    |           | KBPv     |           | Totali |
|--------------------------------------------------------------------|----------|-----------|----------|-----------|--------|
|                                                                    | Llog Ind | Llog prof | Llog Ind | Llog prof |        |
| Pagesa e njehershme                                                | 58       | 31        | 24       | 113       | 226    |
| Pagesat e shumëhershme                                             | 2        | 1         | 0        | 7         | 10     |
| Trashëgimia                                                        | 8        | 12        | 2        | 6         | 28     |
| Totali                                                             | 68       | 44        | 26       | 126       | 264    |

Në grafikun 6.23, është paraqitur struktura e kompensimeve dhe pagesave të realizuara pensionale për anëtarët e shtyllës së tretë nga fillimi i punës së shtyllës së tretë, sipas viteve, përfundimisht në vitin 2021. Numri i pagesave është i vogël, sepse sistemi është ende i ri dhe anëtarët janë relativisht të rinj. Pjesa më e madhe e pagesave janë pagesa të njëhershme në rast të përmbushjes së kriterëve të moshës, pasuar nga pagesat në rastet e vdekjes së anëtarit si pagesë e trashëgimisë. Ekzistojnë një numër i vogël pagesash të njëhershme në bazë të aftësisë së kufizuar, si dhe pagesash të shumëfishta në bazë të përmbushjes së kriterëve të moshës.

Grafiku 6.23. Struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e tretë nga fillimi i funksionimit



## 7 Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale

---



## 7. Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale

Për shkak të mbrojtjes së interesave të anëtarëve ekzistues, të ardhshëm dhe të pensionuar të sigurimit pensional me financim kapital dhe për shkak të sigurimit të informimit të drejtë dhe objektiv të publikut, marketingu bëhet në mjedis të rregulluar, i cili është i rregulluar me ligj dhe me akte nënligjore.

Gjatë vitit 2021 u organizua dhe u realizua provim për agjentë, në tre sesione të provimit, ku 49% të kandidatëve të pranishëm e kanë dhënë provimin. Gjithashtu, bëhej vazhdimisht regjistrimi dhe përtëritja vjetore e regjistrimit të agjentëve, ndërsa te një pjesë e agjentëve u ndërpre statusi i agjentit.

Rritja e numrit mesatar të marrëveshjeve të lidhura për agjent vazhdon edhe në vitin 2020 dhe 2021 më së shumti për shkak të rritjes së numrit mesatar të marrëveshjeve të lidhura për agjent të shoqëria e re pensionale. Lidhur me numrin e agjentëve që kanë lidhur marrëveshje, ka rritje te të tre shoqëritë pensionale.

Për t'i mbrojtur interesat e anëtarëve ekzistues dhe të ardhshëm të anëtarëve në pension të finansimit kapital të sigurimit pensional dhe për t'i ofruar informacion të drejtë dhe objektiv publikut, marketingu kryhet në mjedis të rregulluar, të rregulluar me ligj dhe me akte nënligjore.

Aktivitetet e marketingut janë të gjitha aktivitetet, qëllimi i të cilave është reklamimi i shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe informimi dhe lidhja e kontratave për anëtarësim në fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për pagesën e mjeteve nga fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Këto aktivitete përfshijnë: reklamimin e punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale që ato i menaxhojnë, informimin për karakteristikat e finansimit kapital të sigurimit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, informimin për kompensimet dhe provizionet e transaksionit, informimin për kontributet e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, informimin për portofolet e investimeve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, informimin për llogaritë individuale, llogaritë vullnetare individuale dhe llogaritë profesionale, anëtarësimin dhe transferimin e anëtarëve nga njëri fond i detyrueshëm pensional në tjetrin, anëtarësimin dhe transferimin e anëtarëve nga njëri fond pensional vullnetar, lidhjen e kontratave për tërheqjet e programuara, kontratave për pagesën e njëhershme dhe kontratave për pagesat e shumëfishta dhe aktiviteteve të tjera për qëllime reklamimi dhe sigurimi të informacioneve në lidhje me punën e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale. Shoqëria pensionale mund të kryejë veprimtari të marketingut në fondin pensional, në hapësirat e saj, në hapësirat e bashkëpunëtorëve të saj afaristë për marketing ose jashtë tyre, drejtpërdrejt ose nëpërmjet llojit përkatës të komunikimit (telefoni, faksi, interneti). Hapësirat e marketingut duhet të përmbushin kushte të përcaktuara ligjore.

Për t'i mundësuar MAPAS-it ta ushtrojë funksionin e kontrollit mbi materialet e marketingut, shoqëria pensionale është e detyruar t'ia dorëzojë MAPAS-it, në fotokopje ose në median e jashtëm përkatës, çdo material të publikuar për marketing, brenda tre ditëve pas publikimit të tij. Në rast kur MAPAS-i konsideron se ndonjë reklamë ose ndonjë material tjetër të shkruar mund të shkaktojë lajthi, mund me aktvendim ta ndalojë publikimin ose shpërndarjen e mëtejshme dhe të urdhërojë publikimin e ndryshimit të atij materiali, brenda periudhës që do të përcaktohet vetë.

Personi që bën marketing, përkatësisht agjenti, mund të jetë personi i punësuar në shoqërinë pensionale ose personi tjetër i angazhuar me kontratë nga shoqëria pensionale. Agjenti mund të kryejë aktivitete të marketingut në fondet pensionale dhe/ose të lidhë kontratë të anëtarësimit ose të pagesës së mjeteve, vetëm për fondet pensionale të menaxhuara nga shoqëria pensionale në të cilën ai është i punësuar ose i angazhuar me kontratë. Agjenti detyrimisht është i pranishëm në lidhjen e kontratës së anëtarësimit në fondin pensional, të kontratës së transferimit, kontratës së tërheqjeve të programuara, kontratës së pagesës së njëhershme dhe kontratës me pagesat e shumëfishta dhe është i detyruar të nënshkruajë kontratën e tillë. Agjenti është i detyruar që të gjitha kontaktet me anëtarin, me anëtarin në pension ose me personat që kanë të drejtë të bëhen anëtarë dhe anëtarë në pension në fondin pensional, t'i bëjë personalisht dhe nuk guxon të lidhë kontratë nëpërmjet personit tjetër. Agjenti, gjithashtu, ka rol të rëndësishëm edhe në zgjedhjen e llojit të pagesës së pensionit nga finansimi kapital i sigurimit pensional, nga anëtar, dhe është i detyruar që personalisht t'i paraqes ofertat për pensionet e projektuara të ardhshme të anëtarit që ka parashtruar kërkesë për kotacion, me shpjegimin e detajuar të karakteristikave dhe supozimeve të përdorura për të gjitha llojet e pagesave të pensioneve.

Personi mund të kryejë aktivitete të marketingut, vetëm pas regjistrimit të tij në Regjistrin e Agjentëve të mbajtur nga MAPAS-i. MAPAS-i e përcakton mënyrën dhe procedurën e dhënies së provimit për agjentë dhe mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të personit në Regjistrin e Agjentëve.

Gjatë vitit 2021 është organizuar provimi për agjentë në tri sesione të provimit nga gjithsej 136 kandidatë të pranishëm, të paraqitur për dhënien e provimit, e kanë dhënë provimin 69 ose 51% të kandidatëve të pranishëm. Në tabelën 8.1. janë dhënë të dhënat e detajuara për kandidatët e pranishëm që e kanë dhënë provimin për agjentë në vitin 2021, sipas shoqërisë pensionale.

Gjatë vitit 2021 ishte bërë regjistrimi i gjithsej 89 agjentëve, nga të cilët 18 agjentë të SAVA, 30 agjentë të KB Prvo dhe 41 agjentë të TRIGLAV. Regjistrimi i sërishëm është bërë te 4 agjentë të TRIGLAV. Gjithashtu, ishte bërë edhe rinovimi vjetor i regjistrimit të agjentëve për gjithsej 529 agjentë, prej tyre 284 të SAVA, 160 agjentë të KB Prvo dhe 85 agjentë të TRIGLAV. Gjatë vitit 2021,


Табела 7.1. Kandidatet pranishem qe kaluan provimin sipas shoqërive pensionale

| Shoqëria pensionale | Pranishem | Kaluan | Kaluan (ne %) |
|---------------------|-----------|--------|---------------|
| SAVA                | 30        | 15     | 50%           |
| KB e para           | 63        | 29     | 46%           |
| TRIGLAV             | 43        | 25     | 58%           |
| Total               | 136       | 69     | 51%           |

gjithsej 13 agjentëve u pushoi statusi i agjentit, nga të cilët 6 agjentë të SAVA, 6 agjentë të KB Prvo dhe 1 agjent të TRIGLAV. Pasqyra e numrit dhe vlerave mesatare të statuseve të regjistruara, të rinovuara dhe të ndërprera të agjentëve prej vitit 2015 deri në vitin 2021 për shoqërinë pensionale, është dhënë në grafikun 7.1. Mund të vërehet se numri i agjentëve të regjistruar në SAVA, KB Prvo dhe TRIGLAV në vitin 2021 është pothuajse në të njëjtin nivel si edhe në vitin 2020.

Për sa i përket numrit të kontratave për anëtarësim në fondet e detyrueshme pensionale, të cilat janë lidhur nga agjentët që nga fillimi i punës së sistemit, nga grafiku 7.2. mund të theksohet se shumica e agjentëve, të cilët mesatarisht kanë lidhur më së shumti kontrata për anëtarësim, ka në vitin 2005, duke qenë se ky ishte fillimi i sistemit dhe deri më 31.12.2005, ishte afati i fundit që anëtarët vullnetarë të zgjidhnin nëse do t'i bashkoheshin sistemit detyrueshëm dhe të nënshkruajnë kontratë. Në vitet e ardhshme, numri i agjentëve që lidhin kontrata është në rënie të vazhdueshme nga viti në vit, dhe në të njëjtën kohë numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent është në rritje deri në vitin 2011. Më pas, deri në vitin 2014, numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent ka rënë ndjeshëm. Në vitet e ardhshme, numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata dhe numri mesatar i kontratave të lidhura për agjent mbeten përafërsisht në të njëjtin nivel. Në vitin 2019, kur filloi aktivitetin shoqëria e tretë pensionale, ka sërish rritje të numrit të agjentëve që kanë lidhur kontrata si dhe rritje minimale të numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent krahasuar me vitin 2018. Rritja e numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent vazhdon edhe në vitin 2020 dhe 2021, më së shumti për shkak të rritjes së numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent në TRIGLAV. Sa i përket numrit të agjentëve që kanë lidhur kontrata, ka rritje në tri shoqëritë pensionale.

Grafiku 7.1. Numri i statuseve të regjistruara, të rinovuara dhe të pezulluara të agjentëve sipas viteve dhe shoqërive pensionale



Grafiku 7.2 Numri i agjentëve që kanë lidhur kontrata anëtarësimi në fondet pensionale detyrueshme dhe numri mesatar i kontratave për një agjent.

